- Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 198, datë 18.11.2024, "Procedurat për pajisjen me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë, regjistrimin e armës, administrimin e gëzhojës në një bankë të dhënash dhe procedurat që kryhen pas dorëzimit në policinë shkencore";

- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 221, datë 8.11.2024, "Për masën, kriteret dhe procedurat për tarifat financiare për veprimtarinë e lejuar me armët";

- Urdhri i ministrit të Brendshëm nr. 666, datë 18.12.2018, "Për organizimin e punës për analizën e *acquis* të Bashkimit Evropian, në kuadër të procesit 'Screening' për kapitullin 24 'Drejtësia, Liria dhe Siguria"', i ndryshuar me urdhrin e ministrit nr. 145,

datë 31.1.2019 "Mbi disa ndryshime në urdhrin nr. 666, datë 18.12.2018, 'Mbi organizimin e punës për analizën screening"', pasuar nga një analizë e plotë e përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së për armët;

- Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 386, datë 23.11.2021, "Për procedurat, dokumentacionin dhe afatet e shqyrtimit për pajisjen me autorizim për armë të subjekteve juridikë dhe fizikë, formatin e regjistrit për armët dhe municionet për subjektin e licencuar për veprimtaritë me armët, për rregullat, procedurat dhe formularin që plotësohet në kohën e realizimit të qitjes eksperimentale dhe administrimin e gëzhojës në një bankë të dhënash";

- Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 334, datë 28.10.2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e ministrit të Brendshëm nr. 262, datë 25.5.2015, 'Për procedurat për lëshimin/revokimin e dëshmisë për aftësimin teorik e praktik për armët, formati i saj, si dhe procedurat e certifikatës për drejtues teknik, për veprimtaritë e lejuara me armët, formati i saj, si dhe procedurat e certifikatës për drejtues teknik, për veprimtaritë e lejuara me armët, për programin e kursit të trajnimit, për aftësimin teorik dhe praktik për armët dhe kushtet e objektit ku zhvillohet ky program"';

- Urdhri i Kryeministrit nr. 69, datë 22.5.2017, "Për ngritjen e Komisionit Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta;

- Urdhri i ministrit të Brendshëm nr. 203, datë 18.11.2024, "Për ngritjen e komisioneve për veprimtarinë e lejuar me armët";

- Urdhri i ministrit të Brendshëm nr. 199, datë 18.11.2024, "Për ngritjen e komisioneve për dhënien e autorizimit për magazinim, transferim dhe asgjësim të lëndëve plasëse";

- Urdhri i ministrit të Mbrojtjes nr. 906, datë 20.6.2024, "Për miratimin e rregullores 'Për masat e sigurisë që duhet të marrin operatorët ekonomikë të përfshirë në veprimtarinë e prodhimit, eksportit, transitit të artikujve piroteknike"';

- Urdhri nr. 417, datë 2.5.2018, i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, "Për formën dhe përmbajtjen e vërtetimit të besueshmërisë";

- Urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 115, datë 25.1.2019, "Për organizimin e punës në procesin e përafrimit të legjislacionit, në kuadër të procesit të integrimit evropian";

- Urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve nr. 5230/1, datë 24.8.2009, "Për miratimin e normave të plotësimit me armatime e municione për punonjësit e Policisë së Burgjeve";

- Urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve nr. 6596/1, datë 24.8.2009, "Për miratimin e mjeteve dhe pajisjeve në përdorim të policisë së burgjeve";

- Urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, "Për miratimin e procedurave të certifikimit dhe formatit të certifikatës së drejtuesit teknik për veprimtarinë e lejuar me armë";

- Urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1214, datë 6.12.2021, "Procedura standarde e veprimit në rastet e zbulimit të armëve/municioneve/lëndëve plasëse që paraqesin rreziqe të konsiderueshme ndaj sigurisë dhe mbrojtjes";

- Urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 923, datë 23.6.2025 "Rastet, modalitetet dhe strukturat që hartojnë vërtetimin e besueshmërisë";

- Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 334, datë 28.10.2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e ministrit të Brendshëm nr. 262, datë 25.5.2015, 'Për procedurat për lëshimin/revokimin e dëshmisë për aftësimin teorik e praktik për armët, formati i saj, si dhe procedurat e certifikatës për drejtues teknik, për veprimtaritë e lejuara me armët, për programin e kursit të trajnimit, për aftësimin teorik dhe praktik për armët dhe kushtet e objektit ku zhvillohet ky program"';

- Urdhri nr. 367 datë 18.11.2021, "Për përbërjen, detyrat dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë".

2.2 Arritjet

Në kuadër të zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta 2019–2024 janë arritur rezultatet të konkrete, ndër të cilat:

- Ngritja e **Komisionit Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta**, i cili është përmendur edhe në raportet e progresit të Komisionit Evropian gjatë viteve të fundit. Komisioni Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL) është organizëm ndërministror përgjegjës për planifikimin, koordinimin, monitorimin dhe raportimin e të gjitha aktiviteteve të lidhura me kontrollin e armëve në Republikën e Shqipërisë, me qëllim për të siguruar një mjedis të sigurt dhe për të krijuar në këtë mënyrë kushte të favorshme për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Ky komision është një organ kyç në sigurimin e kontrollit dhe rregullimit të posedimit,

përdorimit dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta. **Funksioni kryesor i tij** është monitorimi dhe zbatimi i politikave kombëtare dhe ndërkombëtare në këtë fushë, përmes bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me partnerët ndërkombëtarë.

Komisioni Kombëtar i Armëve të Vogla e të Lehta Komisioni si mekanizëm ndërinstitucional është ngritur me urdhër të Kryeministrit nr. 69, datë 22.5.2017, "Për ngritjen e Komisionit Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta".

Ky Komision kryesohet nga zëvendësministri i Brendshëm dhe ka në përbërje të tij përfaqësues në nivel drejtor drejtorie nga ministritë e linjës, emërtimet e të cilave kanë pësuar ndryshime gjatë viteve të ushtrimit të veprimtarisë së këtij Komisioni, por përfshijnë përfaqësues nga ministritë përgjegjëse për punët e brendshme; për Evropën dhe punët e jashtme; mbrojtjen; drejtësinë, financat, shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, turizmin, mjedisin, ekonominë dhe inovacionin, arsimin, si dhe nga agjencitë ligjzbatuese, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE).

Komisioni mblidhet të paktën dy herë vit dhe ka përgjegjësi:

- për koordinimin e hartimit të politikave mbi armët e vogla dhe të lehta në Shqipëri;

- për koordinimin dhe mbledhjen e informacioneve dhe statistikave nga institucionet përkatëse për prodhimin, tregtimin, çaktivizimin, asgjësimin, përdorimin e paligjshëm të armëve, kontrollin e armëve të lejuar, kontrollin e importit dhe eksportit të armëve;

- për ndjekjen e përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare në këtë fushë dhe koordinimin e ndihmës/asistencës së huaj (organizata dhe partnerë ndërkombëtarë).

- Krijimi i **Njësisë Qendrore të Armëve të Zjarrit** si një strukturë në kuadër të Departamentit të Policisë Kriminale në Policinë e Shtetit përfaqëson një mekanizëm të specializuar për forcimin e kapaciteteve institucionale në kontrollin, parandalimin dhe luftën kundër veprimtarive të paligjshme që lidhen me armët, municionet dhe materialet shpërthyese. Kjo njësi ka detyra të përcaktuara qartë për koordinimin e hetimeve, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, gjurmimin balistik dhe kriminalistik të armëve, si dhe bashkëpunimin me strukturat kombëtare dhe ndërkombëtare për shkëmbimin e informacionit dhe zbatimin e standardeve të përbashkëta. Njësia shërben gjithashtu si pikë kombëtare kontakti për bashkëpunim ndërkufitar dhe ndërinstitucional, duke kontribuar drejtpërdrejtë në përmbushjen e objektivave strategjikë të sigurisë dhe detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për kontrollin e armëve të zjarrit. Ngritja e NJQAZ-së shënon edhe përmbushjen e një prej rekomandimeve kryesore të Komisionit Evropian në këtë fushë për krijimin e NJQAZ-së si një strukture të përhershme, sipas modelit dhe standardeve të Pikave Fokale të Armëve të Zjarrit në vendeve të Bashkimit Evropian.

- Arritja e disa nga objektivave kyç të planit të veprimit për kontrollin e armëve, duke miratuar një kuadër ligjor të përditësuar dhe të harmonizuar me rregulloret e **Bashkimit Evropian** dhe detyrimet ndërkombëtare. Ky përmirësim legjislativ krijoi bazën për politika më efektive dhe standardizim me vendet e të rajonit, duke forcuar bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar. Konkretisht, në vitin 2020, Shqipëria rishikoi kuadrin ligjor në fushën e armëve duke miratuar ndryshimet në ligjin 74/2014, "Për armët", e cila pasoi me miratimin e dy ligjeve të rëndësishme për lëndët plasëse dhe artikujt piroteknikë, përkatësisht ligji 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil" dhe ligji 73/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë", si edhe rregulloren për çaktivizimin e armëve të zjarrit të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 348, datë 26.5.2022, "Rregullorja, standardet dhe teknikat e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre", ku të gjitha këto akte përafruan legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian për fushën përkatëse.

- Progresi i objektivave për realizim deri në vitin 2024 ka qenë i dukshëm, veçanërisht në bazimin e politikave të kontrollit të armëve mbi statistika dhe të dhëna të inteligjencës. Përmirësimi i mekanizmave të mbledhjes dhe analizimit të informacionit ka mundësuar një qasje më të strukturuar në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të armëve, duke reduktuar në mënyrë të konsiderueshme qarkullimin e tyre brenda dhe jashtë **Republikës së Shqipërisë**.

- Ngritja dhe funksionimi i Sistemit të Menaxhimit Policor të Çështjes, një platformë e

integruar për shkëmbimin e informacionit në fushën e drejtësisë penale, me synim përfshirjen e Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe Gjykatave, i cili aktualisht përdoret dhe përditësohet nga Policia e Shtetit, ndërsa janë ndërmarrë hapa konkretë për zgjerimin e aksesit dhe funksionalitetit të tij edhe për institucionet e tjera të drejtësisë. Kjo përbën një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një sistemi të unifikuar dhe efikas për shkëmbimin e të dhënave, përfshirë ato që lidhen me rastet e ndjekura penalisht dhe të gjykuara që përfshijnë përdorimin e armëve të zjarrit.

- Në kuadër të uljes së sasisë së tepërt dhe asgjësimi i armëve të vogla e të lehta dhe municioneve të tyre të kapura, në zbatim të ligjit nr. 74/2014, "Për armët", i rishikuar, si dhe të Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019–2024, gjatë periudhës 2022–2024 është realizuar shkatërrimi i sasive të konsiderueshme të AVL-ve dhe pjesëve përbërëse të armëve, në përputhje me standardet e sigurisë. Konkretisht, në vitin 2022 u asgjësuan 5509 copë AVL, ndërsa në vitin 2023 u shkatërruan 1017 copë AVL dhe rreth 411363 copë pjesë përbërëse të armëve, proces që u krye në Uzinën Mekanike Gramsh. Këto rezultate dëshmojnë përkushtimin e institucioneve përgjegjëse për të reduktuar rreziqet dhe për të siguruar menaxhimin e përgjegjshëm të armatimit dhe municioneve.

- Në lidhje me luftën dhe kontrollin e armëve të vogla e të lehta, një numër i konsiderueshëm armësh të paligjshme dhe municione janë sekuestruar gjatë viteve të fundit. Referuar rasteve të konstatuara të mbajtjes dhe prodhimit të armëve pa leje gjatë periudhës 2019–shtator 2024 ka pasur një nivel zbulueshmërie të armëmbajtjes pa leje prej 78.6% nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur raste të evidentuara të prodhimit të armëve në mënyrë të kundërligjshme, punishte apo vende të përshtatura për këtë aktivitet. Në lidhje me prodhimin dhe mbajtjen pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive gjatë periudhës 2019–2024 ka pasur një zbulueshmëri prej 99.1% nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit. Në lidhje me trafikimin e armëve dhe municioneve gjatë periudhës 2019–2024 ka pasur një zbulueshmëri prej 91.7% nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit. Në bazë të numrit të sekuestrimeve gjatë periudhës 2019–2024 evidentuan një total prej 3180 armësh të sekuestruara, ku përmendim pistoletat 1574 copë (rreth 49.5 % të totalit), të ndjekura nga armët e gjahut 727 copë (rreth 22.86% të totalit) dhe automatiket kallashnikov me 879 (rreth 27.64 % të totalit).

- Forcimi i kapaciteteve hetimore dhe rritjes së efikasitetit në identifikimin e provave materiale balistike, nëpërmjet instalimit me financim të Qeverisë Franceze të sistemit modern EVOFINDER në Sektorin e Ekzaminimeve Balistike pranë Institutit të Policisë Shkencore. Ky sistem, i cili zëvendëson teknologjinë e mëparshme ARSENAL ofron imazh të avancuar 3D, laser skaner me cilësi të lartë, kapacitet më të madh dhe shpejtësi më të lartë përpunimi. Instalimi i tij krijon mundësinë për të shkëmbim të dhënash balistike me vendet e tjera të rajonit dhe më gjerë, duke përfshirë Francën, Greqinë dhe Gjermaninë. Pas trajnimit të stafit, në një kohë të shpejtë u krye regjistrimi i të dhënave për ngjarjet e ndodhura ndër vite (2009–2025), duke përmbushur standardet ndërkombëtare për kartotekën balistike. Që prej përdorimit të tij, sistemi ka rezultuar plotësisht efikas në identifikimin e armëve, gëzhojave dhe predhave, përfshirë edhe rastet e mikro-relievit, duke e kthyer instalimin e EVOFINDER në një histori suksesi dhe një arritje të rëndësishme nga pikëpamja e zhvillimit të kapaciteteve teknologjike në fushën e balistikës.

- Zhvillimi i kontrolleve periodike në subjektet që tregtojnë armët e zjarrit si për kushtet e mbajtjes, transportit dhe ruajtjes/sigurisë së tyre, ku përgjatë periudhës 2022–2024, strukturat e Policisë së Shtetit kanë ushtruar kontrolle të rregullta mbi subjektet e licencuara dhe personat e autorizuar për armët e zjarrit, si dhe mbi subjektet që ushtrojnë veprimtari me lëndë plasëse dhe artikuj piroteknikë. Në këtë kuadër, janë kryer gjithsej 874 kontrolle ndaj subjekteve të licencuara për armë, nga të cilat janë vendosur 36 masa administrative, ndërsa ndaj subjekteve që operojnë me lëndë plasëse dhe artikuj piroteknikë janë zhvilluar 813 kontrolle, pa evidentuar shkelje.

- Forcimi i bashkëpunimit dypalësh, rajonal dhe ndërkombëtar në luftën kundër trafikimit të armëve të zjarrit, përmes mekanizmave ekzistues dhe nxitjes së praktikave të reja të bashkëpunimit operacional dhe shkëmbimit të informacionit, përmes intensifikimit të bashkëpunimit me FRONTEX, në pikat e kalimit kufitar përmes zbatimit të Operacionit të Përbashkët JO FOA Western

Balkans, si dhe ka rritur shkëmbimin e vazhdueshëm të informacionit me Europol dhe Interpol, në kuadër të hetimeve të përbashkëta dhe kontrollit të armëve të zjarrit në sistemin kombëtar SIMA.

Në kuadër të një vlerësimi të nevojave për strukturat kufitare dhe kriminale nga organizatat partnere (SEESAC, UNDP, UNODC dhe OSCE) është ofruar mbështetje gjithëpërfshirëse për rritjen e kapaciteteve të shërbimeve me qëllim zhvillimin e procedurave standarde të veprimit, blerjen e pajisjeve dhe organizimin e trajnimeve, patrullimeve të përbashkëta me vendet fqinje si Kosova etj.

Gjithashtu, gjatë periudhës 2023–2024, në kuadër të veprimeve operacionale ndërkombëtare për kontrollin dhe parandalimin e armëve, municioneve dhe eksplozivëve, janë zhvilluar operacione ndërkombëtare me pjesëmarrjen e strukturave të Policisë së Shtetit, ku përmendim Operacionin Conversus, me synim parandalimin dhe evidentimin e trafikut të armëve të zjarrit të konvertuara, si dhe sekuestrimin e sendeve të tjera të kundërligjshme gjatë ditëve të përbashkëta të veprimit në Evropën Juglindore (EMPACT). Me rëndësi të veçantë ka qenë, gjithashtu, pjesëmarrja në Operacionin JAD SEE, i cili koordinohet nga Platforma EMPACT. Ky operacion kishte si synim luftën kundër trafikimit të armëve dhe municioneve, trafikimin e narkotikëve (kokainë, heroinë, *cannabis sativa*), trafikimin e qenieve njerëzore, rrjetet kriminale me rrezikshmëri të lartë dhe kontrabandimin e migrantëve. Një ndër operacionet e tjera të zhvilluara është Operacioni ARMSTRONG. Qëllimi i këtij operacioni ishte bashkëpunimi midis Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për të zbutur rrezikun e paraqitur nga armët e zjarrit të paligjshme, pjesët e tyre përbërëse dhe municionet, të trafikuara nëpërmjet shërbimeve postare, duke bërë dokumentim dhe goditje të kësaj veprimtarie kriminale, në bashkëpunim dhe koordinim me vendet e Evropës Lindore dhe Juglindore dhe ato anëtare të BE-së. Gjithashtu, përmendim Operacionin TORO, i cili ka si objekt luftën kundër posedimit dhe trafikimit të AME në "dark web".

Gjatë periudhës 2023–2024, në kuadër të veprimeve operacionale kombëtare për kontrollin dhe parandalimin e armëve, municioneve dhe eksplozivëve, janë zhvilluar nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit rreth 183 operacione kombëtare, ku përmendim: rreth 153 operacione për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal; 15 operacione për veprën penale "Trafikim i armëve dhe i municionit", parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal; 14 operacione për veprën penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive", parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal; si dhe 1 operacion për veprën penale "Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse dhe helmuese", parashikuar nga neni 282/a i Kodit Penal.

Gjatë periudhës 2022–2024, strukturat policore kufitare kanë vijuar bashkëpunimin e ngushtë me FRONTEX në kuadër të Operacionit të Përbashkët JO FOA Western Balkan, me fokus parandalimin e trafikimit të armëve të zjarrit në kufirin shtetëror me Greqinë. Krahas kësaj, janë forcuar ndjeshëm kapacitetet operacionale përmes një sërë donacionesh nga partnerë ndërkombëtarë. Në vitin 2022 u siguruan pajisje të specializuara për kufirin nëpërmjet mbështetjes së Republikës Federale të Gjermanisë. Në vitin 2023, me mbështetjen e IOM, Ambasadorëve Gjerman dhe Amerikan, EU4LEA, SEESAC dhe Ministrisë së Brendshme të Mbretërisë së Bashkuar, u përfituan pajisje moderne teknologjike, mjete të avancuara kontrolli, kompjuterë dhe dronë u ndërtua Qendra e Pritjes në PKK Qafë Botë, në vlerën 300 000 euro. Ndërsa në vitin 2024, në kuadër të marrëveshjes me UNDP, Policia e Shtetit përfitoi pajisje të reja për kontrollin kufitar, përfshirë videoprojektorë, detektorë, skanerë me rreze X dhe dronë. Këto zhvillime përbëjnë një arritje të rëndësishme strategjike në forcimin e kapaciteteve të sigurisë kufitare, modernizimin e pajisjeve dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për parandalimin e trafikimit të armëve dhe krimeve ndërkufitare.

Gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë janë përmirësuar dhe modernizuar kapacitetet logjistike dhe kapaciteteve hetuese/zbuluese duke përdorur pajisje sipas standardeve të vendeve të Bashkimit Evropian si videoskop, detektorë, skaner me rreze X dhe dronë. Në fushën e trajnimeve janë miratuar procedurat për trajnimin dhe përdorimin e qenve policorë sipas standardeve evropianë me mbështetjen e ekspertëve në kuadër të projekteve të financuara nga Republika Federale e Gjermanisë, Republika e Francës dhe BE-së, të zbatuara nga OSBE, si dhe janë kryer trajnime nga Xhandarmëria Franceze për zbulimin e armëve të vogla dhe të lehta

nga qentë policorë. Më konkretisht disa nga aktivitetet e realizuara në kuadër të rritjes së kapaciteteve të qenve policorë K-9 janë hartimi i procedurave standarde të funksionimit (PSV) dhe i Master Planit për zhvillimin e kapaciteteve të qenve policorë K9, përmirësimi i kapaciteteve logjistike me automjete dhe pajisjeve për Institutin e Trajnimit të Qenve Policorë, gjithashtu kapacitetet profesionale përmes Trajnimit për Trajnerë (ToT) të punonjësve të policisë me funksion trajnues të qenve policorë për specialitetin SAMBI (frëngjisht: qen shumë-disiplinor për narkotike, monedha, arme dhe municion) në Xhandarmërinë Franceze, si edhe mundësimit të një moduli trajnimi *online* për qëndrueshmërinë dhe konsolidimin e kapaciteteve profesionale. Këto zhvillime përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të koordinimit ndërkombëtar dhe rritjes së efikasitetit në parandalimin dhe goditjen e krimeve që lidhen me armët e zjarrit.

- Konsolidimi i një qasje gjithëpërfshirëse për ndërgjegjësimin e popullsisë, me fokus të veçantë te gratë, burrat dhe të rinjtë, mbi rreziqet që lidhen me keqpërdorimin, mbajtjen e jashtëligjshme dhe trafikimin e armëve të vogla dhe të lehta. Nën udhëheqjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Shtetit, në bashkëpunim të ngushtë me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri dhe organizatat e shoqërisë civile, është zbatuar me sukses Strategjia Kombëtare e Ndërgjegjësimit dhe Komunikimit, duke përfshirë zhvillimin e fushatave të vazhdueshme ndërgjegjësuese dhe aktivitete të shënjestruara në zonat me risk të lartë të mbajtjes së armëve të jashtëligjshme. Fushatat kanë synuar ndryshimin e qëndrimeve shoqërore për armëmbajtjen, veçanërisht tek të rinjtë. Kjo arritje përfaqëson një model të suksesshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërsektorial në përpjekje për reduktimin e qarkullimit të armëve të paligjshme dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore, veçanërisht tek të rinjtë dhe tek gratë dhe vajzat, duke kontribuar në tërësi në rritjen e sigurisë publike në vend.

Gjatë periudhës 2023–2024 janë ndërmarrë hapa konkretë dhe të vazhdueshëm për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të Policisë së Shtetit në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Gjithashtu janë zhvilluar trajnime të shumta në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë dhe organizata vendore, ku janë përfshirë mbi 480 punonjës policie në të gjitha Drejtoritë Vendore të Policisë, me fokus të veçantë në vlerësimin e riskut dhe parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit, në këto raste. Zhvillimi i analizave periodike mbi përdorimin e armëve në ngjarjet e dhunës në familje është një ndër burimet kryesore që ka kontribuar në forcimin e politikave parandaluese.

- Në kuadër të uljes së kërcënimeve që rezultojnë nga keqpërdorimi dhe zotërimi i paligjshëm i armëve të vogla e të lehta përmes aktiviteteve ndërgjegjësuese shumëpalëshe, Ministri i Punëve të Brendshme miratoi urdhrin nr. 90, datë 1.6.2022, *"Për ngritjen e Task-Forcës për uljen e kërcënimeve që rezultojnë nga keqpërdorimi dhe zotërimi i paligjshëm i armëve të vogla e të lehta përmes aktiviteteve ndërgjegjësuese shumëpalëshe dhe të bazuara në informacion"*. Task-Forca ka kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit për uljen e kërcënimeve që rezultojnë nga keqpërdorimi dhe zotërimi i paligjshëm i armëve të vogla e të lehta, përmes forcimit të kapaciteteve institucionale për organizimin e fushatave ndërgjegjësuese efikase duke përfshirë aspektet e projektimit, menaxhimit, monitorimit dhe vlerësimit të fushatave ndërgjegjësuese kombëtare, si dhe duke mundësuar standardizimin e praktikave ndërgjegjësuese me vendet e Ballkanit Perëndimor.

- Në bashkërendim dhe duke u mbështetur tek arritjet e Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta dhe Eksplozivëve 2019–2024, me qëllim uljen e kërkesës dhe keqpërdorimit të armëve të vogla e të lehta në Shqipëri, Ministria e Punëve të Brendshme me Prezencën e OSBE-së hartuan Strategjinë e Ndërgjegjësimit dhe Komunikimit dhe Planin Kombëtar të aktiviteteve të ndërgjegjësimit për periudhën 2023–2027 për Armët e Vogla dhe të Lehta, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, Komisionin Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta, organizatat e shoqërisë civile, Këshillat Vendorë për Sigurinë Publike, grupet rinore, mediat, SEESAC dhe UNDP në Shqipëri. Në kuadër të zbatimit të strategjisë së miratuar janë zhvilluar fushata ndërgjegjësuese dhe aktivitete në zonat me risk të lartë nga Policia e Shtetit, me qëllim ndryshimin e qëndrimeve shoqërore ndaj armëmbajtjes, me fokus tek të rinjtë, si dhe janë ndërmarrë aktivitete për përmirësimin e raportimit etik dhe sensitiv mbi çështjet e sigurisë publike dhe armëve të vogla e të lehta, përmes zbatimit të planit të transmetimit të spoteve dhe materialeve

promovuese në TV, radio dhe rrjete sociale, si dhe postimeve në media *online*.

Paralelisht janë organizuar fushata dhe aktivitete ndërgjegjësuese me të rinjtë në qytete të ndryshme të vendit, duke synuar ndryshimin e qëndrimeve ndaj rrezikut të mbajtjes dhe keqpërdorimit të armëve të vogla e të lehta dhe duke rritur ndërgjegjësimin e shoqërisë për sigurinë dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, konkretisht gjatë periudhës 2023–2024 janë zhvilluar aktivitet ndërgjegjësuese, si më poshtë:

Në periudhën 2022–2024 janë ndërmarrë aktivitete për përmirësimin e raportimit etik e sensitiv mbi çështjet e sigurisë publike dhe armëve të vogla e të lehta, nëpërmjet zbatimit të planit të transmetimit të spoteve dhe materialeve promovuese në TV, radio dhe rrjete sociale, si dhe planit të përmbajtjes së postimeve në median *online*, i cili është detajuar çdo muaj. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë publikuar rregullisht në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit dhe në mediat kryesore informacionet mbi incidentet dhe sekuestrimet e armëve të zjarrit.

Bazuar në Strategjinë e Ndërgjegjësimit dhe Komunikimit, me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, përgjatë vitit 2024, projekti i Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) finalizoi me sukses implementimin e dy fushatave ndërgjegjësuese fokusuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe ndryshimit të qëndrimeve në lidhje me rrezikun e AVL-ve, luftimin e dhunës me bazë gjinore në lidhje me armët e vogla dhe të lehta, si dhe angazhimin e të rinjve me qëllim informimin e qytetarëve shqiptarë për rreziqet e keqpërdorimit të armëve të zjarrit dhe nxitjen e një kulture paqeje dhe sigurie.

Bazuar në hulumtimin e kryer përpara nisjes së fushatës ndërgjegjësuese u përcaktuan qytetet e targetuara, të cilat kishin numrin më të lartë të personave që posedojnë armë të jashtëligjshme, krahasuar me numrin e popullsisë si: Lezha, Shkodra, Vlora, Tirana, Durrësi, Elbasani dhe Fieri. Fushata ndërgjegjësuese me mesazhin kryesor "Ki guxim t'u thuash jo armëve" nisi në muajin maj 2024 dhe vazhdoi implementimin deri në fund të muajit dhjetor 2024, duke përfshirë fushatën digjitale përmes promovimit të spotit të fushatës, postimeve në rrjetet sociale dhe publikimin e një kënge të fushatës me angazhimin e një figure të mirënjohur të muzikës të zhanrit "rap" tek të rinjtë me sloganin "Leji armët", si dhe duke arritur një audiencë prej 3,489,034 qytetarësh në TV, radio dhe platforma të mediave sociale.

Në kuadër të fushatës ndërgjegjësuese janë firmosur dy memorandume mirëkuptimi ndërmjet OSBE-së, Ministrisë së Punëve të Brendshme, katër Organizatave të Shoqërisë Civile dhe Bashkisë së Elbasanit, për bashkë organizimin e aktiviteteve në terren me të rinjtë dhe me kryetarët e Bashkive Elbasan, Shkodër dhe Lezhë, duke pasur si fokus kryesor temën e AVL-ve dhe në funksion të organizimit të aktiviteteve në terren me të rinjtë. Në periudhën shtator–dhjetor 2024 u zhvilluan një seri aktivitetesh ndërgjegjësuese me të rinjtë *(rreth 700 të rinj, studentë, nxënës e mësues)* me përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në Lezhë, Shkodër, Elbasan dhe Tiranë (Organizata Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim; Organizata Qendra e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë; Organizata *Terre Des Hommes* dhe Organizata "Kongresi Rinor").

Një nismë po kaq konkrete ka qenë dhe realizimi dhe prodhimi i gjashtë video dëshmive "Zëra të padëgjuar", të konceptuara dhe regjistruara nga të rinjtë në bashkëpunim me Organizatat e Shoqërisë Civile, të publikuara në rrjetet e mediave sociale gjatë muajve nëntor–dhjetor 2024. Në po të njëjtin qëllim, në qytetet e targetuara janë vendosur e instalacioneve të quajtura "Muri i kujtesës për dhunën me armë' dhe muraleve që tejçojnë mesazhe të fuqishme për paqen, ideuar nga të rinjtë përmes artit dhe ngjarjeve të vërteta, në Bashkitë Shkodër, Elbasan dhe Tiranë.

Në *web*-faqen e Policisë së Shtetit është krijuar një dritare e veçantë në lidhje me parandalimin e përdorimit të armëve të zjarrit, me titullin "Të guximshëm pa armë", në të cilën janë publikuar të dhëna dhe informacione në lidhje me përgjegjësinë ligjore të mbajtjes së armëve dhe keqpërdorimit të tyre, si dhe për fushatën ndërgjegjësuese që po zhvillohet, link i *web:* https://asp.gov.al/te-guximshem-pa-arme/.

Media është informuar në mënyrë periodike për rastet ku janë përdorur armë zjarri apo në rastet e parandalimit të ngjarjeve të rënda kriminale, ku ka pasur të përfshirë armë zjarri apo lëndë plasëse.

Fushata arriti një ekspozim të gjerë mediatik, me 60.10% të të anketuarve që hasnin shpesh mesazhe të lidhura me armët e zjarrit, për të cilat u zhvillua një intervistë për Radio Televizionin Shqiptar mbi ndikimin dhe rezultatet e saj.

Impakti i fushatës ndërgjegjësuese të finalizuar dhe rezultatet e sondazhit do të shërbejnë në vazhdimësi për hartimin dhe implementimin e fushatave të ardhshme ndërgjegjësuese në kuadër të strategjisë së re.

Me mbështetjen e Projektit të UNDP "Forcimi i Kontrollit Administrimit dhe Qëndrimeve Sociale ndaj AVL" u zhvilluan aktivitete ndërgjegjësuese në 24 shkolla të mesme në të gjithë vendin, ku u zhvilluan takimet ndërgjegjësuese dhe këndet e sigurisë në shkolla.

Konkretisht janë zhvilluar takime sensibilizuese në institucione arsimore, me moton "Shkrep ide, jo armë". Mesazhet e ndërgjegjësimit të publikut u fokusuan në:

- Rreziqet potenciale të keqpërdorimit të armëve te jetët e njerëzve, rreziqet e dhunës në familje me armë zjarri, dhe rrezikun e kryerjes së krimeve të rënda.

- Dhënien e apelit për komunitetin për të fuqizuar bashkëpunimin me policinë dhe për të ndihmuar policinë me informacione mbi qytetarët që mund të zotërojnë armë të jashtëligjshme.

- Ndëshkimin e rreptë, në përputhje me Kodin Penal, dhe pasojat sociale për individët, veçanërisht për të rinjtë, në karrierën e tyre të ardhshme personale, si dhe në jetën sociale dhe ekonomike.

Këto aktivitete kanë ndikuar në forcimin e transparencës, komunikimit publik dhe ndërgjegjësimit shoqëror për rreziqet që lidhen me armët e zjarrit.

- Forcimi i kapaciteteve institucionale të strukturave shtetërore përgjegjëse përfshirë Forcat e Armatosura, institucionet ligjzbatuese, rojën pyjore, doganat dhe shërbimet korrigjuese në drejtim të ngritjes dhe funksionalizimit të sistemeve të inspektimit dhe menaxhimit gjatë gjithë ciklit të jetës së armëve të vogla dhe të lehta dhe municioneve, në përputhje me standardet ndërkombëtare, ku janë ndërmarrë masa konkrete për sigurimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së magazinimit për armët dhe municionet, bazuar në nevojat e identifikuara dhe në përputhje me kërkesat teknike dhe standardet e sigurisë ndërkombëtare, duke synuar parandalimin e aksidenteve, shmangien e shpërdorimit dhe garantimin e sigurisë publike.

- Intensifikimi i trajnimeve, ku gjatë periudhës 2022–2024 është realizuar një program i gjerë trajnimesh për punonjësit e strukturave përgjegjëse të Policisë së Shtetit për Hetimin e Krimeve Kibernetike dhe për NJQAZ, me qëllim rritjen e kapaciteteve hetimore dhe të sigurisë kibernetike. Në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë si NCA (*National Crime Agency*), Qeveria Japoneze, Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës, EU4LEA dhe SEESAC janë zhvilluar trajnime mbi hetimin e krimeve kibernetike, masat kundër krimeve kibernetike, ekipet e përbashkëta hetimore, administrimin e provave kompjuterike, patrullimin *online* dhe përdorimin e inteligjencës në burimet e hapura (OSINT). Gjithashtu, u zhvilluan trajnime të specializuara për kapacitetet analitike, mbledhjen dhe shkëmbimin e informacionit të inteligjencës, veçanërisht për veprat penale të lidhura me armët e zjarrit. Këto aktivitete kanë ndihmuar në përforcimin e aftësive profesionale, rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe përmirësimin e metodologjive të hetimit, duke u konsideruar një arritje e rëndësishme strategjike në fushën e sigurisë dhe zbatimit të ligjit.

Në tërësi, Shqipëria ka bërë hapa domethënës në përmbushjen e objektivave të saj strategjikë në fushën e kontrollit të armëve të vogla, të lehta, municioneve dhe eksplozivëve, në përputhje me angazhimet e saj kombëtare dhe ndërkombëtare. Këto përparime janë reflektuar në disa drejtime kyçe që përbëjnë një bazë solide për rendin dhe sigurinë publike dhe për forcimin e shtetit ligjor.

Së pari është forcuar kuadri ligjor dhe nënligjor, përmes përafrimit me standardet e Bashkimit Evropian dhe instrumenteve ndërkombëtare dhe Protokollit të OKB-së për armët e zjarrit. Përmirësimet në kuadrin ligjor për armët e vogla dhe të lehta kanë krijuar një kornizë më efikase për parandalimin e keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve, ku janë ndërmarrë hapa për të ndërtuar një sistem më të mirë të gjurmueshmërisë dhe regjistrimit të armëve, si dhe forcimit të mekanizmave të kontrollit në pikat kufitare.

Së dyti, kapacitetet e organeve shtetërore, agjencive të specializuara, institucioneve të pavarura, si dhe strukturat mbështetëse që kontribuojnë në hartimin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë janë rritur në mënyrë të konsiderueshme, duke kontribuar në zhvillimin e mekanizmave të përbashkët bashkëpunimi lidhur me identifikimin, hetimin dhe goditjen e rrjeteve që merren me trafikimin e paligjshëm të armëve. Këto struktura kanë rritur aftësitë teknike dhe operative për të hetuar, analizuar dhe shkëmbyer

informacione mbi aktivitetet kriminale të lidhura me armët. Përmes bashkëpunimit ndërinstitucional dhe koordinimit të aktiviteteve në kuadër të strategjisë është mundësuar një qasje gjithëpërfshirëse në adresimin e këtij fenomeni.

Së treti, vërehet një përmirësim i dukshëm në mbikëqyrjen dhe kontrollin e qarkullimit të armëve, si rezultat i forcimit të masave të sigurisë dhe zbatimit më të rreptë të ligjit. Një numër i konsiderueshëm armësh të paligjshme janë sekuestruar dhe asgjësuar gjatë viteve të fundit. Konkretisht, në vitin 2022 u asgjësuan 5509 copë AVL, ndërsa në vitin 2023 u shkatërruan 1017 copë AVL dhe rreth 411363 copë pjesë përbërëse të armëve.

Gjithashtu, bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar është intensifikuar përmes pjesëmarrjes në programe të përbashkëta me organizata si SEESAC, UNDP, UNODC, INTERPOL EMPACT- *European Multidisciplinary Platform Against Criminal Threats*, EUROPOL dhe partnerë bilateralë, duke mundësuar shkëmbimin e praktikave më të mira dhe koordinimin e operacioneve kundër trafikut ndërkufitar të armëve.

Në këtë kontekst, përpjekjet e Shqipërisë për të reduktuar qarkullimin e paligjshëm të armëve, për të forcuar kontrollin mbi to dhe masat e ndërmarra për kontrollin e tregtisë së ligjshme të armëve dhe municioneve përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt përmbushjes së angazhimeve të saj si vend kandidat për në Bashkimin Evropian. Ato reflektojnë angazhim në nivel të politikave kombëtare për të adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme çështjet e sigurisë dhe sundimit të ligjit, në funksion të stabilitetit të brendshëm dhe bashkëpunimit rajonal, duke përfshirë transparencën përmes raporteve vjetore.

2.3 Mësimet

Siguria dhe kontrolli i armëve të zjarrit, eksplozivëve dhe lëndëve plasëse në Shqipëri përballet me sfida të shumta dhe komplekse, të cilat kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme dhe sistematike nga institucionet përgjegjëse.

Së pari, është e domosdoshme përmirësimi i përgjigjes institucionale ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit, veçanërisht në rastet e dhunës në familje. Një tjetër sfidë e rëndësishme është trajtimi i lidhjeve të normave sociale/zakonore/kulturore që formësojnë qëndrimet e target grupeve të caktuara për përdorimin e armëve të zjarrit, me qëllim ndryshimin e sjelljeve shoqërore që mund të favorizojnë përdorimin e paligjshëm të armëve. Synohet rritje e pjesëmarrjes së grave në aspektet operacionale dhe teknike të kontrollit të armëve, si dhe përfshirje më aktive e organizatave të grave dhe shoqërisë civile në proceset e politikë-bërjes dhe vendimmarrjes.

Në fushën ligjore, mungesa e një kuadri të veçantë për kontrollin e prekursorëve të lëndëve plasëse përbën një boshllëk të rëndësishëm. Legjislacioni aktual trajton substancat kimike në mënyrë të përgjithshme, pa adresuar specifikisht kontrollin, monitorimin dhe kufizimin e materialeve që mund të përdoren për prodhimin e lëndëve eksplozive. Kjo situatë krijon rrezik për keqpërdorim dhe pengon ndërhyrjen efektive të institucioneve mbikëqyrëse. Po ashtu, mungesa e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit nr. 74/2021, për përdorimin civil të lëndëve plasëse dhe piroteknikëve pengon krijimin e një sistemi të përshtatshëm për gjurmimin, identifikimin, autorizimin dhe kontrollin e magazinimit, transferimit dhe asgjësimit të këtyre lëndëve.

Në aspektin penal, procesi i rishikimit të Kodit Penal vazhdon ende, ku harmonizimi i dispozitave lidhur me armët e zjarrit me standardet ndërkombëtare, veçanërisht me Protokollin e OKB-së për armët e zjarrit, përbën një angazhim thelbësor.

Në nivel operacional, për ndërtimin e mekanizmave të qëndrueshëm për mbikëqyrjen dhe çaktivizimin e armëve të vogla dhe të lehta mbetet një sfidë e rëndësishme. Nevoja për forcimin e kapaciteteve institucionale, përmirësimin e bashkërendimit ndërinstitucional dhe sigurimin e burimeve të qëndrueshme për të parandaluar përhapjen dhe keqpërdorimin e këtyre armëve, ku theksohet domosdoshmëria e forcimit të kapaciteteve trajnuese në Institutit e Përgatitjes së Qenve Policorë për zbulimin e armëve të vogla dhe të lehta, në kabinetet e trajnimit dhe të akomodimit për punonjësit e policisë, të cilët do të trajnohen për shoqërues të qenve policorë. Gjithashtu, rritja e numrit të trajnimeve të specializuara për ndjekjen penale dhe aplikimin e masave penale ose kundërvajtjeve për keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve mbetet nevojë edhe për periudhën vijuese, sidomos në lidhje me përdorimin e provave elektronike.

Në fushën e ndërgjegjësimit publik, mbetet i rëndësishëm sensibilizimi i subjekteve të licencuara, prodhuesve, dhe publikut të gjerë për rreziqet që sjell keqpërdorimi dhe përhapja e jashtëligjshme e armëve të zjarrit. Fokus i veçantë duhet t'i jepet edukimit të të rinjve, ndërgjegjësimit mbi pasojat e gjuajtjes me armë gjatë festimeve, dhe luftës kundër dhunës me armë ndaj grave dhe në familje. Në këtë kontekst, rritja e partneritetit me median dhe forcimi i besimit të qytetarëve në institucionet e sigurisë janë elemente thelbësore.

Nga ana tjetër, sfidat teknike përfshijnë krijimin e një kuadri ligjor dhe mekanizmash praktikë për ndërmarrjen apo konsiderimin e një iniciative për legalizimin dhe dorëzimin vullnetar të armëve të zjarrit. Gjithashtu, përdorimi i qëndrueshëm i procesit të çaktivizimit të armëve dhe garantimi i mjediseve të sigurta për magazinimin e armëve dhe eksplozivëve në përputhje me standardet ndërkombëtare përbëjnë sfida kyçe. Këto kërkojnë investime në infrastrukturë, si dhe ngritjen e kapaciteteve të subjekteve juridike përkatëse, duke përfshirë prodhuesit, tregtuesit, poligonet, shoqëritë private të sigurisë dhe qendrat e trajnimit, për të vendosur sisteme efektive të inspektimit dhe kontrollit.

Në përmbledhje, sfidat në fushën e kontrollit të armëve të zjarrit, duke përfshirë edhe teknologjitë e reja, janë multidimensionale dhe kërkojnë një qasje të integruar, të koordinuar ndërinstitucionale dhe mbështetje të vazhdueshme në nivel politik, ligjor, operativ dhe shoqëror për të garantuar një menaxhim efektiv dhe të qëndrueshëm të armëve dhe eksplozivëve në vend.

3. Vizioni i Strategjisë

3.1 Vizioni

Brenda vitit 2030, Republika e Shqipërisë do të jetë një vend me një mjedis të sigurt dhe me kapacitete gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme në përputhje me standardet më të larta të sigurisë publike dhe angazhimet ndërkombëtare për të parandaluar, identifikuar, hetuar, ndjekur penalisht dhe ndëshkuar zotërimin e paligjshëm, trafikimin dhe keqpërdorimin e armëve të vogla dhe të lehta, municioneve dhe eksplozivëve, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe ato ndërkombëtare, duke kontribuar në forcimin e rendit dhe sigurisë publike, konsolidimin e sundimit të ligjit dhe garantimin e stabilitetit kombëtar dhe rajonal.

Hartimi i një dokumenti strategjik që parashikon objektiva për të siguruar një kontroll të plotë mbi armët e vogla dhe të lehta, municionet dhe eksplozivët, duke u bazuar në nevojat kombëtare, sfidat dhe situatën e kërcënimeve të reja të sigurisë në rajon dhe standardet e BE-së, OKB-së dhe OSBE-së për:

- Reduktimin e zotërimit dhe qarkullimit të paligjshëm të armëve;
- Fuqizimin e mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit të veprimtarisë së lejuar me armë;
- Parandalimin përmes ndërgjegjësimit të publikut mbi rreziqet që lidhen me armëmbajtjen e paligjshme dhe keqpërdorimin në kontekstin e dhunës në familje ose dhunës me bazë gjinore;
- Parandalimin, zbulimin dhe goditjen e trafikimit dhe posedimit të paligjshëm të Armëve të Zjarrit, Pjesëve të tyre, Municioneve dhe Eksplozivëve;
- Parandalimin, kontrollin dhe reduktimin në mënyrë të qëndrueshme të armëve, municioneve dhe eksplozivëve jashtë kontrollit shtetëror përmes forcimit të kapaciteteve institucionale, legjislacionit, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, si dhe ndërgjegjësimit publik.

3.2 Treguesit e impaktit dhe treguesit e rezultatit

1. Niveli i harmonizimit ose i përputhshmërisë së kuadrit ligjor për kontrollin e armëve me kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian, Traktatin për Tregtinë e Armëve dhe Protokollin e Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit;
2. Niveli i rritjes së koordinimit dhe efektivitetit të politikave në fushën e AVLME, përmes numrit të akteve shqyrtuara apo koordinuara nga Komisioni Kombëtar i AVL (projekte, memorandume, marrëveshje, raporte etj.) dhe numrit të takimeve të zhvilluara nga Komisioni Kombëtar i AVL-ve për koordinimin e politikave në këtë fushë.
3. Niveli i zbatimit nga organet e rendit, si dhe përgjigjja e shërbimeve të prokurorisë dhe gjyqësorit në lidhje me incidente/ngjarje që përfshijnë armë, municione dhe eksplozivë.
4. Numri i rasteve dhe sasia e armëve, municioneve dhe eksplozivëve të sekuestruara brenda territorit.
5. Numri i rasteve të raportuara dhe sasia e armëve, municioneve dhe eksplozivëve të sekuestruara në kufi.
6. Numri i licencave të eksportit nga të cilat armë dhe municione janë identifikuar si të devijuara përmes procedurës së kontrollit pas dërgesës.

7. Përqindja e konsolidimit të kapaciteteve njerëzore dhe logjistike të Njësisë Qendrore të Armëve të Zjarrit.

8. Niveli i bashkëpunimit operativ, referuar në përqindje në luftën kundër krimeve që lidhen me armët e zjarrit midis autoriteteve shqiptare dhe ato në rajon, Shtetet Anëtare të BE-së dhe agjencitë ndërkombëtare.

9. Numri i ngjarjeve dhe viktimave që përfshijnë armë dhe eksplozivë, të ndara sipas gjinisë dhe moshës.

10. Numri i armëve, municioneve dhe eksplozivëve të dorëzuara vullnetarisht, si dhe armëve të legalizuara apo të çaktivizuara.

11. Numri i armëve, municioneve dhe eksplozivëve të raportuara (të konfiskuara, të dorëzuara vullnetarisht ose tepricë) që janë shkatërruar sistematikisht.

12. Numri i armëve, municioneve dhe eksplozivëve në pronësi të: 1. Institucioneve; 2. subjekteve private juridike; dhe 3. civilëve, të raportuara si të humbura ose të vjedhura.

13. Niveli i përmirësimit sigurisë fizike të depove të ruajtjes/magazinimit të armatimit.

3.3 Metodologjia

Strategjia Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2025–2030 përbën një dokument strategjik të rëndësishëm që lidhet ngushtë me procesin e integrimit evropian të Shqipërisë dhe me angazhimin për të forcuar shtetin e së drejtës, sigurinë publike dhe stabilitetin rajonal. Ministria e Punëve të Brendshme, në rolin e institucionit lider për hartimin dhe monitorimin e politikave në fushën e rendit dhe sigurisë publike është përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit të hartimit të dokumentit strategjik dhe anekseve shoqëruese si dhe koordinimit mes të gjithë institucioneve të tjera.

Ministri i Punëve të Brendshme miratoi urdhrin nr. 6, datë 14.1.2025, *"Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e strategjisë kombëtare për kontrollin e armëve të vogla e të lehta, municioneve dhe eksplozivëve 2025–2030 dhe planit të saj të veprimit 2025–2028"*. Grupi ndërinstitucional i punës u kryesua nga Zëvendësministri i Punëve të Brendshme përgjegjës për politikat dhe strategjitë në fushën e kontrollit të armëve të vogla e të lehta, municioneve dhe eksplozivëve dhe në përbërje kishte përfaqësues nga struktura përgjegjëse për politikat, buxhetin, programimin, standardizimin dhe harmonizimin e kuadrit rregullator në Ministrinë e Punëve të Brendshme, strukturat përgjegjëse në Policinë e Shtetit.

Në mbledhjet e grupit ndërinstitucional të punës u ftuan të marrin pjesë për të kontribuar në hartimin e dokumentit strategjik, në përputhje me funksionet dhe përgjegjësitë institucionale, anëtarët e Komisionit Kombëtar të Armëve të Vogla e të Lehta të krijuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 69 prot., datë 22.5.2017, "Për ngritjen e Komisionit Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL)" dhe përfaqësues nga institucione të tjera që ngarkohen për zbatimin e masave dhe aktiviteteve që parashikon kjo strategji.

Kjo strategji është hartuar në përputhje me metodologjinë e **Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030**, duke përfaqësuar parimet e qeverisjes së mirë, zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e social dhe forcimit të institucioneve demokratike. Lidhja e saj me reformat në drejtësi, luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit është e drejtpërdrejtë dhe thelbësore për përmbushjen e kritereve të kapitujve 1 "Lëvizja e lirë e mallrave", 24 "Drejtësia, Liria dhe Siguria" dhe 31 "Politikat e Jashtme, të Sigurisë dhe Mbrojtjes", të *acquis*-it të Bashkimit Evropian, veçanërisht në fushat që lidhen me kontrollin e armëve, mbikëqyrjen kufitare dhe ndalimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.

Në përmbajtje, kjo strategji synon reduktimin e ndjeshëm të qarkullimit dhe posedimit të paligjshëm të armëve, municioneve dhe eksplozivëve në Shqipëri, përmes masave të integruara që përfshijnë përmirësimin e kuadrit ligjor, forcimin e bashkëpunimit institucional dhe ndërkombëtar, zhvillimin e kapaciteteve teknike e njerëzore dhe zbatimin e mekanizmave të monitorimit e raportimit. Strategjia orienton veprimet ndërinstitucionale për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga dokumente ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, si Traktati për Tregtinë e Armëve, Protokolli i OKB-së për Armët e Zjarrit, Programi i Veprimit i OKB-së për Armët e Vogla dhe të Lehta, si dhe standardet e përcaktuara nga BE, OSBE dhe Udhërrëfyesi Rajonal për Kontrollin e Armëve të Vogla e të Lehta për Ballkanin Perëndimor për periudhën 2025–2030.

Në këtë mënyrë, Strategjia kontribuon drejtpërdrejt në zbatimin e **Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm, nr. 16** të Agjendës 2030 të OKB-

së, duke synuar krijimin e një shoqërie paqësore, të drejtë dhe me institucione efektive. Më specifikisht, dokumenti është i lidhur ngushtë edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara 5. 16.1, 16.4, 16.6, 16.a që synojnë:

- uljen e ndjeshme e të gjitha formave të dhunës dhe numrit të vdekjeve që lidhen me të;
- uljen e ndjeshme deri në vitin 2030, të flukseve të paligjshme financiare dhe të armëve, forcimin e rikuperimit dhe kthimit të aseteve kriminale dhe lufta ndaj të gjitha formave të krimit të organizuar;
- zhvillimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet.
- forcimin e institucioneve përkatëse kombëtare, përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për ndërtimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin.

Strategjia është konceptuar si një instrument i zbatueshëm, në përputhje me dokumentet ndërkombëtare si Traktati i Tregtisë së Armëve, Protokolli i OKB-së për Armët e Zjarrit, Programin e Veprimit dhe Instrumentit Ndërkombëtar të Gjurmimit të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Çështjen e Çarmatimit, Dokumentin për Armët e Vogla dhe të Lehta e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Traktatin e Tregtisë së Armëve, Protokollin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër Prodhimit të Paligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Vogla dhe të Lehta, si dhe Kodin e Sjelljes të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë mbi Aspektet Politiko-Ushtarake të Sigurisë. Në veçanti, ajo parashikon objektiva specifikë që synojnë uljen e dhunës, reduktimin e flukseve të paligjshme të armëve dhe forcimin e kapaciteteve për parandalimin e krimeve dhe terrorizmit. Lidhja e saj me Programin e Qeverisë 2021–2025, kreu "Shqipëria e sigurt" është po ashtu e drejtpërdrejtë duke mbështetur ndërtimin e një Shqipërie të sigurt, ku qytetarët dhe investitorët ndihen të mbrojtur dhe besimi në institucionet publike rritet ndjeshëm.

Përmes një plani veprimi të detajuar që do të përfshijë objektiva të matshëm dhe tregues konkretë, kjo strategji do të mundësojë monitorimin dhe vlerësimin e progresit në nivel kombëtar dhe vendor. Zbatimi i saj do të kërkojë koordinim të ngushtë ndërinstitucional dhe mbështetje të vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë duke garantuar përdorim efikas të burimeve dhe rezultate të prekshme në fushën e sigurisë. Në thelb, Strategjia Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2025–2030, përfaqëson angazhimin e Shqipërisë për të qenë një partner i besueshëm në promovimin e paqes, stabilitetit dhe sundimit të ligjit, si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar.

Ajo ndërthur prioritetet kombëtare me angazhimet rajonale, përmes masave konkrete në kontrollin, gjurmueshmërinë dhe menaxhimin e armëve, si dhe bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar. Kjo përputhje garanton një qasje të qëndrueshme dhe të koordinuar, në përputhje me standardet e BE-së dhe qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Strategjia është hartuar sipas metodologjisë së formatit të sistemit informatik të planifikimit të integruar IPSIS miratuar me vendimin nr. 290, datë 11.4.2020*, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar", i ndryshuar,* që përfaqëson standardin kombëtar për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit në Shqipëri. Ky format siguron një strukturë të unifikuar, të harmonizuar dhe të integruar me kuadrin më të gjerë të planifikimit strategjik të shtetit shqiptar, duke mundësuar lidhjen vertikale dhe horizontale ndërmjet strategjive sektoriale dhe prioriteteve kombëtare, si dhe ndërmjet objektivave afatgjatë dhe masave konkrete të zbatimit. Përmes IPSIS, strategjia garanton transparencë dhe përafrim me buxhetimin afatmesëm, monitorim të rregullt të progresit përmes indikatorëve të matshëm dhe mekanizmave të raportimit të standardizuar dhe strukturën e planifikimit të nevojshme për përmbushjen e kërkesave të Bashkimit Evropian.

Hartimi i Strategjisë është planifikuar si pjesë përbërëse e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2025, duke reflektuar angazhimin e Qeverisë së Shqipërisë për të adresuar në mënyrë të strukturuar dhe të koordinuar sfidat që lidhen me kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta, municioneve dhe eksplozivëve.

Gjatë procesit të hartimit të Strategjisë është ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse, transparente dhe e bazuar në parimet e pjesëmarrjes demokratike sipas formatit dhe metodologjisë së IPSIS, e cila luan një rol kyç në

mbështetjen teknike dhe koordinimin rajonal të Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve të Shqipërisë. Kjo metodologji garanton hartimin dhe zbatimin e strategjive në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke siguruar që politika kombëtare të jetë e harmonizuar dhe e koordinuar me praktikat më të mira në rajon. Një element thelbësor i këtij procesi është **zhvillimi i konsultimi publik të strukturuar**, që ka përfshirë qytetarët, shoqërinë civile, grupet e interesit, organizatat e specializuara dhe institucionet publike që kanë rol në fushën e sigurisë, kontrollit të armëve dhe sundimit të ligjit ku mund të përmendim SEESAC, UNDP, UNODC dhe OSCE. Këto konsultime kanë ndihmuar në identifikimin e prioriteteve kombëtare, në përmirësimin e draftit të strategjisë dhe në garantimin e një baze të gjerë konsensusi për masat e propozuara. Gjithashtu, procesi i konsultimit publik është zhvilluar në përputhje me **kornizën e transparencës dhe pjesëmarrjes së parashikuar nga legjislacioni shqiptar**, duke mundësuar komente, sugjerime dhe rekomandime nga publiku i gjerë dhe partnerët socialë nëpërmjet platformave elektronike dhe komunikimeve zyrtare. Kjo ka garantuar një **qasje të integruar dhe praktike në hartimin e strategjisë**, duke reflektuar realisht nevojat dhe sfidat aktuale.

Strategjia e re gjithashtu u hartua referuar gjetjeve të raporteve të monitorimit në zbatimin e Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla e të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019–2024, të cilat tregojnë një progres të moderuar në përmbushjen e objektivave strategjikë, me theks të veçantë në përmirësimin e kuadrit ligjor, forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, si dhe ndërgjegjësimin publik për rrezikun që paraqet posedimi i paligjshëm i armëve. Strategjia u hartua referuar edhe vlerësimit kombëtar të kërcënimit nga krimi i rëndë dhe i organizuar (SOCTA). Megjithatë, raportet evidentojnë nevojën për një qasje më të integruar në zbatim, përmirësim të kapaciteteve të mbledhjes dhe analizës së të dhënave, si dhe intensifikimin e masave parandaluese dhe operative ndaj trafikimit dhe shpërndarjes së armëve të paligjshme. Këto gjetje shërbejnë si bazë orientuese për hartimin e Strategjisë së re 2025–2030, duke synuar një qasje më të qëndrueshme, të matshme dhe të koordinuar me prioritetet e sigurisë kombëtare dhe standardet e Bashkimit Evropian.

3.4 Parimet e përgjithshme

Në funksion të ndërtimit të një qasjeje të integruar dhe të qëndrueshme ndaj kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta dhe materialeve shpërthyese, Strategjia Kombëtare mbështetet në një sërë parimesh udhëheqëse, të cilat garantojnë legjitimitetin, efektivitetin dhe përputhshmërinë e saj me kuadrin kushtetues dhe ndërkombëtar. Struktura dhe përmbajtja e këtij dokumenti bazohen në këto parime:

Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë – Të gjitha masat dhe ndërhyrjet e parashikuara në kuadër të kësaj strategjie bazohen në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në legjislacionin kombëtar në fuqi, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare dhe instrumentet ligjore të ratifikuara nga Shqipëria. Kjo garanton që zbatimi i politikave të kontrollit të AVL-ve dhe eksplozivëve të realizohet në përputhje të plotë me parimet e shtetit të së drejtës, legjitimitetin demokratik dhe angazhimet ndërkombëtare të vendit.

Parimi i sigurisë shtetërore – Kontrolli i AVL-ve, municioneve dhe eksplozivëve përbën një komponent strategjik të sigurisë kombëtare dhe të funksionimit të shtetit të së drejtës. Menaxhimi efektiv i këtyre elementeve mbështet ruajtjen e rendit publik, mbron tërësinë territoriale dhe forcon besimin e qytetarëve në institucionet e sigurisë. Ky parim afirmon se siguria e brendshme është një parakusht për zhvillim të qëndrueshëm, klimë të favorshme për investime dhe konsolidim të demokracisë.

Parimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut – Respektimi dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përbën një element të pandashëm të politikave të kontrollit të armëve. Masat e parashikuara synojnë të garantojnë mbrojtjen e të drejtave individuale, të dhënave personale dhe identitetit të çdo qytetari, pa diskriminim mbi bazën e gjinisë, moshës, etnisë, besimit fetar apo orientimit seksual. Fëmijët dhe të rinjtë gëzojnë mbrojtje të veçantë në funksion të krijimit të një mjedisi të sigurt dhe të lirë nga rreziqet që lidhen me armatosjen e jashtëligjshme.

Parimi i përgjegjësisë – Strategjia njeh se suksesi i saj nuk mund të arrihet vetëm përmes ndërhyrjes së institucioneve shtetërore, por kërkon

një angazhim të përbashkët të të gjithë aktorëve relevantë, përfshirë shoqërinë civile, sektorin privat, median, komunitetin akademik dhe publikun e gjerë. Ky parim thekson rëndësinë e ndarjes së përgjegjësisë në edukimin, parandalimin dhe ndërgjegjësimin mbi rreziqet që paraqet zotërimi dhe përdorimi i paligjshëm i armëve dhe eksplozivëve.

Parimi i gjithëpërfshirjes – Përballimi i rreziqeve që lidhen me AVL-të dhe materialet shpërthyese kërkon një qasje gjithëpërfshirëse që angazhon të gjitha nivelet e qeverisjes dhe aktorët ndërsektorialë. Strategjia nxit bashkërendimin ndërinstitucional dhe përfshirjen aktive të pushtetit vendor, institucioneve të arsimit, drejtësisë, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale, për të garantuar një përgjigje të koordinuar dhe të qëndrueshme ndaj kërcënimeve të natyrës shumëdimensionale.

Parimi i bashkëpunimit ndërkombëtar – Në një kontekst të globalizuar të kërcënimeve të sigurisë, bashkëpunimi ndërkombëtar përbën një shtyllë kyçe për suksesin e strategjisë. Shqipëria mbetet e angazhuar për të bashkëpunuar me partnerët rajonalë, organizatat ndërkombëtare dhe nismat multilaterale në fushën e kontrollit të armëve, për të siguruar harmonizimin e standardeve, shkëmbimin e informacionit, ndërtimin e kapaciteteve dhe adresimin e përbashkët të sfidave që lidhen me trafikimin, qarkullimin e paligjshëm dhe keqpërdorimin e AVL-ve dhe eksplozivëve.

PJESA II
QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË

QËLLIMI I POLITIKËS 1: Brenda vitit 2030, të garantohet miratimi i legjislacionit të harmonizuar për kontrollin e armëve, në përputhje me kuadrin rregullator të BE-së dhe detyrimet ndërkombëtare, si dhe standardizimi i tij në të gjithë territorin shqiptar.

Aktivitetet në kuadër të këtij qëllimi

Gjatë periudhës 2025–2030, synohet të plotësohet dhe të rishikohet rregullisht kuadri ligjor për kontrollin dhe menaxhimin e armëve, eksplozivëve dhe mallrave me përdorim të dyfishtë, duke garantuar përputhshmërinë dhe standardizimin e tij me kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian dhe detyrimet ndërkombëtare. Ky proces do të përfshijë rregullimin e prodhimit, tregtimit dhe mbajtjes së armëve dhe eksplozivëve për përdorim civil, si dhe forcimin e masave për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të paligjshëm të armëve, eksplozivëve (duke përfshirë artikujt piroteknikë) dhe prekursorët e eksplozivëve. Gjithashtu, do të sigurohet zbatimi i standardeve më të larta të sigurisë dhe kontrollit për pajisjet ushtarake dhe mallrat me përdorim të dyfishtë, duke rritur bashkëpunimin me autoritetet ndërkombëtare dhe forcuar kapacitetet e institucioneve kombëtare për mbikëqyrjen dhe zbatimin e legjislacionit përkatës. Gjatë periudhës vijuese 2025–2030 do të synohet përafrimi i legjislacionit penal, legjislacioni për armët sinjalizuese dhe alarmuese, legjislacioni për eksportin e armëve të vogla e të lehta, si dhe ndryshimi i dispozitave përkatëse kur konsiderohet e nevojshme.

Objektivi specifik 1.1: Miratimi i kuadrit të plotë ligjor për të luftuar të gjitha format e keqpërdorimit, trafikimit dhe zotërimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve (AME) dhe harmonizimi me kuadrin ligjor të BE- së dhe OKB-së.

Objektivi specifik 1.2: Përafrimi me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, me qëllim përmirësimin e reagimit të drejtësisë penale në fushën e kontrollit të armëve dhe në hetimet që lidhen me veprat penale me armë zjarri.

QËLLIMI I POLITIKËS 2: Brenda vitit 2030, të garantohen politika dhe praktika efektive për kontrollin e armëve në Shqipëri, të bazuara në analiza statistikore dhe të udhëhequra nga informacionet e inteligjencës, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe detyrimet përkatëse.

Aktivitetet në kuadër të këtij qëllimi

Gjatë periudhës 2025–2030, synohet të zhvillohen dhe të harmonizohen strategjitë dhe planet e veprimit për kontrollin e armëve, dhe eksplozivëve në përputhje me Udhërrëfyesin e rishikuar Rajonal për kontrollin e armëve të vogla e të lehta për Ballkanin Perëndimor. Politikat e kontrollit të armëve do të integrojnë plotësisht çështjet e gjinisë dhe moshës, duke siguruar përfshirjen aktive të grave në proceset e vendimmarrjes dhe politikëbërjes. Një prioritet kyç do të jetë standardizimi dhe institucionalizimi i regjistrimit dhe grumbullimit të të dhënave mbi armët, dhe eksplozivët, të ndara sipas gjinisë dhe moshës, për të përmirësuar analizën dhe hartimin e

politikave të bazuara në prova. Njëkohësisht do të forcohen funksionet e planifikimit, koordinimit dhe monitorimit të Komisioneve për AVL-të, për të garantuar politika efektive dhe të qëndrueshme. Një aspekt thelbësor do të jetë edhe gjurmimi i çdo arme të mbledhur ose të kapur, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, për të parandaluar trafikimin dhe keqpërdorimin e tyre, si dhe nënshkrimit të marrëveshjeve dypalëshe ose rajonale në lidhje me shkëmbimin e informacionit balistik, sidomos me shtetet e Ballkanit Jugperëndimor, në kushtet kur është në përdorim i njëjti sistem, EVOFINDER. Gjithashtu do ti kushtohet vëmendje dhe trajnimit specifik të punonjësve të policisë që merren me trajtimin e provave materiale balistike, që nga gjetja dhe deri tek ekzaminimi i tyre.

Objektivi specifik 2.1: Standardizimi dhe institucionalizimi i grumbullimit të të dhënave për armët e zjarrit sipas gjinisë dhe moshës, në lidhje me sekuestrimet e AVLME-ve të ligjshme dhe të paligjshme, incidentet e dhunshme me armë, provat balistike dhe të dhëna të tjera që lidhen me armët e zjarrit që çojnë në analizën rajonale periodike të rrezikut për AVLME dhe vlerësimin e kërcënimit.

Objektivi specifik 2.2: Rritja e nivelit të koordinimit dhe monitorimi i vazhdueshëm i strategjisë dhe planit të veprimit nga Komisioni Kombëtar i AVL për të garantuar politika efektive për parandalimin, zbutjen, reagimin dhe eliminimin e keqpërdorimit, trafikimit dhe përhapjes së paligjshme të armëve të zjarrit.

Objektivi specifik 2.3: Institucionalizimi i mbledhjes sistematike të të dhënave për drejtësinë penale dhe gjurmimit të AVLME-ve

Objektivi specifik 2.4: Integrimi i plotë i çështjeve gjinore dhe moshës në politikat për kontrollin e AVLME-ve duke garantuar pjesëmarrjen reale të grave në kontrollin e AVLME-ve.

Objektivi specifik 2.5: Rritja e parandalimit të keqpërdorimit të AVLME-ve.

QËLLIMI I POLITIKËS 3: Brenda vitit 2030, të reduktohet keqpërdorimi dhe prodhimi, zotërimi dhe qarkullimi i paligjshëm i armëve, municioneve dhe eksplozivëve përmes forcimit të kuadrit ligjor, rritjes së kapaciteteve institucionale dhe zbatimit efektiv të masave parandaluese dhe kontrolluese.

Aktivitetet në kuadër të këtij qëllimi

Gjatë periudhës 2025–2030, synohet forcimi i sistemit të analizës së rrezikut, kontrollit, monitorimit dhe parandalimit të devijimit të tregtisë së ligjshme të armëve, municioneve dhe eksplozivëve, përmes përmirësimit të kapaciteteve institucionale, procedurave dhe transparencës. Do të parashikohen dhe ndërmerren masa për parandalimin dhe luftimin e trafikimit, keqpërdorimit, prodhimit dhe mbajtjes së paligjshme të këtyre materialeve, duke forcuar pajisjet, procedurat dhe trajnimin e autoriteteve ligjzbatuese dhe subjekteve të drejtësisë penale. Një prioritet kyç do të jetë rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe forcimi i mekanizmave dhe platformave të bashkëpunimit bilateral dhe rajonal, duke garantuar ndarjen e inteligjencës dhe shkëmbimin sistematik të informacionit në kohën e duhur për të luftuar në mënyrë më efektive aktivitetet e paligjshme që lidhen me armët, municionet dhe eksplozivët.

Objektivi specifik 3.1: Garantimi i zbatimit të plotë dhe monitorimi i kuadrit ligjor, politik dhe procedural për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e armëve të vogla dhe të lehta, municioneve dhe eksplozivëve.

Objektivi specifik 3.2: Parandalimi i trafikimit (kontrabanda, tregtia dhe tranziti i paligjshëm) i AVLME-ve nëpërmjet proceseve dhe pajisjeve të përmirësuara dhe trajnimit të njësive të synuara ligjzbatuese.

Objektivi specifik 3.3: Forcimi i kontrollit, monitorimit dhe parandalimit të devijimit të tregtisë së ligjshme nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve, procedurave dhe transparencës.

QËLLIMI I POLITIKËS 4: Brenda vitit 2030, të reduktohet ndjeshëm oferta, kërkesa, zotërimi i paligjshëm dhe keqpërdorimi i armëve, municioneve dhe eksplozivëve përmes masave efektive parandaluese, forcimit të kornizës ligjore dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

Aktivitetet në kuadër të këtij qëllimi

Gjatë periudhës 2025–2030, synohet rritja e ndërgjegjësimit dhe përgjegjshmërisë së subjekteve të licencuara private dhe juridike, përfshirë prodhuesit, tregtarët, ndërmjetësit, koleksionuesit dhe shoqëritë e transportit, lidhur me rrezikun e keqpërdorimit, përhapjes së paligjshme dhe devijimit të armëve, municioneve dhe eksplozivëve. Në të njëjtën kohë, synohet forcimi i besimit të publikut tek institucionet e sigurisë dhe krijimi i partneriteteve të qëndrueshme për të rritur

advokimin dhe informimin. Edukimi i popullsisë mbi rreziqet e armëve, me fokus të veçantë në parandalimin e dhunës ndaj grave, vajzave dhe dhunës me bazë gjinore, si dhe angazhimi i të rinjve në programe ndërgjegjësuese janë masa thelbësore për reduktimin e keqpërdorimit të armëve. Po ashtu, fuqizimi i rolit të medias për raportim të përgjegjshëm dhe promovimi i legalizimit dhe dorëzimit vullnetar të armëve janë mjete të rëndësishme për reduktimin e zotërimit të paligjshëm dhe keqpërdorimit të tyre.

Objektivi specifik 4.1: Rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve të licencuara private dhe juridike për rrezikun e keqpërdorimit dhe përhapjes së paligjshme të AVLME-ve, përfshirë rrezikun e devijimit për prodhuesit e AVLME-ve.

Objektivi specifik 4.2: Zhvillimi i partneriteteve të qëndrueshme me median dhe shoqërinë civile për promovimin e kontrollit, rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin e publikut, për rrezikun e keqpërdorimit, mbajtjes së paligjshme dhe trafikimit të AVLME-ve.

Objektivi specifik 4.3: Rritja e kapaciteteve administrative dhe operacionale për sekuestrimin e armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve.

Objektivi Specifik 4.4: Përdorimi sistematik i çaktivizimit, dorëzimit vullnetar dhe/ose legalizimit si metoda për uljen e mbajtjes së paligjshëm të armëve të zjarrit.

QËLLIMI I POLITIKËS 5: Brenda vitit 2030, të reduktohet rreziku i përhapjes dhe devijimit të armëve, municioneve dhe eksplozivëve përmes forcimit të masave të mbrojtjes dhe sigurisë së stoqeve, si dhe zbatimit të proceseve efektive për asgjësimin e tyre.

Aktivitetet në kuadër të këtij qëllimi

Gjatë periudhës 2025–2030 synohet reduktimi sistematik i tepricave të armëve të vogla dhe të lehta municioneve dhe eksplozivëve përmes shkatërrimit të sigurt dhe mjedisor të qëndrueshëm, si dhe metodave të tjera efektive. Gjithashtu, synohet asgjësimi i rregullt, i sigurt dhe transparent i armëve, municioneve dhe eksplozivëve të konfiskuara ose të krijuara stok. Për të siguruar një menaxhim të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm, do të forcohen kapacitetet institucionale për menaxhimin e ciklit të jetës së AVLME dhe municioneve. Në këtë kuadër, do të garantohen mjedise të sigurta magazinimi, të përshtatura sipas nevojave të identifikuara dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Objektivi specifik 5.1: Shkatërrimi sistematik i stoqeve të tepërta të AME-ve në një mënyrë jo të dëmshme për mjedisin.

Objektivi specifik 5.2: Të kryhet shkatërrimi i AVLME-ve të konfiskuara në mënyrë periodike në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Objektivi specifik 5.3: Garantimi i mjediseve të sigurta të magazinimit për AVLME, të projektuara sipas nevojave të identifikuara dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Objektivi specifik 5.4: Ngritja e kapaciteteve të subjekteve juridike përkatëse (prodhues, dyqane riparimi, dyqane shitjeje me pakicë, tregtuesit, poligonet e qitjes, poligonet e gjuetisë, shoqëritë private të sigurisë, qendrat e trajnimit) për të përcaktuar sistemet e inspektimit.

PJESA III
PROJEKTET NË MBËSHTETJE TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Projekti 1: Forcimi i masave të sigurisë në kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta në Shqipëri – Projekt vijues

Institucioni zbatues: SEESAC

Përfitues: Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë; Policia e Shtetit

Donator: Zyra për Heqjen e Armëve dhe Zbutjen e Pasojave, pranë Byrosë për Çështje Politiko-Ushtarake të Departamentit të Shtetit Amerikan (PM/WRA)

Kohëzgjatja e projektit: 20 shtator 2022–19 janar 2026

Vlera totale e financimit: 1,250,000 USD

Pezulluar nga donatori në vitin 2025

Ky projekt synon të forcojë masat e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL), përmes përmirësimit të sigurisë fizike, rritjes së përgjegjshmërisë dhe standardizimit të menaxhimit të stokut në depozitat nën administrimin e Policisë së Shtetit. Ndër ndërhyrjet kryesore përfshihet përdorimi i një sistemi të avancuar me barkod për administrimin dhe gjurmimin e armëve në depozitat qendrore në Mullet, si dhe përmirësimi i masave të sigurisë në trembëdhjetë ambiente prioritare të ruajtjes së provave dhe armëve në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto masa synojnë të adresojnë standardet ndërkombëtare për ruajtjen dhe kontrollin e armëve dhe municioneve. Zbatimi i projektit kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin

e sigurisë kombëtare dhe rajonale, duke reduktuar rrezikun e përhapjes së pakontrolluar të armëve, shpërthimeve aksidentale dhe përdorimit të tyre në veprimtari kriminale. Brenda kornizës së Planit të Veprimit për AVL në Ballkanin Perëndimor, projekti adreson Objektivin Strategjik nr. 5 "Të reduktohet rreziku i përhapjes dhe devijimit të armëve, municioneve dhe eksplozivëve përmes forcimit të masave të mbrojtjes dhe sigurisë së stoqeve, si dhe zbatimit të proceseve efektive për asgjësimin e tyre". Në përputhje me këtë, është synuar rritja e numrit të strukturave të ruajtjes të cilat i plotësojnë standardet ndërkombëtare të sigurisë.

Deri në tetor 2024, janë kryer vlerësime të detajuara teknike në shumicën e ambienteve të identifikuara për ndërhyrje, ndërkohë që janë zbatuar hapat për realizimin e përmirësimeve të sigurisë.

Gjithashtu është finalizuar zhvillimi dhe testimi i modulit të barkodit nga ekspertë IT të projektit në bashkëpunim me ekspertët e caktuar nga përfituesi. Trajnimi për operatorët e magazinës së Mulletit është kryer në nëntor 2024, ndërsa pajisjet teknologjike janë prokuruar në gusht 2024.

Pas përgatitjes së Termave të Referencës për angazhimin e një kompanie profesionale për hartimin dhe mbikëqyrjen e ndërhyrjeve të sigurisë në të gjitha lokacionet përkatëse, si dhe për zhvillimin e moduleve të reja të sistemit SIMA, me tenderimin e planifikuar për dhjetor 2024, financimi u ndërpre për shkak të pezullimit të financimit nga Departamenti Amerikan i Shtetit dhe do të vijojë përmes implementimit nga UNDP Albania.

Me Vendimin e Këshillit (CFSP) 2024/3006, të 2 dhjetorit 2024, në mbështetje të aktiviteteve të SEESAC për çarmatimin dhe kontrollin e armëve në Evropën Juglindore, duke zvogëluar kërcënimin e armëve të vogla dhe të lehta (AVL) të paligjshme dhe municioneve të tyre është miratuar edhe fondi prej 3999920,60 euro për përmbushjen e detyrimeve dhe realizimin e politikave në fushën e kontrollit të armëve të vogla e të lehta në vendet e Ballkanit Perëndimor, Moldavisë dhe në mënyrë më të kufizuar për Ukrainën.

Mbështetja me këto fonde përfshirë Shqipërinë lidhet me këto komponentë:

Lehtësimi i bashkëpunimit rajonal dhe mbështetja për hartimin e politikave të bazuara në evidenca mbi kontrollin e AVL-ve, duke kontribuar kështu më tej në uljen e kërcënimit të përhapjes së paligjshme të AVL-ve.

Në mënyrë specifike, projekti parashikon lehtësimin e bashkëpunimit rajonal dhe mbështetjen e hartimit të politikave të bazuara në prova në kontrollin e AVL-ve përmes:

- takimeve rajonale të Komisioneve të AVL-ve (dy herë në vit), duke u përqendruar në shkëmbimin e informacionit dhe ndarjen e njohurive mbi politikat e kontrollit të armëve, si dhe standardizimin e tyre;
- takimeve rajonale të SEEFEN (një herë në vit) duke u përqendruar në shkëmbimin operacional të informacionit dhe bashkëpunimin ndërkufitar në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit;
- ofrimit të asistencës teknike dhe mbështetjes sipas kërkesës për Komisionet e AVL-ve dhe SEEFEN me qëllim përmirësimin e zhvillimit, hartimit, miratimit dhe zbatimit të politikave;
- mbështetjes sipas kërkesës për harmonizimin e legjislacionit për kontrollin e armëve për ndryshimet përkatëse në lidhje me legjislacionin e BE-së mbi kontrollin dhe standardizimin e armëve në të gjithë rajonin;
- mbështetjes për mbledhjen dhe analizën e të dhënave të AVL-ve;
- integrimin e perspektivës gjinore në hartimin e politikave për kontrollin e AVL-ve;
- mirëmbajtjes së platformave *online* të shkëmbimit të informacionit dhe përmirësimit të saj përmes zhvillimit të produkteve analitike sipas kërkesës, të rëndësishme për politikat në fushën e AVL.

Mbështetje e mëtejshme për ndërtimin e kapaciteteve të autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe atyre kufitare në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të paligjshëm të armëve dhe eksplozivëve përmes:

- zhvillimit të Procedurave Standarde të Veprimit dhe ofrimit të trajnimit për menaxhimin kufitar në luftimin e trafikimit të paligjshëm të armëve në mbështetje të autoriteteve doganore në vendet e Ballkanit Perëndimor;
- ofrimit të pajisjeve dhe trajnimit për policinë kufitare dhe kriminale në luftimin e trafikimit të paligjshëm të armëve në mbështetje të autoriteteve të policisë kufitare dhe kriminale.

Përmirësimi i kapaciteteve për sigurinë fizike dhe menaxhimin e stoqeve të armatimit përmes përmirësimeve të sigurisë së infrastrukturës, reduktimit të tepricave të stokut të armatimit dhe

trajnimit të personelit që angazhohet në menaxhimin e tyre:

Aktivitetet kryesore të parashikuara janë:

- mbështetje për sigurinë e shtuar të dhomave të provave/magazinave të AVL-ve të policisë/autoritetit të brendshëm përmes përmirësimeve të infrastrukturës së tyre;

- mbështetje për shkatërrimin e AVL-ve të tepërta dhe/ose të konfiskuara;

- ofrim i mbështetjes për sistemet e menaxhimit të rezervave dhe inspektimit.

Projekti 2: Qasje Institucionale e integruar dhe forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar për kontrollin e AME (faza I)

Institucioni zbatues: UNDP Shqipëri

Periudha e zbatimit: 1 dhjetor 2023–30 nëntor 2025

Përfitues: Policia e Shtetit Shqiptar

Donator: Fondi i Besuar me Shumë Partnerë (*Multi-Partner Trust Fund*)

Financimi total: 1,205,490 USD

Qëllimi i Projektit: Të ofrojë mbështetje dhe pajisje për Policinë Kufitare, Institutin e Policisë Shkencore dhe Njësinë e Hetimit të Vendit të Ngjarjes të Kukësit. Projekti synon gjithashtu të forcojë bashkëpunimin ndërkufitar dhe shkëmbimin policor ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës në fushën e kontrollit të AVL-ve, përmes aktiviteteve të përbashkëta me UNDP Kosovë.

Objektiva dhe synime strategjike të Udhërrëfyesit Rajonal (*Roadmap*):

- Zbatimi i politikave të bazuara në të dhëna dhe inteligjencë;

- Reduktimi i qarkullimit të paligjshëm të armëve, municioneve dhe eksplozivëve;

- Rritja e numrit të sekuestrimeve dhe asgjësimeve;

- Rritja e ndërgjegjësimit për rreziqet nga armët dhe dhuna në bazë gjinore;

- Garantimi i ruajtjes së sigurt të armëve dhe municioneve.

Aktivitete të zbatuara deri në vitin 2024:

- Trajnime të përbashkëta me Kosovën për policimin komunitar, kontrollin e AVL-ve, eksplozivët dhe kornizat ligjore;

- Zhvillimi dhe validimi i kurrikulës kombëtare të trajnimit për AVL;

- Pajisja e Policisë Kufitare me mjete teknologjike (kamera termike, skanerë, etj.);

- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese dhe ngritja e kapaciteteve të zyrave për media dhe informim publik;

- Vizita studimore në CEPOL dhe agjencitë forensike në Kroaci.

- Furnizimi me pajisje për patrullimet në kufirin e gjelbër;

- Pajisje hetimore të specializuara për AVL për Institutin e Policisë Shkencore Shqiptare.

Për vitin 2025–2026 nga Fondi i Besimit Shumëpalësh projektit "Qasja e Integruar Institucionale dhe Forcimi i Bashkëpunimit Ndërkufitar për Kontrollin e AVL-ve (faza I)", i cili zbatohet nga UNDP Albania, i është akorduar një financim shtesë prej 350,000 dollarë amerikanë për disa prej nevojave prioritare të identifikuara nga Komisioni i Kombëtar i Armëve të Vogla e të Lehta në Shqipëri si më poshtë:

- mbështetja e (ri)ndërtimit të sistemit elektronik të regjistrimit të armëve në Shqipëri, sistemi SIMA me qëllim qëndrueshmërinë ndaj sulmeve kibernetike në sistemet e përdorura nga Policia e Shtetit, bazuar edhe në mbështetjen që Fondi të Mirëbesimit Shumëpalësh ka mundësuar më parë në lidhje me pajisjet dhe kartat digjitale për riregjistrimin e pronarëve të armëve.

- mbështetja e funksionalizimit të NJQAZ duke siguruar *software* për rritjen e kapaciteteve analitike siç është prioritizuar nga Komisioni i AVL-ve në Shqipëri, pajisje logjistike për NJQAZ.

Projekti 3: Ndihmë autoriteteve kombëtare të Shqipërisë për uljen e rrezikut të përhapjes dhe keqpërdorimit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL)

Institucioni zbatues: Misioni i OSBE-së në Shqipëri

Periudha e zbatimit: gusht 2021–qershor 2026

Përfitues: Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Shtetit, ministritë e linjës, media dhe qytetarët

Donatorë: Gjermania, Franca, Bashkimi Evropian

Shuma totale e financimit: 1,998,883 EUR

Mungesa në financim (gap): 422,324 EUR

Projekti i OSBE-së "Asistenca për Autoritetet Kombëtare për Reduktimin e Rrezikut nga Përhapja dhe Keqpërdorimi i Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL)" synon forcimin e kapaciteteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Shtetit përmes asistencës teknike, pajisjeve dhe ngritjes së infrastrukturës në fushën e kontrollit dhe mos-përhapjes së AVL.

Me mbështetjen e Gjermanisë, Francës dhe Bashkimit Evropian, projekti përqendrohet në tre shtylla kryesore: përmirësimin e kuadrit ligjor për çaktivizimin e armëve, modernizimin e njësive K9 për zbulimin e AVL, municioneve dhe eksplozivëve, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi rreziqet që lidhen me keqpërdorimin e armëve.

Gjatë zbatimit të projektit janë përgatitur manuale trajnimi, janë zhvilluar trajnime për çaktivizimin e armëve dhe janë integruar këto module në kurrikulat e Akademisë së Sigurisë. Po mbështetet ngritja e një qendre kombëtare për çaktivizimin e AVL dhe janë realizuar përmirësime infrastrukturore në Institutin e Trajnimit të Njësisë K9, përfshirë ndërtimin e ambienteve të reja dhe pajisjen me mjete të specializuara, si dhe zhvillimin e një Master Plani për njësitë K9. Janë organizuar, gjithashtu, vizita studimore dhe ngjarje rajonale për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira.

Një komponent i rëndësishëm i projektit është edhe ndërgjegjësimi publik. Në këtë kuadër janë zhvilluar dy fushata të mëdha kombëtare me fokus të rinjtë dhe dhuna me bazë gjinore, të cilat kanë arritur një akses nëpërmjet aktiviteteve edukative dhe mesazheve mediatike.

Gjithashtu janë realizuar aktivitete të përbashkëta me shoqërinë civile, shkollat dhe autoritetet vendore në disa qytete, si dhe janë organizuar vizita shkëmbimi me gazetarë dhe ekspertë të sigurisë për të rritur cilësinë e raportimit mbi AVL. Projekti gjithashtu ka integruar një strategji gjinore dhe materiale promovuese për nxitjen e pjesëmarrjes së grave në fushën e sigurisë.

Projekti 4: *Justitia* – Forcimi i përgjigjes së drejtësisë penale ndaj trafikimit të armëve në ballkanin perëndimor

Projekti Justitia, i zbatuar nga UNODC, është projekt vijues bazuar në iniciativën e mëparshme (2020–2023) dhe synon të rrisë kapacitetet e sistemit të drejtësisë penale në juridiksionet e Ballkanit Perëndimor për të luftuar në mënyrë efektive krimin e organizuar dhe trafikimin e paligjshëm të armëve.

Projekti fokusohet në harmonizimin e legjislacionit penal me Protokollin e Kombeve të Bashkuara mbi armët, përmirësimin e aftësive të zbatuesve të drejtësisë penale dhe nxitjen e bashkëpunimit rajonal për një përgjigje të unifikuar dhe efektive ligjore, në përputhje me qëllimet e Udhërrëfyesit Rajonal për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL).

Që nga fillimi i tij, projekti ka organizuar konferenca dhe seminare rajonale mbi harmonizimin e legjislacionit, praktikat gjyqësore dhe përdorimin e masave speciale hetimore në çështjet e armëve. Gjithashtu janë zhvilluar vizita studimore në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe institucione gjyqësore në Francë për shkëmbim eksperiencash.

Njëkohësisht janë përgatitur dhe dorëzuar materiale trajnimi për prokurorë dhe gjyqtarë, dhe është përditësuar koleksioni i rasteve gjyqësore mbi armët në juridiksionet kryesore.

Aktivitetet deri në fund të vitit 2024 kanë përfshirë takime rajonale mbi harmonizimin e legjislacionit penal, seminare të specializuara mbi jurisprudencën për armët dhe trajnim të vazhdueshëm për gjyqtarët, me qëllim forcimin e ndjekjes penale dhe gjykimit të veprave penale lidhur me armët. Projekti synon të sigurojë përgjigje të qëndrueshme dhe të harmonizuara që kontribuojnë në uljen e trafikimit të paligjshëm të armëve në Ballkanin Perëndimor.

Projekti 5: Hermes 2.1 – Luftimi i trafikimit të armëve përmes pakove postare dhe korrierëve ekspres

Projekti Hermes 2.1 synon të rrisë kapacitetet e juridiksioneve të Ballkanit Perëndimor për të zbuluar dhe parandaluar trafikimin e armëve, pjesëve të tyre dhe municioneve të transportuara përmes shërbimeve postare dhe korrierëve ekspres. Duke u bazuar në një iniciativë pilot në Bosnje dhe Hercegovinë (2020–2022) dhe fazën e parë të Hermes (2023), ky projekt përqendrohet në pajisjen e autoriteteve doganore dhe atyre postare me aftësi dhe pajisje të specializuara.

Aktivitetet kryesore përfshijnë trajnime të avancuara për operatorët e skanerëve me rreze X, seminare për njësitë analitike të doganave dhe inspektorët postare, si dhe blerjen dhe shpërndarjen e pajisjeve të specializuara për autoritetet përkatëse. Këto masa kanë për qëllim përmirësimin e kapaciteteve për zbulimin dhe bllokimin e ngarkesave të paligjshme të armëve, duke forcuar kontrollin kufitar dhe duke kontribuar në reduktimin e qarkullimit të paligjshëm të armëve në rajon.

Procesi i prokurimit për pajisjet thelbësore të skanimit ka nisur dhe aktivitetet e trajnimit dhe shpërndarjes së pajisjeve kanë vijuar deri në fund të vitit 2024. Projekti mbështet direkt objektivat e

Udhërrëfyesit Rajonal për Kontrollin e Armëve për uljen e qarkullimit të armëve të paligjshme dhe rritjen e numrit të armëve të sekuestruara në Ballkanin Perëndimor.

Projekti 6: "Siguria fizike dhe menaxhimi i depove në Shqipëri" i zbatuar nga ITF – Rritja e Sigurisë Njerëzore dhe me përfitues Policinë e Shtetit/Ministrinë Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë ka në fokus përmirësimin e sigurisë së ruajtjes së armëve, municioneve dhe eksplozivëve në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Projekti përfshin rindërtimin dhe ndërtimin e objekteve për ruajtje të përkohshme të armëve të zjarrit të sekuestruara apo grumbulluara nga njësitë vendore të Policisë së Shtetit të cilat do të magazinohen deri në dorëzimin e tyre për shkatërrim në Ministrinë e Mbrojtjes dhe sistemet përkatëse të mbrojtjes dhe sigurisë.

Projekti ka një financim total prej 390,615 USD, të siguruar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Projekti 7:" Mbështetje për forcimin e luftës kundër posedimit të paligjshëm, keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL) në Ballkanin Perëndimor".

Projekti i zbatuar nga SEESAC me financim nga IPA përmes DG NEAR/ENEST, zbatuar përgjatë viteve 2021–2024, me synim forcimin e kapaciteteve strategjike dhe operacionale të autoriteteve të Ballkanit Perëndimor për të kryer hetime mbi armët e zjarrit, si dhe për të shkëmbyer informacion brenda rajonit dhe me BE-në lidhur me mbajtjen, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të vogla dhe të lehta dhe municioneve të tyre, gjithashtu, mbështetjen e autoriteteve të rajonit për të rritur reagimin ndaj faktorëve që nxisin kërkesën dhe keqpërdorimin e armëve të zjarrit në Ballkanin Perëndimor.

PJESA IV
ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

4.1 Përgjegjësia e institucioneve

Kuadri institucional nënkupton të gjithë institucionet dhe mekanizmat, qoftë në nivel qendror, varësie, me autonomi apo institucion të pavarur kushtetues, të cilët kanë rol dhe rëndësi primare apo sekondare në zbatimin e strategjisë. Ky kuadër përfshin organet shtetërore, agjencitë e specializuara, institucionet e pavarura, si dhe strukturat mbështetëse që kontribuojnë në hartimin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë. Roli i secilit institucion përcaktohet në përputhje me fushëveprimin e tij ligjor dhe përgjegjësitë funksionale në kuadër të objektivave strategjikë, si më poshtë:

Komisioni Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta është përgjegjës për hartimin e politikave mbi armët e vogla dhe të lehta në Shqipëri. Koordinon dhe mbledh informacione dhe statistika nga institucionet përkatëse për prodhimin, tregtimin, çaktivizimin, asgjësimin, përdorimin e paligjshëm të armëve, kontrollin e armëve të lejuar, kontrollin e importit dhe eksportit të armëve. Gjithashtu ai është përgjegjës të bashkërendojë, udhëzojë, monitorojë dhe të raportojë për zbatimin e politikave që lidhen me AVLME.

Ministria e Punëve të Brendshme është institucioni përgjegjës për propozimin, hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e armëve të vogla dhe të lehta, municioneve dhe materialeve shpërthyese. Në funksion të garantimit të sigurisë publike dhe rendit kushtetues, Ministria e Punëve të Brendshme udhëheq procesin e hartimit të politikave kombëtare në këtë fushë, duke siguruar që ato të jenë të bazuara në evidencë, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe të harmonizuara me standardet e Bashkimit Evropian, Traktatin për Tregtinë e Armëve dhe Protokollin e Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit, si dhe me "Udhërrëfyesin për një zgjidhje të qëndrueshme për zotërimin e paligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të vogla dhe të lehta, municioneve të tyre dhe eksplozivëve 2025–2030". Gjithashtu, Ministria mbikëqyr zbatimin e kuadrit ligjor dhe strategjik përmes strukturave të saj të varësisë, si dhe nëpërmjet koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për të siguruar parandalimin, reduktimin dhe kontrollin efektiv të armëve dhe eksplozivëve në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit përfaqëson strukturën ekzekutive qendrore përgjegjëse për zbatimin e ligjit dhe sigurinë publike, dhe luan një rol thelbësor në luftën kundër trafiqeve të paligjshme të armëve, municioneve dhe eksplozivëve, si brenda territorit të Republikës së

Shqipërisë, ashtu edhe në bashkëpunim me autoritetet kufitare dhe institucionet e tjera ligjzbatuese. Në këtë funksion, Policia e Shtetit angazhohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në parandalimin, identifikimin dhe goditjen e rrjeteve të trafikimit të armëve, duke përdorur mjete të avancuara hetimore, kapacitete operacionale dhe bashkëpunim të strukturuar ndërkombëtar, veçanërisht me agjencitë homologe të vendeve të Bashkimit Evropian dhe të rajonit. Në zbatim të legjislacionit përkatës kombëtar dhe akteve ndërkombëtare që Shqipëria ka ratifikuar, Policia e Shtetit është gjithashtu autoriteti përgjegjës për lëshimin e licencave dhe autorizimeve për veprimtaritë e ligjshme që lidhen me armët e zjarrit, si për personat fizikë ashtu edhe për subjektet juridike. Ky proces përfshin vlerësimin e kritereve të sigurisë, përshtatshmërisë dhe integritetit të aplikantëve, si dhe sigurimin që aktivitetet e lejuara të jenë në përputhje me standardet e sigurisë dhe kontrollit të armëve.

Një funksion tjetër parësor i Policisë së Shtetit është inspektimi dhe mbikëqyrja e kushteve të ruajtjes dhe përdorimit të armëve të zjarrit nga shoqëritë private të sigurisë fizike (SHPSF), si dhe nga të gjithë subjektet e licencuara për mbajtjen apo përdorimin e armëve. Në këtë kontekst, Policia e Shtetit kryen kontrolle të rregullta dhe të jashtëzakonshme për të verifikuar respektimin e kritereve teknike dhe të sigurisë, duke ndërhyrë me masa administrative ose penale në rast shkeljesh. Nëpërmjet këtij mekanizmi ligjor dhe operacional, Policia e Shtetit siguron që qarkullimi dhe përdorimi i armëve në vend të jetë plotësisht i kontrolluar, i ligjshëm dhe i përputhshëm me objektivat kombëtarë të sigurisë.

Njësia Qendrore e Armëve të Zjarrit ngritja e kësaj njësie është përgjegjësi e Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. NJQAZ do të punojë për përsosjen e formave dhe procedurave për regjistrimin e të dhënave për shpërndarjen dhe ndikimin e armëve të zjarrit AVL, statistikat gjinore dhe procedurat për shkëmbimin e detyrueshëm të informacionit me vendet e rajonit. Procedurat për shkëmbim informacioni në sistemet që bartin të dhëna për armët.

Ministria e Mbrojtjes është përgjegjëse për sigurinë e depove ushtarake të armatimeve, shkatërrimin e armëve, municioneve dhe eksplozivëve tepricë, në përputhje me standardet e NATO-s. Ministria e Mbrojtjes gjithashtu është aktor i rëndësishëm në sigurinë e kufijve detarë në ndihmë të institucioneve ligjzbatuese.

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve është institucioni përgjegjës për zbatimin e politikës shtetërore në fushën e kontrollit të eksporteve dhe importeve të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë. Krijimi dhe veprimtaria e tij bazohet në ligjin nr. 46/2018, datë 23.7.2018, "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë" dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 43, datë 16.1.2008, "Për organizimin, funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve". AKSHE është institucioni që licencon importet, eksportet, tranzitin, transship, brokerim të mallrave ushtarake dhe mallrave me përdorim të dyfishtë, në zbatim të ligjit nr. 46/2018. Në bazë të rezultateve të ekspertizës, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve identifikon mallrat, përcakton kushtet e transferimit të tyre ndërkombëtar në shtete të veçanta dhe u lëshon/ose jo këtyre subjekteve licencat respektive.

Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes është ngritur në zbatim të ligjit nr. 87/2024, "Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve teknologjike ushtarake. AIM është autoriteti përgjegjës për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e sektorit të prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armatimit ushtarak në Republikën e Shqipërisë. Licencat e lëshuara nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes (AIM) për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit lëshohen për prodhim, montim, riparim dhe demilitarizim".

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ndihmon me detyra të veçanta për arritjen e objektivave të kësaj strategjie, sidomos në fushën e bashkëpunimit të institucioneve shqiptare me institucionet partnere dhe organizatat ndërkombëtare, raportimeve ndërkombëtare, si dhe në procesin e lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare, subjekt i ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për kontrollin fundor të eksporteve të armëve, municioneve dhe eksplozivëve.

Ministria e Drejtësisë ndihmon me aktivitete për bashkëpunimin e nevojshëm mes Prokurorisë, (*Interpol-strukturë e Policisë së Shtetit*) dhe autoriteteve të huaja të drejtësisë në çështje që lidhen me luftën kundër trafikimit të paligjshëm të armëve. Ministria e Drejtësisë është gjithashtu aktore e rëndësishme për përafrimin e akteve ligjore mbi kontrollin e armëve, municioneve dhe eksplozivëve me direktivat e Bashkimit Evropian dhe akte të tjera ndërkombëtare.

Ministria e Financës ka rol të përgjithshëm këshillues në interes të politikave qeveritare përkatësisht në Strategjinë për Kontrollin e Armëve të vogla, të lehta, Eksplozivëve dhe Municioneve 2025–2030 dhe Plani i Veprimit 2025–2028 në zbatim të saj, ka rol kontribues për promovimin e efektshmërisë, performancës së lartë dhe mirëqeverisjes financiare, përfshirë në të gjithë sektorin publik dhe në ato institucione financiare në të cilat qeveria merr pjesë.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është përgjegjëse për bashkëveprimin me strukturat e tjera të zbatimit të ligjit në funksion të garantimit të kufijve të sigurte tokësore, ujorë dhe ajrorë, duke pasur për qëllim parandalimin dhe luftimin e trafikimit të paligjshëm të armëve, municioneve dhe eksplozivëve.

Ministria e Arsimit është përgjegjëse për hartimin, ndjekjen dhe zbatimin e politikës shtetërore të ndërgjegjësimit dhe edukimit të brezit të ri kundër armëve, me fokus shkollat, qendrat rinore, duke marrë në konsideratë përfshirjen në orë të veçanta mësimore të rreziqeve nga armët, municionet dhe eksplozivët.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për evidentimin e dëmeve ndaj shëndetit të qytetarëve nga armët e zjarrit duke i shërbyer fushatave ndërgjegjësuese mbi rreziqet nga armët, municionet dhe eksplozivët.

Ministria e Mjedisit përfshihet si një institucion kontributor, jo përmes një roli të drejtpërdrejtë në zbatimin praktik të masave specifike që lidhen me pastrimin e ambienteve që shërbejnë për shkatërrimin dhe transformimin e AVLME, por vetëm në bazë të fushës së përgjegjësisë institucionale në përgjithësi, që lidhet me politikat dhe me orientimin strategjik për mjedisin.

Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka një rol në zbatimin e strategjisë, pasi synon goditjen e krimit të organizuar dhe rritjen e sigurisë publike. Një nga aktivitetet kryesore të grupeve kriminale është trafikimi i armëve, që shpesh lidhet ngushtë me veprimtari të tjera të paligjshme si trafiku i drogës, i qenieve njerëzore dhe pastrimi i parave. SPAK, përmes hetimeve të thelluara dhe bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, ndihmon në identifikimin dhe çmontimin e rrjeteve kriminale që merren me trafik armësh. Në këtë mënyrë, puna e SPAK mbështet drejtpërdrejt objektivat e Strategjisë, duke garantuar ndëshkueshmëri dhe duke kontribuar në reduktimin e qarkullimit të armëve të paligjshme në vend.

Prokuroria e Përgjithshme në zbatimin e Strategjisë, është përgjegjëse për ndjekjen penale të veprave që lidhen me mbajtjen, prodhimin, trafikimin apo përdorimin e armëve pa leje. Si pjesë e sistemit të drejtësisë penale, Prokuroria e Përgjithshme bashkëpunon ngushtë me policinë, gjykatat dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese për të siguruar hetime efikase dhe ndjekje të suksesshme të autorëve të këtyre veprave. Gjithashtu, ajo ka kompetencën të orientojë dhe të mbikëqyrë punën e prokurorive më të ulëta në shkallë, duke siguruar një qasje të unifikuar dhe efektive ndaj luftës kundër krimit të organizuar dhe armëve të paligjshme. Në këtë mënyrë, Prokuroria e Përgjithshme përforcon zbatimin e strategjisë duke kontribuar në rritjen e sigurisë dhe sundimin e ligjit.

Akademia e Sigurisë, është përgjegjëse për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit duke i pajisur ata, përveç të tjerave edhe me njohuri të plota në lidhje me legjislacionin dhe procedurat standarde të punës për armët dhe lëndët plasëse e piroteknike si dhe me aftësi praktike për identifikimin, ndalimin dhe hetimin e veprave penale që lidhen me armët e paligjshme dhe lëndët plasëse. Gjithashtu, ajo luan një rol të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve operacionale të policisë si dhe në nxitjen e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Shërbimi Informativ i Shtetit ka rol në aspektin e parandalimit dhe vlerësimit të rreziqeve që lidhen me armët, municionet dhe eksplozivët, duke siguruar informacion të klasifikuar mbi kërcënimet që mund të ndikojnë në sigurinë kombëtare. SHISH mbështet zbatimin e strategjisë nëpërmjet grumbullimit të të dhënave inteligjente dhe informimit të strukturave të tjera shtetërore për veprimtari të dyshuara të trafikut të paligjshëm apo

grupeve të përfshira, duke luajtur rol në identifikimin e risqeve që lidhen me aktorë apo rrjete me ndikim transnacional, gjithashtu, duke kontribuar dhe në ndalimin në kohë të aktiviteteve që cenojnë sigurinë publike dhe atë shtetërore.

Organizatat e Shoqërisë Civile kanë një rol në parandalimin dhe vlerësimin e rreziqeve që lidhen me armët e zjarrit, municionet dhe eksplozivët. Përmes ekspertizës së tyre dhe pranisë në terren, ato kontribuojnë si vëzhgues cilësorë në proceset e monitorimit dhe analizës së politikave. Ky rol është i rëndësishëm për të siguruar transparencë, llogaridhënie dhe për të ndihmuar institucionet shtetërore në identifikimin e sfidave që lidhen me keqpërdorimin e armëve, trafikimin dhe dhunën e lidhur me to. Gjithashtu, përfshirja e tyre në partneritete për zbatimin e masave rrit efektivitetin e masave parandaluese dhe ndihmon në ndërgjegjësimin për rreziqet e mbajtjes së paligjshëm të armëve të zjarrit.

4.2 Monitorimi dhe raportimi

4.2.1 Monitorimi

Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në Strategji dhe Planin e Veprimit, monitorimi i vazhdueshëm i strukturave të angazhuara për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga këto dokumente konsiderohet i nevojshëm për të analizuar gjendjen reale gjatë zbatimit të tyre dhe për të mbikëqyrur implementimin periodik, me qëllim përmbushjen e tyre në mënyrë sa më efektive.

Monitorimi dhe vlerësimi i punës së autoriteteve që kanë detyrime për zbatimin e strategjisë do të shërbejë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të vlerësuar shkallën e realizimit të politikave, objektivave të saj dhe përmbushjes së masave dhe aktiviteteve.

Forcimi i kontrollit, monitorimit dhe parandalimit të devijimit të tregtisë së ligjshme nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve, procedurave dhe transparencës			2025	2028	92,168,769	0	92,168,769	30,722,923	0	30,722,923	0	0		0	0	184,483,464	0	184,483,464	61,591,772	0	61,591,772
Kostoja totale (objektiva specifikë 3.1+3.2+3.3)	Qëllimi i Politikës III				628,563,089	0	628,563,089	209,080,575	0	209,080,575	1,276,723	0	0	1,276,723	0	1,257,373,390	0	1,257,373,390	418,453,003	0	418,453,003

QËLLIMI I POLITIKËS IV. BRENDA VITIT 2030, TË REDUKTOHET NDJESHËM OFERTA, KËRKESA, ZOTËRIMI I PALIGJSHËM DHE KEQPËRDORIMI I ARMËVE, MUNICIONEVE DHE EKSPLOZIVËVE PËRMES MASAVE EFEKTIVE PARANDALUESE, FORCIMIT TË KORNIZËS LIGJORE DHE BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL.

Objektivat specifikë 4	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Burimi i financimit										Hendeku financiar	Kostoja indikative totale			PBA 2026–2030		
					PBA 2025–2027			PBA 2026–2028			Asistencë Financiare e Huaj										
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Korente	Kapitale	Total BSH	Korente	Kapitale	Total BSH	Korente	Kapitale	Donatori dhe titulli i projektit	Total FH		Korente	Kapitale	Total Kosto	Korente	Kapitale	Total Kosto
Rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve të licencuara private dhe juridike për rrezikun e keqërdorimit dhe përhapjes së paligjshme të AME-ve, përfshirë rrezikun e devijimit për prodhuesit e AME-ve			2025	2028	28,850,301	0	28,850,301	9,616,767	0	9,616,767	0	0		0	0	57,700,602	0	57,700,602	19,233,534	0	19,233,534
Zhvillimi i partneriteteve të qëndrueshme me median dhe shoqërinë civile për promovimin e kontrollit, rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin e publikut, për rrezikun e keqërdorimit, mbajtjes së paligjshme dhe trafikimit të AME-ve.			2025	2028	93,037,757	0	93,037,757	31,013,990	0	31,013,990	0	0		0	0	186,079,727	0	186,079,727	62,027,980	0	62,027,980
Rritja e kapaciteteve administrative dhe operacionale për sekuestrimin e armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve			2025	2028	514,476,096	0	514,476,096	30,275,236	0	30,275,236	0	0		0	0	605,301,804	0	605,301,804	60,550,472	0	60,550,472
Përdorimi sistematik çaktivizimi për të eduktuar zotërimin e paligjshëm të armëve të zjarrit			2025	2028	73,060,000	0	73,060,000	24,320,187	0	24,320,187	0	0		0	0	146,020,561	0	146,020,561	48,640,374	0	48,640,374
Kostoja totale (objektiva specifikë 4.1+4.2+4.3+4.4	Qëllimi i Politikës V				709,424,154	0	709,424,154	95,226,180	0	95,226,180	0	0	0	0	0	995,102,694	0	995,102,694	190,452,360	0	190,452,360

QËLLIMI I POLITIKËS V: BRENDA VITIT 2030, TË REDUKTOHET RREZIKU I PËRHAPJES DHE DEVIJIMIT TË ARMËVE, MUNICIONEVE DHE EKSPLOZIVËVE PËRMES FORCIMIT TË MASAVE TË MBROJTJES DHE SIGURISË SË STOQEVE, SI DHE ZBATIMIT TË PROCESEVE EFEKTIVE PËR ASGJËSIMIN E TYRE

Objektivat specifikë 5	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Burimi i financimit										Hendeku financiar	Kostoja indikative totale			Pba 2028–2030		
					PBA 2025–2027			PBA 2026–2028			Asistencë financiare e huaj										
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Korente	Kapitale	Total BSH	Korente	Kapitale	Total BSH	Korente	Kapitale	Donatori dhe titulli i projektit	Total FH		Korente	Kapitale	Total Kosto	Korente	Kapitale	Total kosto
Shkatërrimi sistematik i stoqeve të tepërta të AME-ve në një mënyrë jo të dëmshme për mjedisin.			2025	2028	408,840,388	0	408,840,388	100,000	0	100,000	0	0		0	0	409,140,388	0	409,140,388	200,000	0	200,000
Të keyhet shkatërrimi i AVLE-ve të konfiskuara në mënyrë periodike në përputhje me standardet ndërkombëtare			2025	2028	391,500	0	391,500	130,500	0	130,500	0	0		0	0	783,000	0	783,000	261,000	0	261,000
Garantimi i mjediseve të sigurta të magazinimit për AVL-të/armët e zjarrit dhe municionet, të projektuara sipas nevojave të identifikuara dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare			2025	2028	409,038,388	55,860	409,094,248	43,500	0	43,500	0	0		0	0	409,168,888	55,860	409,224,748	87,000	0	87,000
Ngritja e kapaciteteve të subjekteve juridike përkatëse (prodhues, dyqane riparimi, dyqane shitjeje me pakicë, tregtuesit, poligonet e qitjes, poligonet e gjuetisë, shoqëritë private të sigurisë, qendrat e trajnimit) për të përcaktuar sistemet e inspektimit.			2025	2028	5,242,728	0	5,242,728	1,000,000	0	1,000,000	0	0		0	0	8,242,728	0	8,242,728	2,000,000	0	2,000,000

Kostoja totale (objektiva specifike 5.1+5.2+5.3+5.4	Qëllimi	i	politikës	V					823,513,004	55,860	823,568,864	1,274,000	0	1,274,000	0	0	0	0	0	827,335,004	55,860	827,390,864	2,548,000	0	2,548,000
Kostoja totale e PV									3,307,970,410	55,860	3,308,026,270	604,678,681	0	604,678,681	63,844,983	3,276,425	0	67,121,408	0	5,187,820,978	3,332,285	5,191,153,263	1,211,326,904	0	1,211,326,904

Kostoja totale e PV	5,191,153,263
PBA — Buxheti 2025–2027	3,308,026,270
PBA — Buxheti 2026–2028	604,678,681
PBA — Buxheti 2028–2030	1,211,326,904
Financim i Huaj	67,121,408
Hendek financiar 2025–2029	0

Kostoja korente	5,187,820,978
Kostoja kapitale	3,332,285
Total kosto	5,191,153,263

	64
	12
	23
	1

	99.9
	0.1

	Kostoja korente	Kostoja kapitale	Kostoja totale
QP I	1,694,619,370	3,276,425	1,697,895,795
QP II	413,390,521	0	413,390,521
QP III	1,257,375,390	0	1,257,375,390
QP IV	995,102,694	0	995,102,694
QP V	827,335,004	55,860	827,390,864

Nevojat korente dhe kapitale (në lekë)

Qëllimet e politikave	Natyra/tipologjia e kostove	Kosto të planifikuara PBA 2025–2027 Buxheti	Kosto të planifikuara PBA 2026–2028 Buxheti	Kosto të planifikuara PBA 2028–2030 Buxheti	Kosto të planifikuara FH 2025–2030 Donatorët	Hendeku financiar 2025–2030	Kostoja totale 2025–2030
P1	Korente	932,216,706	233,368,338	467,005,566	62,028,760	**0**	1,694,619,370
	Kapitale	0	0	0	3,276,425		3,276,425
P2	Korente	214,253,457	65,729,589	132,867,976	539,500	**0**	413,390,521
	Kapitale	0	0	0	0		0
P3	Korente	628,563,089	209,080,575	418,453,003	0	**0**	1,257,373,390
	Kapitale	0	0	0	0		0
P4	Korente	709,424,154	95,226,180	190,452,360	0	**0**	995,102,694
	Kapitale	0	0	0	0		0
P5	Korente	823,513,004	1,274,000	2,548,000	0	**0**	827,335,004
	Kapitale	55,860	0	0	0		55,860
TOTALI [lekë]		**3,308,026,270**	**604,678,681**	**1,211,326,904**	**65,844,685**	**0**	**5,191,153,263**
TOTALI [euro] *1 euro 93.1 lekë*		**35,531,969**	**6,494,938**	**13,011,030**	**707,247**	**0**	**55,758,896**


KOSTO E PV- NDARJA E SHPENZIMEVE
Financim I Huaj
1%
PBA - Buxheti
2028-2030
23%
PBA - Buxheti
2026-2028
12%
PBA - Buxheti
2025-2027
64%


NATYRA EKONOMIKE E KOSTOVE TË PLANIT TE VEPRIMIT
Kosto Kapitale
0.1%
Kosto Korente
99.9%



VENDIM
Nr. 790, datë 24.12.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 171, DATË 28.3.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TAKSËS SË PASURISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 9, të nenit 4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pikat 2 dhe 3, të vendimit nr. 171, datë 28.3.2018, të Këshillit të Ministrave , "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë", ndryshohen, si më poshtë vijon:

"2. Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë ka si mision kryesor mbështetjen e njësive të vetëqeverisjes vendore (bashkitë) në zbatimin e legjislacionit që rregullon taksën mbi pasurinë e paluajtshme.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

a) Administron regjistrin qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale) dhe është dhënësja e vetme e të dhënave që përmban ai;

b) Ofron asistencë për bashkitë gjatë procesit të regjistrimit, përditësimit dhe korrigjimit të të dhënave në regjistrin qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale), duke siguruar që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar;

c) Monitoron rregullisht të dhënat e regjistruara nga bashkitë në regjistrin qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale), duke identifikuar mangësitë, gabimet ose

mospërputhjet, si dhe u jep udhëzime bashkive mbi mënyrën e adresimit të tyre;

ç) Regjistron dhe përditëson të dhënat në regjistrin qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale), siç përcaktohet në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore "Regjistri qendror i bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale)";

d) Pajis përdoruesit e sistemit informatik të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale) me kode hyrjeje dhe u vë në dispozicion kredencialet e përdoruesve (aksesit), në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore, "Regjistri qendror i bazës së të dhënave pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale)";

dh) Miraton me vendim të drejtorit të përgjithshëm modelet tip, të:

i. njoftimit të vlerësimit të taksës mbi ndërtesën;

ii. kërkesës për korrigjim;

iii. formularit të vetëdeklarimit;

iv. formularit të evidentimit në terren;

v. kërkesës për pajisjen me kod hyrës dhe kredencialet e aksesit në sistemin informatik të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);

vi. ekstraktit të të dhënave nga regjistri qendror i bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);

e) Asiston bashkitë në adresimin e kërkesave dhe problematikave që mund të lindin gjatë punës për administrimin e taksës mbi ndërtesën, si më poshtë:

i. jep udhëzime teknike për hyrjen dhe përdorimin e funksionaliteteve të sistemit informatik të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);

ii. jep udhëzime për përcaktimin e bazës së taksës për njësitë e ndërtesës dhe llogaritjen e taksës për to;

iii. jep asistencë për adresimin e kërkesave dhe problematikave që lidhen me procesin e gjenerimit dhe dërgimit të njoftimeve të vlerësimit të taksës së taksapaguesit, përmes portalit "*e-Albania",* si dhe regjistrimin e pagesave në pikat e autorizuara të pagesës;

iv. jep asistencë për çështje ose kërkesa të tjera që lidhen me proceset e ndryshme të punës së bashkive në administrimin e taksës mbi ndërtesën;

ë) Monitoron dhe vlerëson rregullisht zbatimin e legjislacionit që lidhet me përcaktimin e bazës së taksës (vlerës së taksueshme), detyrimit për taksën dhe aspekte të tjera të administrimit të taksës mbi ndërtesat në bashkitë e Republikës së Shqipërisë, si pjesë e udhëheqjes së këtij procesi;

f) Kërkon nga bashkitë korrektimin e të dhënave të ndryshme, që përcaktojnë bazën e taksës mbi ndërtesën dhe detyrimet tatimore, si dhe adresimin e çështjeve të tjera, kur konstaton parregullsi dhe gabime në zbatimin e legjislacionit;

g) Verifikon përputhshmërinë e parashikimeve të vendimeve të këshillave bashkiakë për taksën mbi pasurinë e paluajtshme me legjislacionin që rregullon taksën mbi pasurinë e paluajtshme, si dhe informon bashkitë për rezultatet e verifikimit;

gj) Administron procesin e mirëmbajtjes, operimit dhe zhvillimit të funksionaliteteve të sistemit informatik të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale), që kanë lidhje me procesin e regjistrimit, përcaktimit të bazës së taksës, taksimit, faturimit, mbledhjes së detyrimeve tatimore apo aspekte të tjera të sistemit informatik, me qëllim sigurimin e pajtueshmërisë së sistemit informatik të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale) me legjislacionin në fuqi dhe nevojat funksionale;

h) Bën testimin dhe pranimin përfundimtar të funksionaliteteve të sistemit informatik të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);

i) Bashkëpunon dhe mban takime të rregullta me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për:

i. adresimin e kërkesave dhe problematikave që lidhen me mirëmbajtjen, operimin dhe zhvillimin e funksionaliteteve të sistemit informatik të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale); dhe

ii. sigurimin e ndërveprimit dhe adresimit të nevojave për përmirësimin e ndërveprueshmërisë së regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale) me bazat e tjera shtetërore të të dhënave;

j) Asiston bashkitë në aktivitetet dhe proceset e punës që lidhen me informimin dhe shërbimin ndaj taksapaguesve, si dhe organizon, kur është e mundur, fushata informuese dhe ndërgjegjësuese

për të promovuar përmirësimin e nivelit të pajtueshmërisë me detyrimet ligjore;

k) Kërkon nga bashkitë informacion të detajuar, mbi:

i. procesin e administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme;

ii. shërbimin ndaj taksapaguesve;

iii. të ardhurat e mbledhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme;

l) Harton dhe i propozon ministrisë përgjegjëse për financat ndryshime në kuadrin ligjor që rregullon taksën mbi pasurinë e paluajtshme;

ll) Trajnon stafet përgjegjëse për administrimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme në të gjitha bashkitë;

m) Përgatit manuale informuese për zbatimin e legjislacionit që rregullon taksën mbi pasurinë e paluajtshme, si dhe për përdorimin e funksionaliteteve të sistemit informatik të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);

n) Informon në mënyrë periodike ministrin përgjegjës për financat mbi ecurinë e procesit të regjistrimit të të dhënave në regjistrin qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale), administrimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme, si dhe mbi të ardhurat e mbledhura nga këto taksa;

nj) Bashkëpunon dhe mban marrëdhënie institucionale me agjentin përgjegjës për mbledhjen e taksës mbi ndërtesat, ofruesit e shërbimeve dhe autoritetet e tjera që janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit në fuqi që rregullon taksën mbi pasurinë e paluajtshme.".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 791, datë 24.12.2025

PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE E TË KRITEREVE PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTEVE ARKEOLOGJIKE NËNUJORE, SI DHE TË AKTIVITETEVE TË TJERA, QË PREKIN DIREKT OSE INDIREKT TËRËSINË E VLERAVE ARKEOLOGJIKE DHE HISTORIKE NËNUJORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 156, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI**:**

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton kushtet e kriteret për zhvillimin e projekteve arkeologjike nënujore dhe të aktiviteteve të tjera, që prekin direkt ose indirekt tërësinë e vlerave arkeologjike dhe historike nënujore.

2. Ky vendim zbatohet për:

a) projektet e zhvilluara nga institucione shtetërore ose nga operatorë privatë të autorizuar/ licencuar, sipas legjislacionit në fuqi;

b) çdo aktivitet kërkimor-shkencor ose ndërtimor në ujërat e brendshme dhe në ujërat detare territoriale të Republikës së Shqipërisë;

c) çdo ndërhyrje që mund të prekë integritetin e artefakteve, anijeve të fundosura ose objekteve arkeologjike të tjera nënujore.

3. Projekte arkeologjike nënujore janë aktivitete që kanë trashëgiminë kulturore nënujore, si objekt kryesor, dhe, të cilat, drejtpërdrejt ose tërthorazi, mund ta dëmtojnë trashëgiminë kulturore nënujore.

4. Projektet arkeologjike nënujore mund të zhvillohen nga:

a) institucionet e specializuara dhe/ose në bashkëpunim me institucione të huaja, që kryejnë veprimtari të kërkimit arkeologjik, të cilat do të kryejnë projekte arkeologjike nënujore në territore të njohura ose jo si zona me vlera arkeologjike. Në rastet kur këto zona bien brenda territorit të zonave të mbrojtura, institucionet e specializuara, si dhe veprimtaritë e kërkimit arkeologjik respektojnë edhe

kërkesat e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura;

b) subjekte të licencuara në fushën e arkeologjisë nënujore, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

5. Aktivitete të tjera, që prekin direkt ose indirekt rastësisht trashëgiminë kulturore nënujore, janë aktivitete, të cilat, pavarësisht se nuk e kanë trashëgiminë kulturore nënujore si objektin e tyre kryesor ose një nga objektet e tyre, mund ta dëmtojnë trashëgiminë kulturore nënujore. Gjatë kryerjes së këtyre aktiviteteve zbatohen parashikimet e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura.

6. Zhvillimi i projektit arkeologjik nënujor, i cili do të zhvillohet nga institucionet e specializuara ose subjektet e licencuara për veprimtari arkeologjike nënujore, mund të kryhet vetëm me lejen përkatëse nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM).

II. KUSHTET PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTEVE ARKEOLOGJIKE NËNUJORE

Projektet arkeologjike nënujore zbatohen në përputhje me këto kushte:

1. Ruajtja në vendin e gjetjes, *in situ*, trajtohet si zgjidhja parësore. Nxjerrja e objekteve nga vendi i gjetjes nënujore lejohet vetëm në rastet kur ruajtja *in situ* nuk është e mundur dhe vetëm për qëllime studimore, vlerësuese ose arsye të tjera, që lidhen me ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë, pa asnjë synim fitimprurës.

2. Aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore duhet të përdorin teknika joshkatërruese dhe metodat e vrojtimit e jo të përftimit të objekteve. Nëse është i nevojshëm gërmimi ose përftimi për qëllimin e studimeve kërkimore-shkencore ose për mbrojtjen përfundimtare të trashëgimisë kulturore nënujore, metodat dhe teknikat e përdorura duhet të jenë sa më pak shkatërruese, që të jetë e mundur dhe të kontribuojnë në ruajtjen e pjesëve të mbetura.

3. Trashëgimia kulturore nënujore nuk tregtohet, shitet, blihet ose këmbehet si mall në treg.

4. Sigurojnë informimin e publikut dhe botimin/ publikimin e rezultateve të projektit në revistat shkencore arkeologjike, brenda dhe jashtë vendit.

5. Respektojnë mjedisin ujor dhe ekosistemet përkatëse, në përputhje me parashikimet në legjislacionin për mjedisin.

6. Ndalohet çdo veprim që dëmton mjedisin ujor, florën, faunën ose ndot cilësinë e ujit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit.

7. Zbatimi i projekteve duhet të sigurojë ruajtjen fizike të objekteve arkeologjike, që zbulohen gjatë zhvillimit të tij, duke krijuar kushte laboratorike të përshtatshme, si dhe transport të sigurt, nga momenti i zbulimit deri te depozitimi në laborator.

8. Zbulimet e papritura ose ndryshimet në rrethana kërkojnë rishikim të projektit pranë KKTKM-së.

III. KRITERET PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTEVE ARKEOLOGJIKE NËNUJORE

1. Projekti arkeologjik i parashikuar në pikën 6, të kreut I, të këtij vendimi, kur paraqitet pranë KKTKM-së, duhet të përmbajë:

a) qëllimin dhe objektivat shkencorë, që përfshijnë identifikim, hulumtim, dokumentim, studim, restaurim dhe metodologji, sipas standardeve bashkëkohore, në respekt edhe të mjedisit ujor dhe të ekosistemeve;

b) planin metodologjik të punës dhe teknikat që do të zbatohen;

c) një vlerësim paraprak të ndikimit për mjedisin ujor nga aktivitetet e projektit;

ç) një vlerësim të studimeve të mëparshme ose paraprake, nëse aplikohet;

d) listën e personelit kërkimor-shkencor e teknik dhe kualifikimet;

dh) planin e sigurisë dhe emergjencave;

e) planin e konservimit dhe magazinimit të materialeve, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente;

ë) planin financiar dhe burimet e financimit;

f) afatin e pritshëm kohor për përfundimin e projektit;

g) planet për analizat pas punës në terren dhe aktivitetet e tjera;

gj) menaxhimin dhe mirëmbajtjen e vendit për të gjithë kohëzgjatjen e projektit;

h) program dokumentimin;

i) depozitimin e gjetjeve, duke përfshirë trashëgiminë kulturore nënujore;

j) masat në lidhje me ambientin;

k) përgatitjen e raportit;

l) një program publikimi.

2. Projekti arkeologjik, i parashikuar në pikën 6, të kreut I, të këtij vendimi, kur paraqitet pranë KKTKM-së, duhet të përmbushë kriteret teknike dhe logjistike, si më poshtë vijon:

a) Të ketë një drejtues projekti;

b) Të ketë arkeologë, në përputhje me natyrën e projektit dhe staf teknik ndihmës të specializuar për zhytje nënujore, të cilët zotërojnë gradën e tretë të zhytësit ose superiore, të mbrojtur në një nga shkollat didaktike të njohura, si: Shkolla Ndërkombëtare për Zhytje – SSI, Konfederata Botërore e Aktiviteteve Nënujore – CMAS, Shoqata Profesionale e Instruktorëve të Zhytjes – PADI ose të ngjashme;

c) Të ketë arkeologë, në përputhje me natyrën e projektit (arkeologë të licencuar në veprimtari të arkeologjisë nënujore dhe teknik ndihmës të specializuar për zhytje nënujore);

ç) Të ketë staf për përpunimin e gjetjeve;

d) Të ketë specialist konservues;

dh) Të ketë specialist qeramike, monedhash, metalesh, objektesh qelqi etj.;

e) Të ketë skicograf;

ë) Të ketë ekspertë, të cilët do të bëjnë të mundur realizimin e plotë të një projekti, nga fillimi deri në fazën e fundit të tij;

f) Të disponohen mjetet logjistike të specializuara për realizimin e zhytjes dhe infrastrukturën e domosdoshme, përfshirë mjetet lundruese, në pronësi ose me qira;

g) Në rastet e gërmimeve arkeologjike, të sigurojë kushte të përshtatshme për trajtimin dhe ruajtjen e përkohshme të objekteve arkeologjike, sipas standardeve të Këshillit Ndërkombëtar të Monumenteve dhe Siteve ICOMOS (1996/2001), të ndryshuar;

gj) Të disponojë dokumentin për sigurimin e jetës për drejtuesin dhe stafin shoqërues të projektit, në standardet e Agjencisë Ndërkombëtare për Sigurimin e Zhytëseve *DAN EUROPE*.

IV. KRITERET DHE KUSHTET PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE QË PREKIN VLERAT NËNUJORE

Institucionet e specializuara dhe subjektet e licencuara për veprimtari arkeologjike nënujore duhet:

a) të plotësojnë objektiva të qartë, si dhe kriteret që përfshijnë identifikim, hulumtim, dokumentim, studim, restaurim dhe metodologji, sipas standardeve bashkëkohore në respekt edhe të mjedisit ujor dhe ekosistemeve;

b) të respektojnë kriteret e parashikuara në pikën 2, të kreut III, të këtij vendimi.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Ngarkohen ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 792, datë 24.12.2025

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR KRIJIMIN, VENDOSJEN NËN MBIKËQYRJE, PEZULLIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUTEVE DHE TË NJËSIVE TË VEÇANTA TË KËRKIMIT SHKENCOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 16, dhe të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 109/2024, "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e kritereve, të rregullave dhe të procedurave për krijimin e instituteve dhe të njësive të veçanta publike të kërkimit shkencor, si dhe për vendosjen nën mbikëqyrje, pezullimin dhe mbylljen e çdo instituti dhe njësie të veçantë të kërkimit shkencor, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së kërkimit shkencor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Instituti privat i kërkimit shkencor dhe njësia e veçantë private e kërkimit shkencor krijohen sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për personat juridikë privatë.

3. Instituti i kërkimit shkencor dhe njësia e veçantë e kërkimit shkencor kanë si mision nxitjen e dijes e të së vërtetës shkencore, mbrojtjen e shëndetit publik, të trashëgimisë kulturore, mjedisore e materiale, nxitjen e teknologjisë dhe inovacionit, nëpërmjet kryerjes së veprimtarive

laboratorike dhe vlerësimeve shkencore në këto fusha.

4. Instituti i kërkimit shkencor ka për objekt kërkimin shkencor e zbatimin e tij në një apo në disa fusha të shkencës.

5. Njësia e veçantë e kërkimit shkencor realizon kërkim shkencor në fusha të veçanta të organizuara sipas legjislacionit në fuqi.

II. KRITERET PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE NJËSISË SË VEÇANTË PUBLIKE TË KËRKIMIT SHKENCOR

1. Instituti i kërkimit shkencor dhe njësia e veçantë e kërkimit shkencor krijohen sipas përbërjes, kritereve të organizimit dhe të plotësimit të personelit kërkimor shkencor, punonjësve ndihmësteknikë dhe administrativë, të përcaktuar në ligjin nr. 109/2024, "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë".

2. Instituti i kërkimit shkencor përbëhet nga jo më pak se dy njësi të kërkimit shkencor, të organizuara në formën e departamentit, qendrës kërkimore, laboratorit kërkimor ose qendrës eksperimentale. Personeli kërkimor shkencor i institutit, sipas kategorive, përbëhet nga të paktën:

a) 1 (një) kërkues shkencor i avancuar;

b) 4 (katër) kërkues shkencorë;

c) 2 (dy) asistentë kërkues shkencorë.

3. Personeli kërkimor-shkencor i njësisë së kërkimit shkencor, sipas kategorive, përbëhet nga të paktën:

a) 2 (dy) kërkues shkencorë;

b) 1 (një) asistent kërkues shkencor.

4. Numri dhe pozicionet e punës për punonjësit ndihmësteknikë dhe administrativë të institutit të kërkimit shkencor dhe njësisë së veçantë të kërkimit shkencor përcaktohen në aktet e brendshme të institutit apo të njësisë së veçantë, ku është punësuar punonjësi.

5. Instituti i kërkimit shkencor dhe njësia e veçantë e kërkimit shkencor duhet të plotësojnë kriteret infrastrukturore për krijimin e tyre, që lidhen me objektin ndërtimor, ku do të zhvillojnë veprimtarinë, i cili duhet të jetë i përshtatshëm për fushën/at e kërkimit shkencor, që do të realizojnë, si dhe të disponojnë infrastrukturën teknike të nevojshme, në përputhje me fushën/at, që t'i shërbejnë funksionimit normal të veprimtarisë kërkimore-shkencore.

6. Instituti i kërkimit shkencor dhe njësia e veçantë e kërkimit shkencor duhet të deklarojnë burimet e financimit dhe të garantojnë qëndrueshmërinë financiare për krijimin e tyre.

III. PROCEDURA PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE TË NJËSISË SË VEÇANTË PUBLIKE TË KËRKIMIT SHKENCOR

1. Çdo person juridik publik ka të drejtën e propozimit për krijimin e institutit ose të njësisë së veçantë publike të kërkimit shkencor.

2. Për krijimin e institutit ose të njësisë së veçantë publike të kërkimit shkencor ndiqen procedurat e mëposhtme:

a) Subjekti kërkues i paraqet dokumentacionin e nevojshëm ministrisë përgjegjëse, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, për krijimin e institutit apo të njësisë së veçantë publike të kërkimit shkencor;

b) Propozimi për aplikim përmban informacionin dhe dokumentacionin, si më poshtë vijon:

i. kërkesën për krijimin e institutit apo të njësisë së veçantë publike të kërkimit shkencor, ku të përcaktohet misioni, objekti, fusha e veprimtarisë, duke argumentuar nevojën për krijimin e tij;

ii. të dhënat e subjektit, si dhe deklaratën/at për përbërjen, kriteret e organizimit e të personelit kërkimor-shkencor, si dhe të kritereve infrastrukturore;

iii. projektstatutin, i cili duhet të përmbajë normat bazë që rregullojnë veprimtarinë e institutit apo të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, ku përcaktohen organizimi, strukturat përbërëse të tij, veprimtaritë e organeve drejtuese, zgjedhja apo emërimi i tyre, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e tyre;

iv. projektdokumentin strategjik, që përcakton vizionin, objektivat afatgjatë, në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit 2023–2030;

v. deklaratën për burimet e financimit dhe të garantimit të qëndrueshmërisë financiare për krijimin e institutit apo të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor.

3. Ministria përgjegjëse, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, për verifikimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit mbi plotësimin e kritereve për krijimin e institutit ose të njësisë së veçantë publike të kërkimit shkencor, ngre një komision *ad hoc*, ku, në përbërje të tij, caktohen edhe

ekspertë të fushës/ave të kërkimit shkencor, që zhvillon instituti apo njësia e veçantë e kërkimit shkencor, si dhe përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor.

4. Verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu, bëhet brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e aplikimit, sipas akteve të brendshme të ministrisë përgjegjëse, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore.

5. Ministria përgjegjëse, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, i propozon Këshillit të Ministrave krijimin e institutit të kërkimit shkencor ose të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor.

6. Instituti i kërkimit shkencor apo njësia e veçantë e kërkimit shkencor i/e krijuar regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Institucioneve, Instituteve, Njësive të Veçanta të Kërkimit Shkencor dhe Kërkuesve Shkencorë.

IV. RREGULLA DHE PROCEDURA PËR VENDOSJEN NËN MBIKËQYRJE OSE PEZULLIM TË VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT DHE TË NJËSISË SË VEÇANTË TË KËRKIMIT SHKENCOR

1. Ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor kryen vlerësimin periodik apo vlerësime të tjera për verifikimin e përmbushjes së kritereve të funksionimit të institutit ose të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor.

Për kryerjen e këtij vlerësimi, ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor dhe ministria përgjegjëse sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore ngrenë një komision *ad hoc,* ku, në përbërje të tij, caktohen përfaqësues nga të dyja ministritë, si edhe ekspertë të fushës/ave të kërkimit shkencor, që zhvillon instituti apo njësia e veçantë e kërkimit shkencor.

2. Komisioni *ad hoc* ia paraqet raportin mbi vlerësimin e institutit apo të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor ministrisë përgjegjëse sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore.

Në rast të konstatimit të mospërmbushjes së kritereve të funksionimit ose performancës së ulët në ushtrimin e veprimtarisë të institutit apo të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, sipas kritereve dhe procedurave të vlerësimit të miratuara me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, komisioni i propozon ministrisë përgjegjëse për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor vendosjen në mbikëqyrje ose pezullim të veprimtarisë kërkimore shkencore të institutit ose njësisë së veçantë.

3. Ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor, bazuar në raportin e vlerësimit të komisionit, vendos:

a) kushte për vijimin e veprimtarisë nën mbikëqyrje të ministrisë deri në 1 (një) vit; ose

b) pezullimin e veprimtarisë deri në plotësimin e kushteve, për një periudhë jo më të gjatë se 2 (dy) vite kalendarike.

4. Në rast kur vendoset masa e përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 3, të këtij kreu, për monitorimin dhe raportimin mbi procesin e mbikëqyrjes së veprimtarisë së institutit ose të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor dhe ministria përgjegjëse sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore ngrenë një komision *ad hoc* me përfaqësues nga të dyja ministritë, si edhe ekspertë të fushës/ave të kërkimit shkencor, që zhvillon instituti apo njësia e veçantë e kërkimit shkencor.

5. Mbi bazën e raportit të vlerësimit të komisionit *ad hoc*, që monitoron procesin e mbikëqyrjes, ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor vendos, si më poshtë vijon:

a) Heqjen e kushteve, nëse konstatohet përmbushja e tyre brenda afatit të vendosur nga instituti ose njësia e veçantë e kërkimit shkencor nën mbikëqyrjen e ministrisë; ose

b) Pezullimin e veprimtarisë deri në 2 (dy) vite kalendarike, në rast se nuk janë plotësuar kushtet e vendosura për institutin ose njësinë e veçantë të kërkimit shkencor për vendosjen nën mbikëqyrjen e ministrisë.

6. Gjatë periudhës së pezullimit, instituti ose njësia e veçantë e kërkimit shkencor nuk lejohet të aplikojë në projekte kombëtare apo ndërkombëtare, të financuara me fonde publike, apo të punësojë personel të ri kërkimor shkencor.

7. Në rast kur vendoset pezullimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore, në përfundim të afatit të përcaktuar, ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor dhe ministria përgjegjëse sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, ngrenë një komision *ad hoc* me përfaqësues nga të dyja ministritë, si edhe ekspertë të fushës/ave të kërkimit shkencor, që zhvillon instituti apo njësia e veçantë e kërkimit shkencor për të vlerësuar përmbushjen e kushteve të vendosura.

8. Në rast se ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor konstaton përmbushjen e kushteve të vendosura prej saj, brenda afatit të përcaktuar në aktin e pezullimit, vendos për heqjen e pezullimit dhe lejimin e ushtrimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të institutit ose të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor.

9. Në rast se kushtet e përcaktuara në aktin e pezullimit të ministrisë përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor nuk janë plotësuar brenda afatit të përcaktuar, ministria vijon procedurën për mbylljen e institutit apo të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, sipas kreut V të këtij vendimi.

10. Subjekti i vendosur nën mbikëqyrje apo i pezulluar ka të drejtën e ankimit pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative.

V. RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR MBYLLJEN E INSTITUTIT OSE TË NJËSISË SË VEÇANTË TË KËRKIMIT SHKENCOR

1. Mbyllja e veprimtarisë së institutit ose të njësisë së veçantë publike të kërkimit shkencor dhe përcaktimi i detyrimeve pas mbylljes së tij/saj bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, mbi bazën e propozimit të ministrit përgjegjës për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor.

2. Veprimtaria e institutit ose e njësisë së veçantë të kërkimit shkencor mbyllet për rastet e përcaktuara në nenin 21 të ligjit për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë.

3. Shkelje të rënda ligjore për mbylljen e institutit apo të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor janë:

a) ushtrimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore, që shkakton rrezik për sigurinë kombëtare, të drejtat e njeriut, shëndetin publik apo mjedisin, mbi masën e normës së lejuar të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e jetës, sigurinë kombëtare, të drejtat e njeriut, shëndetin publik dhe mjedisin;

b) mosrespektimi i legjislacionit në fuqi për pronësinë intelektuale dhe shkelja e normave të etikës së kërkimit shkencor.

4. Për mbylljen e institutit ose të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor respektohet, sipas rastit të paraqitur, procedura e mëposhtme:

a) Në rastin e mbylljes vullnetarisht të institutit ose të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, subjekti paraqet propozimin e organit drejtues të institutit ose të drejtuesit të njësisë për njësinë e veçantë për mbyllje, propozim i cili përmban të dhëna për pasuritë publike të krijuara gjatë veprimtarisë kërkimore-shkencore, të dhëna për menaxhimin e fondeve publike, si dhe për produktet shkencore, që disponon instituti ose njësia e veçantë e kërkimit shkencor;

b) Kur mbyllja e institutit ose e njësisë së veçantë publike të kërkimit shkencor bëhet për rastet e përcaktuara në nenin 21 të ligjit për shkencën dhe kërkimin shkencor, ministria përgjegjëse sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, i propozon ministrisë përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor ndjekjen e procedurës ligjore për mbylljen e tij/saj.

5. Kur mbyllja e institutit ose e njësisë së veçantë të kërkimit shkencor publik bëhet për rastet e përcaktuara në nenin 21 të ligjit për shkencën dhe kërkimin shkencor, ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor i propozon Këshillit të Ministrave mbylljen e tij/saj.

6. Në rast të mbylljes së institutit privat apo të njësisë së veçantë private të kërkimit shkencor, ministria i propozon organit, që e ka krijuar, mbylljen e veprimtarisë së kërkimit shkencor, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për personat juridikë privatë.

7. Pas mbylljes vijohet procedura për çregjistrimin e institutit apo të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor të mbyllur nga Regjistri Kombëtar i Institucioneve, Instituteve, Njësive të Veçanta të Kërkimit Shkencor dhe Kërkuesve Shkencorë.

8. Subjekti, për të cilin propozohet mbyllja, ka të drejtën e ankimit pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative.

9. Instituti ose njësia e veçantë e kërkimit shkencor që mbyllet dorëzon dokumentacionin që disponon pranë arkivit shtetëror vendor, sipas legjislacionit në fuqi për arkivat.

VI. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ngarkohen ministritë përgjegjëse, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor, institutet e kërkimit shkencor dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 793, datë 24.12.2025

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE PËR PËRFITIMIN E KATEGORISË NGA PUNONJËSIT KËRKIMORË-SHKENCORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 25, të ligjit nr. 109/2024, "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI**:**

1. Përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për përfitimin e kategorisë nga punonjësit kërkimorë-shkencorë, "asistent kërkues-shkencor", "kërkues-shkencor", "kërkues-shkencor i avancuar" dhe "drejtues kërkimor-shkencor", të instituteve dhe të njësive të veçanta të kërkimit shkencor, të krijuara sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Për përfitimin e kategorisë "asistent kërkues-shkencor", kandidati duhet:

a) të zotërojë diplomë të ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave", në fushën përkatëse të arsimimit, ose një diplomë të barasvlershme me të, në përputhje me nivelin e shtatë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në rast se diploma është lëshuar nga institucioni i huaj, i autorizuar në vendin përkatës për lëshimin e tyre, ajo duhet të jetë njohur dhe njësuar në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) të jetë i regjistruar dhe në ndjekje të programit të studimeve të ciklit të tretë "Doktoratë", niveli i tetë i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;

c) të ketë referenca nga dy ekspertë të fushës së tij të angazhimit në veprimtari të kërkimit shkencor, të cilët zotërojnë tituj akademikë.

3. Për përfitimin e kategorisë "kërkues-shkencor", kandidati duhet:

a) të zotërojë diplomë të ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë", niveli i tetë i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në rast zotërimi të një diplome të lëshuar nga institucioni i huaj, i autorizuar në vendin përkatës për lëshimin e tyre, të jetë e njohur dhe njësuar në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) të ketë zhvilluar veprimtari kërkimore-shkencore, të paktën 1 (një) vit, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor", e cila vërtetohet nëpërmjet angazhimit në veprimtari kërkimore-shkencore në institucione të arsimit të lartë, institute apo njësi të veçanta të kërkimit shkencor;

c) të ketë botuar, së paku, 1 (një) artikull shkencor në revista ndërkombëtare të indeksuara, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor";

ç) të ketë botuar, së paku, 2 (dy) artikuj shkencorë, në revista kombëtare të kategorisë A ose B, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor";

d) të ketë referenca nga 2 (dy) ekspertë të fushës së tij të angazhimit në veprimtari të kërkimit shkencor, të cilët zotërojnë tituj akademikë.

4. Për përfitimin e kategorisë "kërkues-shkencor i avancuar", kandidati duhet:

a) të zotërojë kategorinë "kërkues-shkencor";

b) të zotërojë diplomë të ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë", niveli i tetë i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në rast zotërimi të një diplome të lëshuar nga institucioni i huaj, i autorizuar në vendin përkatës për lëshimin e tyre, të jetë e njohur dhe njësuar në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi;

c) të ketë zhvilluar veprimtari kërkimore-shkencore prej të paktën 3 (tre) vjet, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor", e cila vërtetohet përmes angazhimit në veprimtari kërkimore-shkencore në institucione të arsimit të lartë, institute apo njësi të veçanta të kërkimit shkencor;

ç) të ketë botuar, së paku, 2 (dy) artikuj shkencorë në revista ndërkombëtare të indeksuara, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor";

d) të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë, në revista kombëtare të kategorisë A ose B, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor";

dh) të ketë pjesëmarrje në veprimtari kërkimore-shkencore, si pjesëmarrje në komitete shkencore apo udhëheqje ose bashkëudhëheqje të projekteve kërkimore-shkencore në institucionet e arsimit të lartë, institute apo njësi të veçanta të kërkimit-shkencor.

5. Për përfitimin e kategorisë "drejtues kërkimor-shkencor", kandidati duhet:

a) të zotërojë kategorinë "kërkues-shkencor i avancuar";

b) të zotërojë diplomë të ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë", niveli i tetë i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në rast zotërimi të një

diplome të lëshuar nga institucioni i huaj, i autorizuar në vendin përkatës për lëshimin e tyre, të jetë e njohur dhe njësuar në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi;

c) të ketë zhvilluar veprimtari kërkimore-shkencore prej të paktën 5 (pesë) vjet, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor", e cila vërtetohet përmes angazhimit në veprimtari kërkimore-shkencore në institucione të arsimit të lartë, institute apo njësi të veçanta të kërkimit shkencor;

ç) të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista ndërkombëtare të indeksuara, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor";

d) të ketë botuar, së paku 4, (katër) artikuj shkencorë, në revista kombëtare të kategorisë A ose B, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor";

dh) të ketë pjesëmarrje në veprimtari kërkimore-shkencore, si pjesëmarrje në komitete shkencore apo udhëheqje ose bashkëudhëheqje të projekteve kërkimore-shkencore në institucionet e arsimit të lartë, institute ose njësi të veçanta të kërkimit-shkencor.

6. Kandidati për përfitimin e kategorisë së punonjësit kërkimor-shkencor aplikon pranë institutit kërkimor-shkencor ose njësisë së veçantë të kërkimit shkencor.

7. Instituti kërkimor-shkencor ose njësia e veçantë e kërkimit shkencor ngre një komision të posaçëm të vlerësimit të dosjeve (në vijim "KVD") për vlerësimin e aplikimeve. KVD-ja, nëse e vlerëson të nevojshme, fton personel të kategorisë "Profesor" nga universitetet publike, për shqyrtimin e aplikimeve.

8. KVD-ja shqyrton aplikimin brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, sipas kritereve të parashikuara për secilën kategori.

9. Në rast të përmbushjes së kritereve, KVD-ja i përcjell për vlerësim Këshillit Shkencor aplikimin.

10. Pas vlerësimit, brenda 5 (pesë) ditëve punë nga Këshilli Shkencor, drejtuesi i institutit kërkimor-shkencor vendos për dhënien e kategorisë për aplikantin.

11. Kur aplikimi për përfitimin e kategorive nga kandidatët bëhet pranë njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, funksionin e Këshillit Shkencor e kryen Këshilli Shkencor i institutit kërkimor-shkencor, me të cilin njësia e veçantë e kërkimit shkencor ka lidhur marrëveshje për këtë qëllim.

12. Drejtuesi i institutit kërkimor shkencor përkatës lëshon aktin e miratimit të kategorisë, brenda 5 (pesë) ditëve punë nga vlerësimi i Këshillit Shkencor, për përfitimin e kategorisë përkatëse për punonjësin kërkimor-shkencor.

13. Kategoria e përfituar, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, mund të transferohet në institutin ose në njësinë e veçantë kërkimore-shkencore, brenda së njëjtës fushë të kërkimit shkencor.

14. Procedura e ankimimit bëhet sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

15. Për institutet ose njësitë e veçanta kërkimore-shkencore, të cilat krijohen për herë të parë, kategoritë e punonjësve kërkimorë-shkencorë do të përcaktohen nga institutet ekzistuese, sipas fushës së kërkimit shkencor që ato mbulojnë, ose, në rast të mungesës së tyre, do të jepen nga drejtuesi i njësisë kryesore në institucione të arsimit të lartë, lloji "universitet", që kanë të drejtë të japin tituj dhe mbulojnë fushën përkatëse të kërkimit shkencor.

16. Kandidatët që gëzojnë gradën shkencore "Doktor" dhe provojnë nëpërmjet dokumentacionit, që kanë ushtruar veprimtari në fushat përkatëse të kërkimit shkencor për më shumë se 5 (pesë) vjet, e përfitojnë kategorinë "kërkues-shkencor i avancuar" ose "drejtues kërkimor-shkencor", pa përmbushur përcaktimet e shkronjës "a", të pikës 4, dhe të shkronjës "a", të pikës 5, të këtij vendimi.

17. Kandidatëve që zotërojnë titujt akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", në rast të angazhimit në institutin e kërkimit shkencor ose në njësi të veçantë të kërkimit shkencor u caktohet kategoria "drejtues kërkimor-shkencor", pavarësisht kritereve të përcaktuara në këtë vendim.

18. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor, institutet dhe njësitë e veçanta kërkimore-shkencore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 794, datë 24.12.2025

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË, PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT "PËRPARIMI I SHËNDETIT NEONATAL DHE I NËNËS NË SHQIPËRI (ANMA)-AID 013307"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI**:**

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për zbatimin e projektit "Përparimi i shëndetit neonatal dhe i nënës në Shqipëri (ANMA)-AID 013307", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË

Për zbatimin e Projektit **"Përparimi i Shëndetit Neonatal dhe i Nënës në Shqipëri (ANMA) – AID 013307"** (në vijim i referuar si "Projekti"),

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (në vijim e referuar si "KM") e përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS), dhe Qeveria e Republikës Italiane (në vijim e referuar si "QRI") e përfaqësuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim për Zhvillim (MAECI - DCGS) në vijim të referuara individualisht si "Pala" dhe kolektivisht si "Palët", kanë vendosur të lidhin këtë Marrëveshje (në vijim e referuar si "Marrëveshja"),

duke dëshiruar të kontribuojnë në arritjen e objektivave të zhvillimit të Shqipërisë, si dhe të kontribuojnë në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe në përafrimin me *Acquis Communautaire;*

duke riafirmuar kuadrin e prioriteteve të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Shqipërisë për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE 2022–2030) dhe Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021–2030;

duke kujtuar Marrëveshjen Kuadër të Bashkëpunimit për Zhvillim ndërmjet Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të nënshkruar në Tiranë më 2 dhjetor 2008;

duke pasur parasysh se Agjencia Italiane për Bashkëpunim për Zhvillim (AICS) është themeluar me ligjin 125/2014 si një agjenci autonome, funksionale që nga 1 janari 2016 dhe përgjegjëse për identifikimin, formulimin, zbatimin, financimin dhe monitorimin e projekteve të bashkëpunimit për zhvillim nën udhëheqjen politike të Ministrisë Italiane të Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar (MAECI);

duke pasur parasysh se Statuti i AICS-së është miratuar me dekretin ndërministror nr. 113/2015 dhe parashikon mjetet financiare të Agjencisë (neni 13);

duke pasur parasysh se Deklarata e Qëllimit ndërmjet Agjencisë Italiane për Bashkëpunim për Zhvillim – Zyra e Tiranës (në vijim e referuar si "AICS Tirana") dhe MSHMS-së është nënshkruar në Tiranë më 10 mars 2025;

duke pasur parasysh se Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet "Azienda Socio Sanitaria Territoriale Fatebenefratelli-Sacco" (në vijim i referuar si "ASST FBF Sacco") dhe MSHMS është nënshkruar më 22 maj 2025;

duke pasur parasysh se më 19 maj 2025, MHSW paraqiti për shqyrtim tek "AICS Tirana" një kërkesë zyrtare për kontribut për të përmirësuar kujdesin intensiv neonatal në Shqipëri me Asistencën Teknike të ASST FBF Sacco italiane;

duke pasur parasysh se Komiteti i Përbashkët i Bashkëpunimit për Zhvillim i MAECI-t ka miratuar financimin e Projektit **"Përmirësimi i Shëndetit Neonatal dhe i Nënës në Shqipëri – ANMA – AID 013307"** më 12 qershor 2025,

Palët, duke njohur dhe respektuar parimet demokratike dhe të drejtat themelore të njeriut, bien dakord, si më poshtë.

Neni 1
Fusha e zbatimit të marrëveshjes

Kjo Marrëveshje synon:

- përcaktimin e detyrimeve të ndërsjella të Palëve në lidhje me zbatimin e Projektit;
- përcaktimin e procedurave të menaxhimit, kreditimit, disbursimit, prokurimit, monitorimit, vlerësimit, kontrollit dhe raportimit në lidhje me zbatimin e Projektit.

Kjo Marrëveshje do të lexohet dhe kuptohet në përputhje me Marrëveshjen Kuadër të Bashkëpunimit për Zhvillim ndërmjet Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane të nënshkruar në Tiranë më 2 dhjetor 2008.

Neni 2
Përbërja dhe përmbajtja

Kjo Marrëveshje përbëhet nga 20 nene, si dhe tri shtojcat e mëposhtme:

- Shtojca I: Dokumenti i Projektit, i cili përmban një përshkrim të detajuar të Projektit.
- Shtojca II: Klauzolat Etike dhe Parimet e Përgjithshme për prokurimin dhe ekzekutimin e kontratave.
- Shtojca III: Rregullat e përgjithshme të zbatueshme për procedurat e prokurimit.

Shtojcat e lartpërmendura përbëjnë pjesë integrale të Marrëveshjes dhe përcaktojnë procedurat dhe mekanizmat për përdorimin e fondeve dhe zbatimin e aktiviteteve në kuadër të projektit **"Përmirësimit të Shëndetit Neonatal dhe i Nënës në Shqipëri – ANMA – AID 013307"**. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në interpretim, teksti i Marrëveshjes do të ketë përparësi mbi Shtojcat.

Neni 3
Objektivat e projektit

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është ulja e vdekshmërisë së nënave dhe foshnjave në Shqipëri.

Objektivi specifik i projektit është të sigurojë që të porsalindurit dhe nënat në Spitalin Universitar Obstetrik- Gjinekologjik "Koço Gliozheni", Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë" dhe Spitalet Rajonale të Dibrës dhe Fierit të marrin kujdes shëndetësor cilësor në ambiente moderne, të sigurta dhe të pajisura në nivel të mjaftueshëm që përmbushin standardet ndërkombëtare.

Neni 4
Kontributi financiar i palëve

4.1 Kontributi i QRI-së

MAECI do t'i japë MSHMS-së një kontribut financiar total prej **4,000,000.00 EURO** (katër milionë Euro /00), (në vijim i referuar si "Granti") për

i. punimet e rinovimit të njësive të kujdesit intensiv dhe sub-intensiv neonatal në Spitalin Universitar të Obstetrikës dhe Gjinekologjisë "Koço Gliozheni"

ii. blerjen e pajisjeve për përmirësimin e kujdesit intensiv neonatal në Shqipëri për Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni", Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë" dhe Spitalet Rajonale të Dibrës dhe Fierit. Financimi i grantit është tërësisht i palidhur.

4.2 Kontributi i KM-së

MSHMS-ja, duke vepruar në emër të KM-së, do të garantojë mirëmbajtjen dhe përdorimin e saktë të ambienteve të rinovuara dhe pajisjeve të blera gjatë zbatimit të Projektit dhe pas përfundimit të tij. Kjo përfshin sigurimin e materialeve të nevojshme të konsumit dhe mirëmbajtjen për të lejuar funksionimin e saktë të pajisjeve të blera me Grantin sipas parimeve të efektivitetit të kostos.

MSHMS-ja do të garantojë që ambientet e rinovuara dhe pajisjet e ofruara sipas kësaj Marrëveshjeje do të përdoren ekskluzivisht për qëllime publike. Në asnjë rrethanë këto ambiente ose pajisje nuk do të përdoren në një mënyrë që u sjell përfitim pacientëve që paguajnë, dhe ky angazhim do të mbetet në fuqi përgjithmonë.

KM-ja do të garantojë që të gjitha shpenzimet e kryera sipas kësaj Marrëveshjeje të përjashtohen nga pagesa e të gjitha taksave, TVSH-së, detyrimeve dhe çdo takse tjetër që duhet të paguhet në Shqipëri.

MSHMS-ja do të mbulojë shpenzimet që lidhen me çdo tarifë pastrimi dhe magazinimi të shkaktuar gjatë zbatimit të Projektit.

MSHMS-ja do të sigurohet që të gjitha pajisjet e zëvendësuara nga Projekti në Spitalin Universitar

Obstetrik dhe Gjinekologjik "Koço Gliozheni" dhe Spitalin Universitar Obstetrik dhe Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë", të cilat janë funksionale dhe në gjendje të mirë, do të përdoren për të pajisur njësitë e kujdesit intensiv dhe sub-intensiv neonatal të spitaleve rajonale të përzgjedhura. Alokimi i pajisjeve të përmendura do të miratohet nga Komiteti Drejtues.

Neni 5
Institucionet dhe organet e përfshira në zbatimin e marrëveshjes

Institucionet dhe Organet kryesore të përfshira në zbatimin e Marrëveshjes janë:

5.1 Për QRI-në:

Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin për Zhvillim të Ministrisë Italiane të Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar (MAECI-DGCS) që përfaqëson Qeverinë e Italisë për Marrëveshjen.

Ambasada e Italisë në Tiranë, e cila vepron në nivel lokal në emër të MAECI/DGCS.

Agjencia Italiane për Bashkëpunimin për Zhvillim (AICS), Institucioni Publik Italian përgjegjës për identifikimin, formulimin, zbatimin, financimin dhe monitorimin e projekteve të bashkëpunimit për zhvillim nën udhëheqjen politike të Ministrisë Italiane të Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar.

Zyra e AICS-së në Tiranë, e cila përfaqëson AICS-në në Shqipëri për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen e aktivitetit të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë.

ASST FBF Sacco, përgjegjëse për ofrimin e trajnimeve për personelin e MSHMS-së të dedikuar për kujdesin neonatal dhe atë të nënës-fëmijës, si dhe asistencë teknike për MSHMS-në për forcimin e kapaciteteve të personelit të kujdesit shëndetësor, forcimin e sistemeve të referimit, përcaktimin e standardeve për pajisjet mjekësore, sigurimin që investimet në infrastrukturë të jenë në përputhje me një vizion afatgjatë dhe të qëndrueshëm.

5.2 Për KM-në:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS), e cila përfaqëson KM-në si homologe e QRI-së për këtë Marrëveshje, nënshkruese e Marrëveshjes dhe përgjegjëse për ekzekutimin e Projektit.

5.3 Për Palët:

Palët, pasi të kenë informuar siç duhet të gjitha Institucionet dhe Organet e lartpërmendura, do t'u japin një kopje të kësaj Marrëveshjeje. Palët do të sigurojnë që Institucione dhe Organe të tilla do të përmbushin, për sa i përket secilës prej tyre, detyrimet e Marrëveshjes.

Neni 6
Qeverisja e projektit

6.1 Komiteti Drejtues

Do të ngrihet një Komitet Drejtues (në vijim i referuar si "KD"). Ai do të përbëhet nga një përfaqësues i MSHMS-së, një përfaqësues i "AICS Tirana", një përfaqësues i ASST FBF Sacco dhe, si vëzhgues, Drejtorët e Spitalit Universitar të Obstetrikës dhe Gjinekologjisë "Mbretëresha Geraldinë" dhe Spitalit Universitar të Obstetrikës dhe Gjinekologjisë "Koço Gliozheni", dy spitalet e nivelit terciar në Shqipëri për kujdes intensiv neonatal, të cilat shërbejnë si pika referimi për të gjitha spitalet në vend. KD do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e përgjithshme të Projektit. Ai do të mblidhet të paktën çdo gjashtë muaj për të vlerësuar ecurinë drejt arritjes së objektivave, përputhshmërinë me politikat sektoriale kombëtare dhe për të miratuar Planin Operacional Vjetor (PVO) të propozuar nga MSHMS-ja për Grantin. Ai do të mblidhet me kërkesë të njërit prej anëtarëve të tij, ose në çdo kohë që kërkohen vendime. Shpenzimet që lidhen me pjesëmarrjen në takime, nëse ka, do të mbulohen nga institucionet përkatëse.

Dokumentet e mëposhtme do t'i paraqiten për miratim Komitetit Drejtues:

a) Plani i prokurimit;

b) Ndryshimet në planin e prokurimit;

c) Raportet e progresit dhe shpenzimeve të programit;

d)Alokimi i pajisjeve të papërdorura nga Spitali Universitar i Obstetrikës dhe Gjinekologjisë "Mbretëresha Geraldinë" dhe Spitali Universitar i Obstetrikës dhe Gjinekologjisë "Koço Gliozheni" te spitalet rajonale.

Dokumentet e mëposhtme duhet t'i paraqiten për miratim Komitetit Drejtues, përpara se të miratohen nga AICS Romë:

a) Rishpërndarjet e buxhetit dhe zgjatjet e Programit;

b) Raportet financiare vjetore dhe përfundimtare të certifikuara;

c) Raporti përmbyllës;

d) Termat e referencës së vlerësimit përfundimtar, auditimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare.

Vendimet e Komitetit Drejtues miratohen unanimisht.

6.2 Zbatimi i Projektit

Zbatimi i Projektit do të jetë nën përgjegjësinë e MSHMS-së. MSHMS-ja do të caktojë ose rekrutojë personel kyç për t'u përfshirë në zbatimin e Projektit për të krijuar një Njësi të Menaxhimit të Projektit, roli dhe përgjegjësitë e së cilës përcaktohen në paragrafin vijues.

Njësia e Menaxhimit të Projektit (në vijim e referuar si "NJMP") do të jetë përgjegjëse për ekzekutimin e Grantit të dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje. NJMP-ja do të mbështetet nga personeli i MSHMS-së dhe do të koordinohet nga një Menaxher Projekti. Ai/ajo do të nënshkruajë të gjitha raportet dhe kërkesat për transferimin e fondeve sipas dispozitave përkatëse të Projektit dhe do të ketë përgjegjësinë ndaj palëve për të garantuar zbatimin e plotë të Projektit. NJMP-ja, nën udhëheqjen e përgjithshme të KD-së, do të drejtojë dhe koordinojë gjithashtu zbatimin e trajnimit dhe asistencës teknike të ofruar për Projektin nga ASST FBF Sacco.

Neni 7

Modalitetet e dhënies së fondeve italiane

QRI-ja, sipas kësaj Marrëveshjeje, angazhohet të sigurojë burime financiare siç përcaktohet në nenin 4.1.

7.1 Llogaritë bankare

Burimet financiare të ofruara nga QRI-ja sipas kësaj Marrëveshjeje, do të transferohen në "Llogarinë e dedikuar për Projektin të Thesarit Shtetëror të Ministrisë së Financave".

Fondet do të transferohen në Llogarinë e dedikuar për Projektin të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe do të përdoren ekskluzivisht për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

7.2 Këstet

Në përputhje me klauzolat e mëposhtme të kësaj Marrëveshjeje, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, AICS do të transferojë fondet në tri këste:

Kësti I	Kësti II	Kësti III	Totali
1,500,000.00 EURO	1,500,000.00 EURO	1,000,000.00 EURO	4,000,000.00 EURO

sipas procedurave të mëposhtme të kreditimit

7.3 Procedurat e kreditimit

Kësti i parë

Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, duhet të përmbushen kushtet paraprake të mëposhtme para nisjes së procedurës së shpërndarjes të kështit të parë:

1. MSHMS-ja duhet të ketë krijuar NJMP-në;

2. MSHMS-ja duhet të ketë informuar "AICS Tirana", në lidhje me detajet e "Llogarisë së Dedikuar"; NJMP-ja duhet të paraqesë një kërkesë specifike për disbursimin e kështit në "AICS Tirana", të shoqëruar me Planin Vjetor Operacional.

Kusht paraprak për disbursimin e **kësteve të mëposhtme**

Kësti i dytë

Kësti i dytë do të disbursohet pas miratimit nga AICS-ja të Raportit Financiar që lidhet me kështin e parë, të certifikuar nga firma e auditimit, në bazë të kushteve të mëposhtme:

60% e transhit të parë të shpenzohet dhe të paktën 80% të angazhohet.

Kësti i tretë

Kësti i tretë do të disbursohet pas miratimit nga AICS-ja të Raportit Financiar që lidhet me kështin e parë dhe të dytë, të certifikuar nga firma e auditimit, në bazë të kushteve të mëposhtme:

1. 60% e kështit të dytë të shpenzohet dhe të paktën 80% të angazhohet;

2. të paktën 90% e kështit të parë të shpenzohet.

7.4 Taksat

Kontributi italian, siç detajohet në nenin 4.1 të kësaj Marrëveshjeje, nuk do të mbulojë taksat, TVSH-në, detyrimet, tarifat e zhdoganimit dhe magazinimit dhe çdo taksë tjetër që duhet të paguhet në Shqipëri. Në rast se ndonjë nga shpenzimet e mësipërme është e nevojshme për ekzekutimin e aktiviteteve të Projektit, ato do të mbulohen nga KM-ja.

Neni 8

Aktivitetet dhe raportet financiare

8.1 Plani vjetor operacional

Brenda dy (2) muajve nga marrja e çdo kësti, MSHMS-ja duhet të përgatisë Planin Vjetor Operacional (PVO) në lidhje me shumën e plotë të

fondeve të marra. Çdo PVO duhet të paraqitet nga NJMP-ja dhe të miratohet nga Komiteti Drejtues.

8.2 Aktivitete të tjera dhe raporte financiare

MSHMS-ja do të paraqesë një raportim përfundimtar financiar/administrativ dhe teknik tek "AICS Tirana" çdo gjashtë (6) muajve (Raporti Gjashtëmujor - SAR).

Raporti do të analizojë shfrytëzimin e fondeve të Projektit, duke përfshirë proceset e prokurimit.

SAR-ja do të përfshijë dy seksione që raportojnë përshkrimin e aktiviteteve të kryera (seksioni i parë) dhe informacionin përkatës financiar, administrativ, të prokurimit (seksioni i dytë). I pari nga këto raporte do të mbulojë aktivitetet e gjashtëmujorit (6-mujorit) të parë, duke filluar nga data kur janë kredituar fondet. SAR mund të korrespondojë me Raportin e Ndërmjetëm të Kërkesave që duhet t'i bashkëlidhet kërkesës për transhe (përveç të parit).

MSHMS-ja do të sigurojë një raportim përfundimtar financiar/administrative dhe Teknik "AICS Tirana" brenda gjashtë (6) muajve nga përfundimi i Projektit.

Aktivitetet e monitorimit të përditshëm të Projektit do të jenë përgjegjësi e MSHMS-së në bashkëpunim me ASST FBF Sacco dhe do të kryhen në përputhje me Dokumentin e Projektit.

NJMP-ja është përgjegjëse për mirëmbajtjen e një sistemi të përditësuar kontabël që përmban të dhëna për të garantuar saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit dhe raportimit financiar të Projektit. Sistemi kontabël duhet gjithashtu të garantojë që dokumentet mbështetëse (pasqyrat e shpenzimeve, dokumentet e tenderit, dokumentet e kontratës etj.) të identifikohen në mënyrë të duhur dhe që linjat buxhetore të miratuara/të ndryshuara të mos tejkalohen. Dokumentet origjinale duhet të mbahen në zyrat e MSHMS-së. Sistemi kontabël dhe/ose mbajtja e të dhënave duhet të gjurmojë paradhëniet e marra dhe të dhënat e shpenzimeve nga Projekti. Raportet financiare, pasqyrat e shpenzimeve të ekzekutuara dhe kontratat duhet t'i paraqiten KD-së sa herë që kërkohet.

Neni 9

Aktivitetet e auditimeve të jashtme dhe të monitorimit dhe të vlerësimit

9.1 Modalitetet e auditimit

Auditimet do të kryhen nga një shoqëri e pavarur auditimi. Shoqëria e pavarur e auditimit do të zgjidhet duke ndjekur rregulloret e Udhëzuesit Praktik mbi Procedurat e Kontraktuale për Veprimin e Jashtëm të Bashkimit Evropian (PRAG) mbi prokurimin publik dhe duhet të ndjekë standardet ndërkombëtare të auditimit të miratuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC), Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Larta të Auditimit (INTOSAI) ose institucione ndërkombëtare ekuivalente.

Termat e referencës së auditimeve do t'i paraqiten për miratim Komitetit Drejtues.

Çdo shumë fondesh e shpenzuar që mbetet e paauditуar pas përfundimit të aktiviteteve të Projektit, do t'i kthehet QRI-së.

Raportet e auditimit duhet gjithashtu të vërtetojnë ligjshmërinë e kontratave të punës që arrijnë në më pak se 300,000.00 EURO (treqind mijë Euro) dhe kontratave për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve që arrijnë në më pak se 100,000.00 EURO (njëqind mijë Euro).

Përfaqësuesit e AICS-së kanë të drejtë:

a) të kryejnë auditime ose inspektime që çmohen të nevojshme në lidhje me përdorimin e fondeve të Projektit, bazuar në të gjithë dokumentacionin përkatës;

b) të inspektojnë llogaritë dhe të dhënat e furnizuesve dhe kontraktorëve që lidhen me zbatimin e kontratave

Raporti i Kërkesës së Përkohshme (RKP) duhet të mbështetet nga një audit i jashtëm që vërteton rregullsinë e shpenzimeve dhe pagesave të prokurimit. Auditimi duhet, gjithashtu, të vërtetojë përputhshmërinë e procedurave të prokurimit në përputhje me shtojcën III.

9.2 Informacioni, monitorimi dhe vlerësimi

Palët do të bashkëpunojnë plotësisht për të garantuar që qëllimi i kësaj Marrëveshjeje të realizohet. Në këtë kuadër, Palët do të shkëmbejnë opinione dhe do t'i sigurojnë njëra-tjetrës të gjitha të dhënat që lidhen me zbatimin, dokumentacionin dhe informacionin. Palët gjithashtu do të ofrojnë ndihmën e ndërsjellë të nevojshme në kryerjen e detyrave të Palëve dhe do të ofrojnë të gjithë mbështetjen e nevojshme në lidhje me çështjet administrative, për të lehtësuar zbatimin e saktë të Projektit.

Projekti do të monitorohet sipas Planit të Monitorimit të përshkruar në Dokumentin e Projektit. Secila Palë ka të drejtë të kryejë aktivitete monitorimi të ekzekutimit të Projektit sa herë që e

çmon të nevojshme. Secila Palë do të ofrojë të gjithë mbështetjen e nevojshme në lidhje me aktivitetet e monitorimit për të lehtësuar zbatimin e tij.

Një Vlerësim i Jashtëm i Projektit do të kryhet në përfundim të Projektit. Vlerësimet e Brendshme të Projektit mund të kryhen me kërkesë të të dyja Palëve. Vlerësimi i Jashtëm Përfundimtar do të kryhet nga një shoqëri/konsulent i pavarur. Shoqëria/konsulenti i pavarur do të përzgjidhet duke ndjekur rregulloret e PRAG për prokurimin publik dhe do të ndjekë standardet ndërkombëtare të vlerësimit

Termat e referencës së vlerësimit duhet t'i paraqiten për miratim Komitetit Drejtues.

Palët do të kenë të drejtë të kryejnë, me shpenzimet e tyre, të gjitha aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit, kontrollit dhe auditimit që do të çmohen të nevojshme. Aktivitetet e vlerësimit të përbashkët (të vazhdueshëm, përfundimtar dhe *ex-post)* do të organizohen nga MAECI-DGCS dhe/ose AICS-së nëpërmjet zyrave të tyre në Tiranë sa herë që të çmohet e përshtatshme.

Neni 10
Përdorimi i fondeve italiane

10.1 Periudha e zbatimit

Pala Italiane do të ofrojë, në kuadër të Projektit, një Grant deri në 4,000,000.00 (katër milionë) Euro gjatë një periudhe prej tridhjetë e gjashtë (36) muajsh për të financuar aktivitete për përmirësimin e kujdesit intensiv neonatal në Shqipëri.

10.2 Rialokimi i fondeve

Rialokimet e linjave buxhetore në lidhje me Buxhetin e Projektit në Euro, të detajuara në Dokumentin e Projektit, lejohen gjatë përgatitjes së POV-ve. Kërkesat për rialokim të fondeve që nuk tejkalojnë 25% të linjës makro të buxhetit, do të miratohen nga KD-ja dhe do të dorëzohen nga NJMP-ja në "AICS Tirana" për miratim. Nuk kërkohen ndryshime.

Kërkesat për rialokime të fondeve që tejkalojnë 25% të buxhetit, do të miratohen nga Palët nëpërmjet një ndryshimi të kësaj Marrëveshjeje, me anë të shkëmbimeve të Notave Verbale të cilat do të jenë pjesë integrale e Marrëveshjes dhe do të hyjnë në fuqi në datën e përgjigjes së Notës Verbales.

10.3 Interesat e akumuluar dhe kursimet

Interesi i akumuluar në Projekt ose fitimi që rezulton nga transaksionet financiare në llogarinë bankare të dedikuar, do të përdoret për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, duke ndjekur procedurat e zbatuara për kontributin, me miratimin paraprak të KD-së.

10.4 Aktivitetet e prokurimit

Aktivitetet e prokurimit, të lidhura me punimet, mallrat dhe shërbimet, do të kryhen në nivel lokal nga MSHMS-ja, me asistencën teknike të ASST FBF Sacco, sipas alokimeve buxhetore dhe duke ndjekur (PRAG) dhe dispozitat e përfshira në Shtojcën III. Ato duhet të plotësojnë kriteret e pranueshmërisë për kontraktorët, kostot e pranueshme dhe të papranueshme, klauzolat etike dhe kushtet e përgjithshme të kontratës. Punimet, mallrat dhe shërbimet e siguruara sipas kësaj Marrëveshjeje, do të ndjekin rregulloret e (PRAG).

AICS-ja ka të drejtën të rishikojë vendimet e prokurimit të MSHMS-së, në mënyrë që të sigurojë që aktivitetet të kryhen në mënyrë transparente dhe efikase, në përputhje me parimet e përcaktuara të kësaj Marrëveshjeje.

Në çdo rast, "AICS Tirana" rezervon të drejtën për të marrë pjesë në të gjitha fazat e proceseve të lartpërmendura të prokurimit në cilësinë e "Vëzhguesit".

10.5 Tërheqja e fondeve

Në rast të progresit të pakënaqshëm të Projektit, si rezultat i misioneve të shqyrtimit të kryera nga MAECI-DGCS-ja dhe/ose AICS-ja, dhe të një vendimi formal pasues për tërheqjen e fondeve nga Projekti, të njoftuar Qeverisë së Shqipërisë, fondet italiane të disbursuara dhe të pashpenzuara, përfshirë interesin e akumuluar, do t'i vihen në dispozicion QRI-së brenda tre (3) muajve pas njoftimit.

Neni 11
Detyrimet për palën shqiptare

KM-ja do të sigurojë që fondet italiane të llogariten siç duhet dhe në kohë brenda buxhetit për vitin fiskal të caktuar.

MSHMS-ja do t'i komunikojë "AICS Tirana", me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të dhënat e llogarisë bankare sipas çka përshkruhet në nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje.

KM-ja do të garantojë që të gjitha organet dhe institucionet shqiptare të përfshira në zbatimin e Projektit, të respektojnë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, në veçanti raportet financiare dhe

teknike, të kërkuara për disbursimet e fondeve që do të dorëzohen në kohë në AICS sipas neneve 7 dhe 8 të kësaj Marrëveshjeje.

MSHMS-ja është përgjegjëse për të garantuar zbatimin e Projektit në përputhje me këtë Marrëveshje dhe do të jetë përgjegjëse për kërkimin e përjashtimit nga pagesa e taksave dhe detyrimeve të tjera doganore.

MSHMS-ja do të lejojë AICS-në të kryejë aktivitete mbikëqyrjeje, monitorimi dhe verifikimi në lidhje me zbatimin e Projektit, duke përfshirë dhënien e aksesit në vendet e Projektit dhe dokumentacionin teknik dhe financiar përkatës.

MSHMS-ja do të ruajë të gjithë dokumentacionin që lidhet me procedurat e prokurimit dhe kontraktuale (duke përfshirë dokumentet origjinale të tenderit, dosjet e prokurimit dhe të gjithë korrespondencën përkatëse gjatë viteve pas zbatimit të aktiviteteve) për një periudhë prej pesë (5) vjetësh pas përfundimit të aktiviteteve.

Neni 12
Detyrimet për palën italiane

QRI-ja do të disbursojë shumën totale të rënë dakord sipas procedurave të përshkruara në nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje.

AICS-ja do të kryejë të gjitha aktivitetet e kërkuara për mbikëqyrjen dhe monitorimin e Projektit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë efikasitetit të përdorimit të fondeve dhe efektivitetit të zbatimit të Projektit.

Neni 13
Ligji i zbatueshëm

Kjo Marrëveshje do të zbatohet në përputhje me legjislacionin italian dhe atë shqiptar, si dhe me të drejtën ndërkombëtare në fuqi dhe, për Palën Italiane, me detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi i Italisë në Bashkimin Evropian.

Neni 14
Mbrojtja e të dhënave personale

Në kuadër të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, asnjë informacion në lidhje me individët ose që mundëson identifikimin e tyre, nuk do t'u transmetohet palëve të treta ose nuk do të përpunohet në një mënyrë të papajtueshme me qëllimet e rëna dakord, pa pëlqimin paraprak me shkrim të kontrolluesit të të dhënave që e ka dhënë këtë informacion.

Neni 15
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet në me mirëkuptim me anë të negociatave dhe/ose konsultimeve të drejtpërdrejta midis Palëve nëpërmjet kanaleve diplomatike.

MAECI-DCGS-ja dhe AICS-ja nuk do të përfshihen në ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet Palës Shqiptare dhe palëve të treta që rrjedhin nga proceset e prokurimit ose aktivitete të tjera të kryera në kuadër të Projektit.

Neni 16
Pengesat dhe forca madhore

Në rast pengesash për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje për shkak të rasteve të forcës madhore, të tilla si lufta, përmbytjet, zjarri, tajfuni, tërmeti, konfliktet dhe grevat e punës, trazirat civile, aktet e ndonjë qeverie, vështirësitë e papritura në transport dhe raste të tjera që do të njihen nga të dyja Palët me marrëveshje si forcë madhore sipas praktikës ose në rast rreziku ose kushtesh të pasigurta për personelin, do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

- Në rast se kohëzgjatja e pengesës për zbatimin e Projektit është më pak se gjashtë (6) muaj, përdorimi i fondeve do të pezullohet derisa MAECI-DGCS të autorizojë rifillimin e aktiviteteve.
- Në rast se kohëzgjatja e pengesës për zbatimin e Projektit është më shumë se gjashtë (6) muaj, Projekti do të pezullohet dhe fondet e mbetura do të mbahen derisa pengesa të përfundojë dhe MAECI-DGCS të autorizojë rifillimin e aktiviteteve të Projektit;
- Aktivitetet e vazhdueshme që po kryhen në vendet që nuk preken nga pengesat e përmendura në paragrafin pararendës të këtij neni, do të vazhdojnë deri në përfundimin e tyre.

Neni 17
Parandalimi i abuzimit dhe përdorimit të paligjshëm të fondeve

17.1 Parandalimi i abuzimit dhe përdorimit të paligjshëm të fondeve

KM-ja do të garantojë që fondet e ofruara nga QRI-ja sipas kësaj Marrëveshjeje, do të përdoren rigorozisht në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Qeveria e Republikës së Italisë angazhohet të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të siguruar një administrim efikas të fondeve të lartpërmendura dhe për të parandaluar çdo abuzim dhe përdorim të paligjshëm të tyre. Nëse fondet përdoren në një mënyrë që nuk përputhet me metodat dhe objektivat e përcaktuar në këtë Marrëveshje, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'ia kthejë pjesën e fondeve të përdorura në mënyrë të papërshtatshme QRI-së.

17.2 Pranueshmëria e kostove

Kostot direkte janë të pranueshme për financim nga QRI-ja, nëse plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:

a) janë të nevojshme për kryerjen e Projektit, që i atribuohen drejtpërdrejt atij, të cilat rrjedhin si pasojë e drejtpërdrejtë e zbatimit të tij dhe ngarkohen në raport me përdorimin aktual;

b) ato janë kryer në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;

c) janë kryer realisht nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, d.m.th. përfaqësojnë shpenzime reale të kryera në mënyrë të qartë dhe reale nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

d) janë të arsyeshme, të justifikuara, përputhen me parimin e Menaxhimit të Qëndrueshëm Financiar dhe janë në përputhje me praktikat e zakonshme të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, pavarësisht nga burimi i tyre i financimit;

e) janë kryer gjatë Periudhës së Zbatimit, me përjashtim të kostove që lidhen me raportin përfundimtar, vlerësimin përfundimtar, auditimin dhe kostot e tjera të lidhura me mbylljen e Projektit, të cilat mund të kryhen pas Periudhës së Zbatimit;

f) janë të identifikueshme dhe të mbështetura nga dokumente mbështetëse, në veçanti të përcaktuara dhe të regjistruara në përputhje me praktikat kontabël të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

g) mbulohen nga një nga nëntitujt e specifikuar në buxhetin e llogaritur dhe nga aktivitetet e përshkruara në Shtojcën I;

h) përputhen me legjislacionin tatimor dhe social në fuqi, duke marrë parasysh privilegjet dhe imunitetet e MSHMS-së.

Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të pranueshme për financim nga QRI-ja:

a) bonuset, provizionet, rezervat ose kostot që nuk lidhen me shpërblimin. Kontributet e punëdhënësve në fondet e pensioneve ose fondet e tjera të sigurimeve të drejtuara nga Qeveria e Indisë, mund të jenë të pranueshme vetëm në masën që nuk i tejkalojnë pagesat aktuale të bëra nga këto skema dhe që shuma e parashikuar nuk tejkalon kontributin që mund të ishte bërë në një fond të jashtëm;

b) kostoja e plotë e blerjes së pajisjeve dhe aseteve, përveç nëse aseti ose pajisjet blihen posaçërisht për Projektin dhe pronësia transferohet;

c) detyrimet, taksat dhe tarifat, përfshirë TVSH-në, që janë të rikuperueshme/të zbritshme nga Qeveria e Italisë;

d) kthimi i kapitalit;

e) borxhet dhe tarifat e shërbimit të borxhit;

f) provizionet për humbjet, borxhet ose detyrimet e mundshme në të ardhmen;

g) kostot e shkaktuara gjatë pezullimit të zbatimit të Marrëveshjes, përveç kostove minimale të rëna dakord nga Palët;

h) kostot e deklaruara nga QRI-ja sipas një marrëveshjeje tjetër të financuar nga Qeveria e Italisë ose donatorë të tjerë;

i) kostot e blerjes së tokës ose ndërtesave.

Neni 18
Zgjidhja e marrëveshjes

QRI-ja rezervon të drejtën për të zgjidhur këtë Marrëveshje në rastet e mëposhtme, për shkak të parregullsisë së rëndë nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe MSHMS-ja, të tilla si:

- Vonesa të paarsyeshme dhe të zgjatura në përdorimin e fondeve të cilat rrezikojnë arritjen e objektivave të Projektit;
- Përdorimi i fondeve për qëllime të ndryshme nga ato të përfshira në këtë Marrëveshje dhe shtojcat ose ndryshimet e saj;
- Menaxhimi i papërgjegjshëm i fondeve;
- Në rast të moszbatimit ose mos-raportimit të

Projektit në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje;

- Në rast pengese ose force madhore sipas nenit 16 të kësaj Marrëveshjeje.

Në rast të parregullsisë së rëndë të lartpërmendur, MAECI-DGCS do të njoftojë me shkrim Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS) për rastin, duke e ftuar atë të marrë masat e nevojshme për të zgjidhur parregullsinë brenda maksimumi dy (2) muajve nga data e njoftimit. Pas përfundimit të këtij afati kohor, MAECI-DGCS rezervon të drejtën për ta ndërprerë menjëherë këtë Marrëveshje. Në këtë rast, do të zbatohen dispozitat e nenit 20.3 të kësaj Marrëveshjeje.

Në të gjitha rastet e përmendura më sipër, pas njoftimit të parashikuar në nenin 20.3, MSHMS-ja do të ndalojë të gjitha aktivitetet e Projektit, përveç nëse është rënë dakord ndryshe midis dy Palëve.

Neni 19

Amendimi i marrëveshjes

Ky Dokument dhe Shtojcat e tij përbëjnë Marrëveshjen e plotë ndërmjet Palëve. Çdo modifikim ose amendim do të jetë i vlefshëm vetëm nëse bëhet me shkrim dhe është rënë dakord nga të dyja Palët. Në varësi të pajtueshmërisë së plotë me Statutet e saj, asnjë Palë nuk do të jetë e detyruar t'i përmbahet ndonjë termi, përfaqësimi, garancie ose premtimi të shprehur ose të nënkuptuar që nuk është deklaruar shprehimisht këtu ose nuk është përcaktuar me ligj.

Palët mund ta ndryshojnë këtë Marrëveshje, në çdo kohë, me anë të shkëmbimit të "Notave Verbales". Marrëveshja Ndryshuese do të hyjë në fuqi duke ndjekur të njëjtën procedurë të përcaktuar në nenin 20.1.

Neni 20

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

20.1 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së të dyja njoftimeve të fundit me anë të të cilave Palët i kanë komunikuar njëra-tjetrës përfundimin e procedurave të tyre të brendshme, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

20.2 Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi derisa të përfundojnë shpenzimet, Raporti i Përfundimit dhe Raporti Financiar Përfundimtar i Certifikuar të miratohen nga Komiteti Drejtues.

20.3 Përfundimi

Marrëveshja mund të ndërpritet nga secila Palë, duke dhënë njoftim me shkrim 3 (tre) muaj përpara, nëpërmjet rrugëve diplomatike, mbi qëllimin e saj për të ndërprerë Marrëveshjen. Fondet e pashpenzuara ose të paangazhuara në datën e ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje, do t'i kthehen QRI-së.

Nëse, për ndonjë arsye, ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje nuk mund të përfundojë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, Palët do të konsultohen me njëra-tjetrën për këtë çështje. Fondet e pakrediturara dhe/ose të paangazhuara ende do të përdoren vetëm me një marrëveshje specifike ndërmjet Palëve, përndryshe do t'i kthehen QRI-së.

20.4 Pikat e kontaktit

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, adresat e mëposhtme specifikohen për dorëzimin zyrtar të dokumenteve:

Për MAECI-DGCS

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës Italiane - Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin për Zhvillim

Piazzale della Farnesina, 1 Rome, Italy (Romë, Itali)

dgcs5@esteri.it

Për Ambasadën e Italisë në Tiranë

Rruga Papa Gjon Pali II, nr.2

Tiranë, Shqipëri

segramb.tirana@esteri.it

Për "AICS Tirana"

Agjencia Italiane për Bashkëpunimin për Zhvillim

Rruga Abdi Toptani, Torre Drini, kati 5

Tiranë, Shqipëri

segreteria.aics@esteri.it

Për MSHMS-në

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Rruga e Kavajës 25

Tiranë, Shqipëri

info@shendetesia.gov.al

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar sipas rregullave nga Qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në _____, më _____, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze, ku të dyja tekstet janë njëlloj autentike.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË ITALISË
_____	_____

Shtojcat

Shtojca I: Dokumenti i Projektit

Shtojca II: Klauzolat Etike dhe Parimet e Përgjithshme për prokurimin dhe ekzekutimin e kontratave

Shtojca III: Rregullat e përgjithshme të zbatueshme për procedurat e prokurimit

DOKUMENTI I PROJEKTIT

PËRPARIMI I SHËNDETIT NEONATAL DHE I NËNËS NË SHQIPËRI

24 SHKURT, 2025

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje E PROJEKTIT

ORIGJINA DHE KONTEKSTI

Analiza e Kontekstit

Koordinimi me Nisma të Tjera Publike dhe Ndërkombëtare

ANALIZA E NEVOJAVE, PROBLEMET DHE IDENTIFIKIMI I PËRFITUESVE

Boshllëqet Kritike në Kujdesin Neonatal dhe Reagimin Emergjent

Përfituesit

STRATEGJIA E NDËRHYRJES

Nga ndikimi tek veprimi

Si PRISMA (trajnimi dhe SOP-të) do të plotësojë ANMA (punimet civile dhe pajisjet mjekësore)

Qasja e Zbatimit dhe Sinergjitë

ENTI EKZEKUTUES DHE PARTNERITETI GJITHËPËRFSHIRËS

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Shëndetësore

METODAT E PËRFSHIRJES SË PARTNERËVE DHE GRUPEVE TË INTERESIT

ASST Fatebenefratelli Sacco – Partneri teknik

Spitalet Koço Gliozheni, Mbretëresha Geraldina dhe Spitalet Rajonale Dibër e Fier – Grupet Përfitues të Interesit

PARTNERITETI ME ASST FATEBENEFRATELLI SACCO

Përvoja e ASST Fatebenefratelli Sacco në Shqipëri dhe Kontributet Specifike

1. Vlerësimi Teknik dhe Shkëmbimi i Ekspertizës

2. Bashkëpunimi Dypalësh dhe Mbështetja Klinike e vazhdueshme

3. Kontributet në projektimin e NICU-së dhe Prokurimin e Pajisjeve

KUADRI LOGJIK/ZINXHIRI I REZULTATEVE

AKTIVITETET

AKTIVITETI 1 – FAZA FILLESTARE

Produkti – 1 (Objektivi i Ndërmjetëm I): NICU dhe pavijoni i maternitetit i përmirësuar tek Koço Gliozheni sipas praktikave më të mira të OBSH-së dhe Italisë.

AKTIVITETI 2 – RINOVIMI DHE ZGJERIMI I NICU-së TE KOÇO GLIOZHENI

2.1 Prokurimi dhe Përzgjedhja e Ekspertëve për Projektimin e Njësisë së Kujdesit Intensiv Neonatal (NICU) dhe Punimet Civile

2.2 Vlerësime Teknike të Vendndodhjes dhe Analiza e Nevojave

2.3 Ndihma teknike për planifikimin dhe projektimin e infrastrukturës së NICU-së, mbikëqyrjen dhe verifikimin e punimeve civile

2.4 Ekzekutimi i Punimeve Civile

2.5 Testimi dhe Certifikimi Përfundimtar

Produkti - 2 (Objektivi i ndërmjetëm 2): Blerja e pajisjeve moderne të kujdesit neonatal dhe maternal për spitalet Koço Gliozheni, Mbretëresha Geraldina, Dibër dhe Fier.

AKTIVITETI 3 – FURNIZIMI, SHPËRNDARJA DHE INSTALIMI I PAJISJEVE MJEKËSORE

3.1 Përgatitja e Specifikimeve Teknike dhe Procesi i Tenderimit

3.2 Prokurimi, Dorëzimi dhe Garantimi i Cilësisë

3.3 Instalimi i Pajisjeve dhe Testimi Operacional

3.4 Shpërndarja e pajisjeve funksionale nga Koço Gliozheni dhe Mbretëresha Geraldina në Spitalet Rajonale

3.5 Testimi dhe Certifikimi Përfundimtar

1. KRONOGRAMA
RREZIQET DHE MASAT ZBUTËSE
QËNDRUESHMËRIA
Qëndrueshmëria Institucionale dhe Integrimi i Politikave
Replikueshmëria e Projektit
Menaxhimi i Njohurive dhe Shpërndarja e Rezultateve
PLANI FINANCIAR
METODAT E MENAXHIMIT DHE EKZEKUTIMIT
Qeverisja Organizative dhe Struktura e Menaxhimit
Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU) – Koordinimi Operacional
Grupi Teknik i Punës (TWG) – Mbikëqyrja e Infrastrukturës dhe Prokurimit
Komiteti Shkencor (SciCom) – Standardizimi Klinik dhe Zhvillimi i Kapaciteteve
Garantimi i Përputhshmërisë me Standardet e BE-së dhe Procesin e Anëtarësimit të Shqipërisë në BE
Komiteti Drejtues (SC) – Koordinimi dhe MVendimmarrja në Nivel të Lartë
Faza Fillestare – Veprimet Përgatitore dhe Planifikimi Operacional
Prokurimi, Mbikëqyrja Financiare dhe Transparenca
Monitorimi, Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rreziqeve
Strategjitë e Zbutjes së Rrezikut
MONITORIMI DHE VLERËSIMI
Rëndësia dhe Matshmëria e Treguesve
Aktivitetet e Monitorimit
Aktivitetet e Vlerësimit
Metodologjitë e M&V
Menaxhimi i Riskut nëpërmjet Monitorimit dhe Vlerësimit
STRATEGJIA E KOMUNIKIMIT INSTITUCIONAL
Vizibiliteti i Kontributit të Italisë
Angazhimi i Medias dhe Publikut
Mediat Sociale dhe Komunikimi Digjital
Pajtueshmëria me Udhëzimet e Komunikimit të AICS-së
SHKURTIMET

PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT

Titulli	**Përparimi i Shëndetit Neonatal dhe i Nënës në Shqipëri – ANMA**
Kostoja e projektit	| 4,000.000€
Kohëzgjatja	36 muaj Data e pritshme e fillimit: 1.6.2025 Data e pritshme e përfundimit: 31.5.2028
Shteti	Shqipëri
Zona e ndërhyrjes	Tiranë, Dibër, Fier
SEKTORI OECD-DAC	Shërbimet e Infrastrukturës Sociale (120/121/122/130)
OZHQ-të (Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm):	OZHQ 3: Shëndeti i mirë dhe mirëqenia OZHQ 5: Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave OZHQ 17: Forcimi i mjeteve të zbatimit dhe rilindja e Partneritetit Global për Zhvillim të Qëndrueshëm
Përshkrim i shkurtër	ANMA (Përparimi i Shëndetit Neonatal dhe i Nënës në Shqipëri), i udhëhequr nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, fokusohet në përmirësimin e infrastrukturës dhe në blerjen e pajisjeve mjekësore. Ai përfshin rehabilitimin e Njësisë së Kujdesit Intensiv Neonatal (NICU) në Spitalin Koço Gliozheni në Tiranë dhe rinovimin e NICU-ve në spitalet Koço Gliozheni, Mbretëresha Geraldina, Fier dhe Dibër. Këto përmirësime synojnë të rrisin cilësinë e shërbimeve, të ulin vdekshmërinë neonatale dhe të nënës, dhe të minimizojnë transferimet emergjente drejt Tiranës. Brenda programit më të gjerë MATHERNA (Përparimi i Shëndetit Neonatal dhe i Nënës në Shqipëri), ANMA është plotësues me projektin PRISMA (*Potenziamento e Rafforzamento delle Infrastrutture e dei Servizi Materno-infantile in Albania*), i udhëhequr nga ASST FBFS. PRISMA plotëson ANMA-n duke trajnuar personelin shëndetësor, forcuar sistemet e referimit dhe përcaktuar standardet e pajisjeve mjekësore. PRISMA gjithashtu kontribuon në zhvillimin e masterplanit për NICU-në e Koço Gliozhenit, duke garantuar që investimet në infrastrukturë të jenë në përputhje me një vizion afatgjatë dhe të qëndrueshëm. Së bashku, këto projekte krijojnë një kuadër të koordinuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Shëndetit 2021-2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (ODSH-të 3, 5, 17). Programi

	modernizon objektet spitalore, përmirëson trajnimin e stafit mjekësor dhe forcon sistemet e referimit, duke adresuar boshllëqet kritike në kujdesin neonatal dhe të nënës. Si një iniciativë pilot, Programi forcon spitalet kryesore për të reduktuar transferimet emergjente dhe përmirësuar qasjen lokale në kujdesin neonatal dhe të nënës. Katër spitale u përzgjodhën bazuar në normat e lindjeve, vendndodhjen strategjike dhe iniciativat në vazhdim, duke garantuar mundësinë e zgjerimit për një nivel kombëtar në të ardhmen. Duke zbatuar një qasje të strukturuar dhe të bazuar në prova, projekti do të udhëheqë ndërhyrjet e ardhshme në shkallë kombëtare, duke mundësuar që qeveria shqiptare të riprodhojë dhe të zgjasë modelet e suksesshme. Ky Dokument Projekti fokusohet në komponentin ANMA, ndërsa PRISMA detajohet në një dokument të veçantë.

ORIGJINA DHE KONTEKSTI

Analiza e kontekstit

Në fillim të vitit 2024, MSHMS-ja kërkoi zyrtarisht mbështetje nga Ministria Italiane e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (MAECI) për të forcuar sistemin kombëtar të kujdesit neonatal. Pas kësaj kërkese dhe për t'u pajtuar me Strategjinë Kombëtare Shqiptare dhe me *Aquis Communautaire,* në korrik 2024 u krye një vlerësim, i cili përfshiu një ekip të përbashkët ekspertësh shqiptarë dhe italianë nga ASST FBF Sacco, siç u rekomandua nga Italia, duke përfshirë neonatologë, inxhinierë klinikë, arkitektë dhe specialistë të sistemit shëndetësor. Ata vlerësuan 17 spitale në të gjithë vendin dhe organizimin e përgjithshëm të sistemit.

Gjetjet e këtij vlerësimi[1] (shtojca 1 e këtij propozimi) konfirmuan se kapacitetet e kufizuara të kujdesit intensiv neonatal, pajisjet e vjetruara, protokollet jo të qëndrueshme të menaxhimit dhe sistemi i referimit i pazhvilluar kontribuojnë në vdekshmërinë e parandalueshme të të porsalindurve, veçanërisht tek të porsalindurit para kohe dhe të sëmurët kritikë. Këto boshllëqe janë veçanërisht të rënda në spitalet rajonale dhe komunale, ku të porsalindurit e brishtë shpesh nuk kanë qasje në mbështetje të mjaftueshme respiratore, ushqyerje neonatale dhe shërbime emergjente transporti.

Të porsalindurit para kohe nën 27 javë shtatzëni kanë shanse jashtëzakonisht të ulëta mbijetese jashtë Tiranës për shkak të mungesës së ventilimit joinvaziv (nCPAP, oksigjen nazal me rrjedhje të lartë), ushqyerjes parenterale dhe protokolleve të standardizuara të reanimacionit neonatal. Edhe për të porsalindurit para kohe me peshë dhe gjendje më të moderuar, qasja në pajisjet themelore mjekësore si mikserët e ajrit, inkubatorët dhe pajisjet e monitorimit neonatal, mbetet jashtëzakonisht e paqëndrueshme.

Sistemi i referimit midis spitaleve rajonale dhe atyre terciarë u identifikua gjithashtu si një dobësi kritike. Disponueshmëria e shtretërve në NICU në Tiranë është e kufizuar, dhe transporti i të porsalindurve kritikë pengohet ndjeshëm nga mungesa e ambulancave neonatale të pajisura siç duhet, duke çuar në vonesa në transferime dhe rritje të rreziqeve shëndetësore për të porsalindurit që kanë nevojë për kujdes intensiv dhe për nënat e tyre.

Për më tepër, megjithëse disa trajnime për reanimacionin e të porsalindurve janë ofruar nga neonatologët në Spitalin Mbretëresha Geraldina, këto trajnime mbeten të pamjaftueshme, jo të standardizuara dhe nuk shtrihen tek i gjithë stafi neonatal, veçanërisht infermierët dhe mamitë. Për më tepër, shqetësimi respirator neonatal ka rritur për shkak të një përqindjeje në rritje të lindjeve me prerje cezariane, ndërsa shumica e spitaleve periferike nuk kanë kapacitete për ventilim joinvaziv, duke vështirësuar më tej kapacitetet e NICU-së në Tiranë.

Pas këtyre gjetjeve, u krijua zyrtarisht një grup teknik pune për të përcaktuar prioritetet e ndërhyrjes dhe për të formuluar një përgjigje të strukturuar. Vlerësimi identifikoi spitalet Koço Gliozheni dhe Mbretëresha Geraldina në Tiranë, së bashku me

[1] Vlerësimi i kryer në Shqipëri në korrik 2024 ishte i shpejtë, i fokusuar në dhënien e një përmbledhjeje të përgjithshme të sistemit të kujdesit neonatal dhe të nënës në të gjithë vendin. Për shkak të shtrirjes gjeografike të gjerë dhe gamës së gjerë të institucioneve të përfshira, misioni nuk përfshinte një analizë të detajuar të çdo pajisjeje mjekësore të pranishme në të gjitha institucionet shëndetësore. Vlerësimi shërbeu kryesisht për të identifikuar boshllëqet kritike strukturore dhe të lidhura me pajisjet dhe për të prioritizuar spitalet kyçe për ndërhyrje. Vetëm pas identifikimit të katër spitaleve të synuara Koço Gliozheni, Mbretëresha Geraldina, Dibër dhe Pogradec, MSHMS-ja kreu një vlerësim më të fokusuar të pajisjeve dhe infrastrukturës ekzistuese. Kjo mundësoi një kuptim më të detajuar të mospërputhjeve me standardet e OBSH-së dhe të shkallës reale të përmirësimeve të nevojshme.

Spitalet Rajonale Dibër dhe Fier, si vendet prioritare për ndërhyrje.

Kriteret e përzgjedhjes bazoheshin në:

- Normat vjetore të lindjeve, duke siguruar ndikim tek një numër i konsiderueshëm i të porsalindurve.
- Kapacitetet ekzistuese të kujdesit neonatal, duke u fokusuar tek spitalet me infrastrukturë bazë që mund të përmirësohen në mënyrë efektive.
- Modelet e referimit, duke adresuar spitalet kryesore që shërbejnë si qendra rajonale të kujdesit neonatal.
- Gatishmëria e stafit për iniciativat e ndërtimit të kapaciteteve, duke siguruar që përmirësimet të jenë të qëndrueshme.

Spitalet Rajonale Dibër dhe Fier u përzgjodhën për shkak të volumit të konsiderueshëm të lindjeve dhe rëndësisë gjeografike, duke shërbyer si qendra kryesore të kujdesit neonatal për zonat rurale përreth. Spitali Rajonal Pogradec vepron si qendër e rëndësishme referimi për Shqipërinë jugore, ndërsa Spitali Rajonal Dibër luan rol vendimtar në rajonin verior-lindor, ku qasja në kujdesin neonatal terciar në Tiranë është e ndaluar ndjeshëm nga distanca dhe kufizimet e transportit.

Për më tepër, procesi i përzgjedhjes gjithashtu mori në konsideratë veprimet ndërkombëtare të vazhdueshme dhe të kaluara për të shmangur përsëritjen dhe për të siguruar sinergji me programet ekzistuese. Në veçanti, u mor parasysh projekti i financuar nga Gjermania në Shkodër, duke siguruar që investimet të plotësojnë, dhe jo të riprodhojnë përpjekjet tashmë në zhvillim.

Gjetjet e vlerësimit krijuan bazën konceptuale për dizajnin e këtij projekti, duke formësuar prioritetet e tij dhe duke garantuar që ndërhyrjet të adresojnë nevojat më urgjente brenda sistemit të kujdesit neonatal dhe i nënës në Shqipëri.

Ky projekt është plotësisht në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Shëndetit 2021-2030 të Shqipërisë, e cila prioritizon shëndetin neonatal dhe të nënës si çështje kombëtare, duke theksuar investimet në infrastrukturën spitalore, zhvillimin e stafit dhe përmirësimet në ofrimin e shërbimeve. Për më tepër, ai kontribuon drejtpërdrejt në zbatimin e Planit të Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues (UNFPA 2017), i cili synon të ulë normat e vdekshmërisë dhe morbiditetit neonatal përmes protokolleve klinike të standardizuara, përmirësimit të njësive intensive neonatale (NICU) dhe forcimit të sistemeve të referimit.

Duke financuar ristrukturimin e NICU-së së Koço Gliozhenit dhe duke pajisur katër spitale me teknologji moderne neonatale, projekti ofron një model për ndërhyrjet e ardhshme në shkallë kombëtare. NICU-ja e re në Koço Gliozheni do të projektohet, pajiset me personel dhe pajiset për t'iu përmbajtur standardeve të OBSH-së, duke krijuar një njësi të specializuar për menaxhimin e të porsalindurve kritikë dhe të nënave të tyre. Kjo jo vetëm që do të përmirësojë shanset e mbijetesës për të porsalindurit para kohe dhe në rrezik, por gjithashtu do të reduktojë ngarkesën mbi NICU-të ekzistuese, duke lejuar një shpërndarje më efikase të burimeve të kujdesit neonatal dhe të nënës në të gjithë Shqipërinë.

Për të forcuar më tej kapacitetin e spitaleve terciarë në Shqipëri, projekti do të shtrihet edhe tek Spitali Mbretëresha Geraldina, pas modernizimit dhe ristrukturimit të tij të financuar nga MSHMS-ja. Spitali do të marrë të njëjtën pajisje mjekësore të avancuar të blerë për NICU-në e Koço Gliozhenit, duke siguruar dy NICU-të më moderne në Tiranë, të afta që të shërbejnë për të gjithë vendin.

Projekti mbështet drejtpërdrejt Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ 3 – Shëndeti i Mirë dhe Mirëqenia, OZHQ 5 – Barazia Gjinore, OZHQ 17 – Partneritete për Zhvillim të Qëndrueshëm). Duke siguruar që gratë të kenë qasje në kujdesin neonatal dhe të nënës me cilësi të lartë, ai forcon barazinë gjinore (OZHQ 5) dhe kontribuon në uljen e vdekjeve të parandalueshme te të porsalindurit. Për më tepër, duke aplikuar pajisje neonatale me eficiencë energjetike dhe duke përmirësuar infrastrukturën spitalore, projekti mbështet OZHQ 7 – Energjia e Përballueshme dhe e Pastër, duke rritur qëndrueshmërinë dhe reziliencën e spitaleve. Përmes strukturës së tij bashkëpunuese, projekti forcon OZHQ 17 duke promovuar partneritete ndërkombëtare, duke u mundësuar institucioneve shëndetësore shqiptare dhe italiane të shkëmbejnë ekspertizë dhe praktika më të mira në kujdesin neonatal.

Koordinimi me Iniciativa të Tjera Publike dhe Ndërkombëtare

Kjo ndërhyrje është projektuar për të plotësuar dhe integruar me iniciativat ekzistuese të shëndetit neonatal dhe të nënës, duke siguruar një strategji kombëtare të koordinuar dhe jo një qasje të

fragmentuar. Projekti është në përputhje me trajnimin aktual për reanimacionin neonatal të udhëhequr nga UNFPA, i cili fokusohet në ndërtimin e kapaciteteve për punonjësit shëndetësorë në vijën e parë, si dhe me iniciativën e mbështetur nga Gjermania në Shkodër, e cila ka forcuar shërbimet e kujdesit maternal në veri të Shqipërisë. Duke u bazuar në këto përpjekje, projekti shmang përsëritjen, shfrytëzon ekspertizën ekzistuese dhe rrit reziliencën e përgjithshme të sistemit shëndetësor.

ASST FBF Sacco i Milanos ka luajtur rol vendimtar në dizajnimin e projektit, duke ofruar udhëzime teknike, kurrikula trajnimi dhe ekspertizë arkitekturore. Me përvojë të gjerë në kujdesin intensiv neonatal në Spitalin e Fëmijëve Vittore Buzzi në Milano, ASST FBF Sacco ka qenë vendimtar në sugjerimin e dizajneve paraprake për NICU-në e re në Koço Gliozheni, zhvillimin e profesionistëve shqiptarë në hartimin e një liste paraprake të pajisjeve të nevojshme (e cila mund të modifikohet pas fazës fillestare) dhe strukturimin e programit Trajnimi i Trajnerëve (ToT) (shihni Shtojcën 2- Planet Paraprake për NICU-në e Gliozhenit, Shtojca 3 Plani Paraprak i Prokurimit). Kjo garanton që praktikantët shqiptarë të marrin mësim praktik mbi teknikat moderne të kujdesit neonatal, duke garantuar qëndrueshmëri afatgjatë.

Projekti do të përdorë një qasje me metoda të përziera, duke kombinuar mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore për një kuptim gjithëpërfshirës të ndikimit.

Metoda sasiore

- Të dhënat e spitalit dhe treguesit e shëndetit: Ndjekja e shkallës së vdekshmërisë neonatale, efikasitetit të referimit dhe përdorimit të pajisjeve përmes regjistrimit sistematik të të dhënave.

- Monitorimi i infrastrukturës dhe pajisjeve: Rishikimi i të dhënave të prokurimit, faturave të dorëzimit dhe raporteve të instalimit për të garantuar pajtueshmërinë me objektivat e planifikuar.

- Ndjekja financiare: Raportet mujore mbi shpenzimet, statusin e prokurimit dhe ndarjet e buxhetit, duke siguruar llogaridhënien financiare.

Metoda cilësore

- Konsultimet me palët e interesuara: Intervista dhe grupe fokusi me profesionistë të kujdesit shëndetësor, administratorë të spitalit dhe pacientë për të mbledhur reagime mbi efektivitetin e projektit.

- Vizita në terren dhe vëzhgime të drejtpërdrejta: Inspektime në vend për të vlerësuar funksionalitetin e NICU-së dhe efektivitetin operativ të pajisjeve të reja mjekësore.

- Anketa të pacientëve dhe familjeve: Mbledhja e reagimeve mbi aksesin dhe cilësinë e shërbimit përmes anketave të nivelit të përmbushjes së kërkesave.

Menaxhimi i Riskut nëpërmjet Monitorimit dhe Vlerësimit

Kuadri MAE do të funksionojë gjithashtu si mjet për zbutjen e rrezikut, duke garantuar që sfidat të identifikohen dhe adresohen në mënyrë proaktive.

Mësimi adaptiv do të lejojë përshtatje në kohë reale në zbatimin e projektit.

- ASST Fatebenefratelli do të mbikëqyrë proceset e prokurimit, duke ofruar mbështetje teknike për të siguruar materiale cilësore.

- Vizitat rutinë në vend nga inxhinierët dhe neonatologët e ASST-së do të sigurojnë që punimet civile dhe instalimet e pajisjeve të NICU-së të përmbushin standardet ndërkombëtare.

- Qëndrueshmëria afatgjatë e pajisjeve mjekësore do të mbrohet përmes ndarjeve të detyrueshme të buxhetit të spitalit për mirëmbajtje dhe kontrata shërbimi të mbështetura nga furnizuesit.

STRATEGJIA E KOMUNIKIMIT INSTITUCIONAL

Strategjia e komunikimit për këtë Program do të garantojë transparencë, vizibilitet dhe angazhim publik, në përputhje me Udhëzimet e Komunikimit të AICS-së. Projekti do të miratojë një qasje shumëkanalëshe, duke shfrytëzuar vizibilitetin institucional, shtrirjen mediatike dhe angazhimin digjital për të theksuar ndikimin e ndërhyrjes dhe partneritetin strategjik midis Italisë dhe Shqipërisë në forcimin e kujdesit shëndetësor neonatal dhe të nënës.

Vizibiliteti i Kontributit të Italisë

Për të garantuar njohjen e plotë të rolit të Italisë, të gjitha materialet e komunikimit do të përmbajnë në mënyrë të dukshme logon dhe markën e AICS-së, duke siguruar përputhshmëri me rregulloret e vizibilitetit. Kjo përfshin:

- Markimi Institucional: Raportet zyrtare, prezantimet, dokumentet publike dhe materialet e trajnimit do të përmbajnë logon e AICS dhe referencë për bashkëpunimin italian, sipas rregullave të vizbilitetit të AICS-së.

- Sinjalistika dhe Etiketimi i Pajisjeve: Përmirësimet infrastrukturore në Spitalin "Koço Gliozheni" dhe spitalet rajonale do të përfshijnë pllaka të dedikuara që njohin kontributin italian. Pajisjet mjekësore të blera në kuadër të Programit do të etiketohen me markën e AICS-së, kur të jetë e mundur.

- Njoftimet dhe Eventet Zyrtare: Përfaqësues të AICS-së do të ftohen në evente publike, duke përfshirë aktivitetet e nisjes së projektit, inaugurimet infrastrukturore dhe takimet shkencore të punës, duke siguruar njohje në nivel të lartë të angazhimit italian.

- Evente të organizuara nga MSHMS-ja: MSHMS-ja do të organizojë një event të nisjes së projektit (pas fazës së nisjes) dhe një konferencë përfundimtare, ku do të prezantohen rezultatet e projektit.

Angazhimi i medias dhe publikut

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) do të luajë rol qendror në integrimin dhe promovimin e rezultateve të projektit nëpërmjet komunikatave për shtyp dhe shpërndarjes në media. Duke shfrytëzuar prezencën e saj institucionale, MSHMS-ja do të sigurojë përditësime publike të shpeshta, duke forcuar rëndësinë e projektit brenda strategjisë kombëtare të shëndetësisë.

- Komunikata për Shtyp dhe Shpërndarje në Media Kombëtare: MSHMS-ja do të nxjerrë komunikata të rregullta për mediat shqiptare dhe ndërkombëtare, duke raportuar mbi progresin e projektit, theksuar arritjet kryesore dhe siguruar vizibilitet të lartë të rezultateve.

- Video Institucionale dhe Dëshmi: Filma të shkurtër, histori pacientësh dhe dëshmi nga stafi mjekësor do të ilustrojnë ndikimin e ndërhyrjes, duke forcuar rolin e Italisë si partner strategjik në zhvillimin e kujdesit shëndetësor në Shqipëri.

- Publikime Shkencore dhe Konferenca: Projekti do të kontribuojë në dialogun akademik dhe politik, me MSHMS-në dhe ASST Fatebenefratelli duke qenë bashkautorë në artikuj të rishikuar nga kolegët dhe duke prezantuar gjetjet në konferenca ndërkombëtare mbi kujdesin neonatal.

Mediat Sociale dhe Komunikimi Digjital

Projekti do të shfrytëzojë mjetet digjitale për të maksimizuar shtrirjen, duke përdorur një strategji të koordinuar të mediave sociale që angazhon institucionet, profesionistët mjekësorë dhe publikun e gjerë.

- Fushatat e mediave sociale duke përdorur hashtage të miratuara nga AICS-ja. Infografika dhe përmbajtje multimediale: Imazhet para dhe pas përmirësimeve të NICU-së, videot e instalimeve të pajisjeve dhe intervistat me profesionistët e kujdesit shëndetësor do të ndahen për të ilustruar progresin e prekshëm.

- Bashkëpunimet e influencerave dhe ekspertëve: Angazhimi me profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe avokatët e shëndetit të nënës do të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe besimit në shërbimet e përmirësuara të kujdesit neonatal.

Pajtueshmëria me udhëzimet e komunikimit të AICS-ja

Të gjitha materialet e komunikimit do të respektojnë rigorozisht udhëzimet për markën dhe mesazhet e AICS-së, duke garantuar një përfaqësim të qëndrueshëm dhe profesional të kontributit italian. MSHMS-ja dhe ASST Fatebenefratelli Sacco do të koordinohen ngushtë me ekipet e komunikimit të AICS-së për rishikimin dhe miratimin e materialeve para publikimit.

Kjo qasje e strukturuar do të rrisë transparencën, do të maksimizojë angazhimin publik dhe do të forcojë qëndrueshmërinë e ndërhyrjes, duke pozicionuar Italinë dhe Shqipërinë si partnerë afatgjatë në forcimin e kujdesit matern dhe neonatal.

SHTOJCA

Shtojca 1: Raporti i vlerësimit – Kujdesi neonatal në Shqipëri, korrik 2024

Shtojca 2: Planet paraprake për NICU-n e Gliozhenit

Shtojca 3: Plani paraprak i prokurimit

SHKURTIME

AICS	Agjencia Italiane për Bashkëpunimin për Zhvillim (Agenzia Italiana per la Cooperazione allo Sviluppo)
ANMA	Përparimi i Shëndetit Neonatal dhe i Nënës në Shqipëri
ASST FBF	Azienda Socio Sanitaria Territoriale Fatebenefratelli Sacco
BE	Bashkimi Evropian
HVAC	Ngrohje, Ventilim dhe Ajër i Kondicionuar
IPA CARE	Projekt i Bashkëpunimit për Mbrojtjen Civile i financuar nga BE-ja për Ndihmën e Parapërgatitjes për Anëtarësim
KPI	Tregues Kyç i Performancës
MAECI	Ministria Italiane e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar (*Ministero degli Affari Esteri e della Cooperazione Internazionale)*
MATHERNA	Përparimi i Shëndetit Neonatal dhe i Nënës në Shqipëri
M&E	Monitorim dhe Vlerësim
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Shqipëri)
NICU	Njësi Intensive Neonatale
nCPAP	Presion Pozitiv i Vazhdueshëm në Rrugët e Frymëmarrjes Nazale
OECD-DAC	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik Komiteti i Ndihmës për Zhvillim
PAR	Rregulloret e Prokurimit dhe Blerjeve
PMU	Njësi e Menaxhimit të Projektit
PRAG	Udhëzues Praktik mbi Procedurat e Kontratave për Veprimet e Jashtme të BE-së
PRISMA	Forcimi dhe Përmirësimi i Infrastrukturës dhe Shërbimeve Materno-Infantile në Shqipëri
SciCom	Komiteti Shkencor
SC	Komiteti Drejtues
SDG	Objektiv për Zhvillim të Qëndrueshëm
SOP	Procedurë Standarde Operacionale
TA	Asistencë Teknike
ToT	Trajnimi i Trajnerëve
TWG	Grupi Teknik i Punës
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

Vendi dhe data:
Nënshkrimi:

SHTOJCA 2

KLAUZOLAT ETIKE DHE PARIMET E PËRGJITHSHME PËR PROKURIMIN DHE EKZEKUTIMIN E KONTRATAVE

Kjo Shtojcë përmban klauzolat etike dhe parimet themelore mbi prokurimin, hartimin dhe ekzekutimin e kontratave të prokurimit të punimeve, furnizimeve dhe shërbimeve të parashikuara në Marrëveshjen Ndërqeveritare. Të gjitha çështjet që nuk përmenden shprehimisht në këtë Shtojcë, do të rregullohen nga ligji në fuqi i përcaktuar nga Marrëveshja.

1. KËRKESAT E KONTRAKTORIT

1.1 Përveç nëse përcaktohet ndryshe në Marrëveshje, procedurat e prokurimit janë të hapura për operatorët ekonomikë të BE-së, operatorët që hyjnë në kushtet e përcaktuara nga neni 25 i Direktivës BE/2014/24 dhe operatorët që plotësojnë kërkesat dhe kualifikimet për kontrata sipas ligjit të tyre kombëtar.

1.2 Autoriteti Kontraktor mund t'u kërkojë të gjithë ofertuesve të përmbushin një ose më shumë kërkesa për të marrë pjesë në prokurimin publik, me kusht që këto kërkesa të jenë relevante dhe proporcionale për të kryer kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

1.2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Autoriteti Kontraktor mund të vendosë kushte për pjesëmarrje për të garantuar që operatorët ekonomikë kanë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën. Për këtë qëllim, Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro minimale vjetore. Autoriteti Kontraktor nuk mund të kërkojë një xhiro minimale vjetore që tejkalon dyfishin e shumës së parashikuar të kontratës, përveç rasteve të justifikuara siç duhet nga rreziqet e veçanta që lidhen me natyrën e punimeve, shërbimeve ose furnizimeve. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet në lidhje me secilin lot individual. Megjithatë, autoriteti kontraktor mund të përcaktojë xhiron minimale vjetore që operatorët ekonomikë duhet të kenë, duke iu referuar grupeve të loteve në rast se ofertuesit të suksesshëm i jepen disa lote për t'u ekzekutuar në të njëjtën kohë.

1.2.2 Kapaciteti profesional dhe teknik: Autoritetet kontraktuese mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë të zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore dhe teknike dhe përvojën për të përmbushur kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë, në veçanti, që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje të provuar nga referenca të përshtatshme nga kontratat e kryera në të kaluarën, duke përfshirë edhe në interes të palëve private. Në procedurat e prokurimit për furnizime që kërkojnë punë, shërbime ose punime vendosjeje ose instalimi, aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin ose ekzekutuar instalimin ose punën, mund të vlerësohet në lidhje me aftësitë, efikasitetin, përvojën dhe besueshmërinë e tyre.

1.2.3 Kualifikimet për aktivitete profesionale: Lidhur me përshtatshmërinë për të ushtruar aktivitetin profesional, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të jenë të regjistruar në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë që mbahen në shtetin e tyre të themelimit.

1.3 Dokumentet e tenderit duhet të specifikojnë kushtet e kërkuara të pjesëmarrjes, të cilat mund të shprehen si nivele minimale të aftësisë, së bashku me mjetet e duhura të provës.

1.4 Kur një operator ekonomik bazohet në kapacitetet e subjekteve të tjera në lidhje me kriteret që lidhen me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe këto subjekte të jenë bashkërisht përgjegjës për ekzekutimin e kontratës.

1.5 Në rastin e kontratave të punimeve, kontratave të shërbimit dhe operacioneve të vendosjes ose instalimit në kontekstin e një kontrate furnizimi, autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që detyra të caktuara kritike të kryhen drejtpërdrejt nga vetë ofertuesi ose, kur oferta paraqitet nga një grup operatorësh ekonomikë, nga një pjesëmarrës në atë grup.

1.6 Operatorët ekonomikë që hyjnë në një ose më shumë nga kushtet e mëposhtme, përjashtohen nga pjesëmarrja në prokurimin publik dhe nuk mund t'u jepet një kontratë:

1.6.1 kanë qenë objekt i një dënimi me vendim të formës së prerë për njërën nga arsyet e mëposhtme, siç përcaktohet nga neni 57 i Direktivës BE/2014/24: pjesëmarrja në një organizatë kriminale, korrupsioni, mashtrimi, veprat penale terroriste ose veprat penale të lidhura me aktivitete terroriste, pastrimi i parave ose financimi i terrorizmit, puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore;

1.6.2 kanë qenë objekt i një dënimi me vendim të formës së prerë për çdo krim tjetër që ka si pasojë pamundësinë për të lidhur kontrata me autoritetet publike, qoftë në vendin ku janë vendosur ose në njërën nga vendet Palë të Marrëveshjes;

1.6.3 janë në shkelje të rëndë të detyrimeve të tyre në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore pasi kanë qenë objekt i një dënimi me vendim të formës së prerë ose një vendimi administrativ të formës së prerë, të detyrueshëm në Shtetin e Donatorit ose të autoritetit kontraktues në vendin ku janë vendosur;

1.6.4 janë në shkelje të rënda, të provuara me çdo mjet të përshtatshëm të detyrimeve të tyre ligjore mbi shëndetin dhe sigurimet shoqërore, mjedisin, mirëqenien dhe punën, në Shtetin e Donatorit ose të autoritetit kontraktues në vendin ku janë vendosur;

1.6.5 ose janë objekt i një procedure për deklarim, ose ndodhen në njërin nga kushtet e mëposhtme: kanë falimentuar ose janë duke u likuiduar, kanë paaftësi paguese ose punët e tyre administrohen nga likuiduesi ose nga gjykatat, ose kanë lidhur një marrëveshje me kreditorët, me ose pa pezullimin e aktiviteteve të tyre të biznesit, ose ndodhen në një situatë të ngjashme;

1.6.6 autoriteti kontraktues mund të provojë me mjete të përshtatshme se operatori ekonomik është fajtor për sjellje të rëndë profesionale, çka e vë në dyshim integritetin e tij;

1.6.7 ata ose anëtarët e grupit të cilit i përkasin, partnerët e tyre në sipërmarrje të përbashkëta ose grupe ose nënkontraktorët e tyre, janë në konflikt interesi të lidhur me përfshirjen e tyre të mëparshme në procedurën e prokurimit, duke i ofruar konsulencë autoritetit kontraktues ose duke qenë të përfshirë në fazat paraprake të procedurës së prokurimit;

1.6.8 janë shpallur fajtorë për keqinterpretim serioz në dhënien e informacionit të kërkuar për verifikimin e mungesës së arsyeve për përjashtim ose përmbushjen e kritereve të përzgjedhjes, ia kanë mbajtur të fshehtë informacionin e tillë njërës prej Palëve të Marrëveshjes ose janë regjistruar në regjistrin e mbajtur nga Observatori i Autoritetit Italian Antikorrupsion për paraqitjen e dokumenteve të rreme ose informacionit të rremë, me qëllim marrjen e kualifikimit për aktivitetin e tyre profesional;

1.6.9 janë dënuar me vendim gjyqësor për terrorizëm ose pjesëmarrje në një organizatë kriminale, që ka si pasojë humbjen, pezullimin ose ndalimin e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik

1.6.10 u është ndaluar dhënia e një kontrate prokurimi publik me anë të një vendimi administrativ përfundimtar detyrues (si pasojë e një vendimi përfundimtar për një krim), në Shtetin e Donatorit ose të autoritetit kontraktues në vendin ku janë vendosur;

1.6.11 janë në shkelje të detyrimeve të tyre në lidhje me ndalimin e transferimit fiktiv të pronësisë tek administratorët mbi bazë fiduciare, në lidhje me kontrollin e transferimit fiktiv të pronësisë tek palët e treta, qoftë në Shtetin e Donatorit ose të autoritetit kontraktues ose në vendin ku janë vendosur;

1.6.12 ata nuk janë në përputhje me detyrimet e tyre në lidhje me të drejtat e punës së personave me aftësi të kufizuara në Shtetin e autoritetit kontraktues;

1.6.13 janë në kontroll të ndonjë ofertuesi tjetër që merr pjesë në të njëjtën procedurë prokurimi, ose ushtrojnë një ndikim vendimtar mbi ofertuesin tjetër, duke nënkuptuar se ofertat e tyre i atribuohen një strukture të vetme menaxhimi vendimmarrës;

1.6.14 kanë punësuar, si punonjës ose konsulentë, ish-punonjës të autoritetit kontraktues, kontrata e të cilëve ka skaduar për më pak se tre vjet, në rast se këta ish-punonjës, brenda tre vjetëve të fundit, kanë pasur kompetenca vendimmarrëse në emër të autoritetit kontraktues në dhënien e kontratave për veten e tyre.

1.7 Një operator ekonomik përjashtohet gjithashtu kur kushtet për përjashtim, të përcaktuara në paragrafin 1.6, lidhen me një anëtar të organit administrativ, drejtues ose mbikëqyrës të atij operatori ekonomik ose një person brenda tij me kompetenca përfaqësimi, vendimmarrjeje ose kontrolli.

2. ZGJEDHJA E KONTRAKTORËVE

2.1 Dhënia dhe ekzekutimi i punimeve, kontratave të furnizimit dhe shërbimit dhe koncesioneve duhet të garantojë cilësinë e performancës dhe duhet të jetë në pajtim me parimet e rezultatit, besimit, aksesit në treg, besimit të mirë dhe mbrojtjes së besimit, autonomisë kontraktuale, ruajtjes së ekuilibrit kontraktual, plotësimit të kushteve për përjashtim dhe pjesëmarrje. Gjatë dhënies së kontratave dhe

koncesioneve, autoritetet kontraktuese duhet gjithashtu të respektojnë parimet e efektivitetit të kostos, efikasitetit, shpejtësisë dhe drejtësisë, konkurrencës së lirë, mosdiskriminimit, transparencës, proporcionalitetit dhe publicitetit. Parimi i efektivitetit të kostos mund t'i nënshtrohet, sa herë që lejohet nga ligji në fuqi, kritereve të përmendura shprehimisht në dokumentet e tenderit, të frymëzuara nga nevojat sociale, si dhe mbrojtja e shëndetit, mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfshirë edhe në aspektin e energjisë.

2.2 Hartimi i prokurimit nuk duhet të bëhet me qëllim ngushtimin artificial të konkurrencës, me qëllim favorizimin ose disavantazhin e padrejtë të operatorëve të caktuar ekonomikë ose punëve, furnizuesve ose shërbimeve të caktuara.

2.3 Kriteret për zgjedhjen e pjesëmarrësve në procedurat e prokurimit publik, nuk duhet të diskriminojnë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

2.4 Dokumentet e tenderit duhet të specifikojnë burimet financiare të disponueshme për kontratën që do të jepet dhe shumën maksimale të ankandit. Çdo ofertë mbi këtë shumë përjashtohet automatikisht.

2.5 Procedurat e dhënies së tenderit anulohen nëse ka më pak se tre kandidatë/ofertues të përshtatshëm. Sa herë që kushtet objektive të tregut e bëjnë tejet të pamundur paraqitjen e tri ofertave të vlefshme, dokumentet e tenderit mund të lejojnë dhënien e tenderit në prani të një ose dy ofertave të vlefshme të përshtatshme.

2.6 Çdo ofertues mund të paraqesë vetëm një ofertë. Kur paraqesin ofertën e tyre, ofertuesit deklarojnë se nuk kanë konflikt interesi dhe se nuk kanë ndonjë lidhje specifike me ofertues të tjerë ose me palë të tjera të përfshira në procedurën e prokurimit.

2.7 Në mungesë të autorizimit të shprehur në dokumentet e tenderit, variantet e ofertës nuk autorizohen. Variantet duhet të lidhen me objektin e kontratës.

2.8 Sa herë që Marrëveshja kërkon një mos-kundërshtim për procedurat e prokurimit nga AICS-ja, autoritetet kontraktuese kërkojnë një garanci oferte që arrin në 2% të shumës maksimale të ankandit. Garancitë mund të lëshohen nga një bankë ose shoqëri sigurimesh parësore, do të hyjnë në fuqi me përmbushjen e kërkesës së autoritetit kontraktues që thjesht deklaron se kontraktori ka shkelur detyrimet e tij dhe duhet të përmbajnë një heqje dorë të shprehur nga e drejta për të zbatuar pagesën paraprake të debitorit fillestar. Garancia do të kërkohet nëse kontrata nuk është përcaktuar për shkak të fajit të kontraktorit. Autoriteti kontraktues mund ta reduktojë në mënyrë të justifikuar shumën deri në 1%, ose ta rrisë deri në 4%, në mënyrë që shuma e garancisë të jetë proporcionale dhe e përshtatshme me natyrën e shërbimeve që do të ofrohen dhe shkallën e rrezikut të përfshirë.

3 EKZEKUTIMI I KONTRATËS

3.1 Kontratat e dhëna pas një mos-kundërshtimi nga AICS-ja, do të garantohen nga një garanci performance, normalisht e barabartë me 10% të çmimit të kontratës. Garancitë mund të lëshohen nga një bankë ose shoqëri sigurimesh parësore, do të jenë në fuqi me kërkesën e parë të autoritetit kontraktues dhe duhet të përmbajnë një heqje dorë të shprehur nga e drejta për të zbatuar pagesën paraprake të debitorit fillestar. Garancitë do të jenë gjithashtu të pagueshme në rast mashtrimi ose sjelljeje të rëndë të papërshtatshme nga kontraktori. Garancitë e performancës zvogëlohen progresivisht gjatë ekzekutimit të kontratës, dhe në çdo rast deri në maksimumi 80% të shumës së garancisë. 20% e mbetur do të lirohet pas verifikimit të ekzekutimit të rregullt të kontratës.

3.2 Kontratat mund të ndryshohen gjatë afatit të tyre me miratimin paraprak të AICS-së, në përputhje me nenin 72 të Direktivës BE/2014/24. Në çdo rast, çdo rritje e çmimit nuk duhet të kalojë shumën totale të buxhetuar në Marrëveshje. Miratimi i ndryshimeve mund të refuzohet nëse ato e bëjnë të pamundur ose tejet të pamundur përfundimin e aktiviteteve të tjera të iniciativës së rregulluar nga Marrëveshja. Kontraktorët nuk do të kenë të drejtë për asnjë pagesë ose rimbursim për shpenzimet që rrjedhin nga aktivitetet e kryera pa miratimin paraprak të AICS-së. Me kërkesë të AICS-së ose autoritetit kontraktues, kontraktorëve mund t'u kërkohet të rivendosin, me shpenzimet e tyre, gjendjen fillestare para ndryshimit të paautorizuar.

3.3 Autoriteti kontraktor mund të kërkojë, nëse gjatë afatit të kontratës bëhet e nevojshme të rritet ose të ulet shuma totale e kontratës deri në 20%, përmbushjen me të njëjtat kushte të kontratës fillestare. Kontraktorët nuk lejohen ta ndërpresin kontratën.

3.4 Kontratat nuk do t'u kalohen palëve të treta. Në rast të kalimit, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

3.4 bis Transferimi i kontratës mund të lejohet, me miratim paraprak nga AICS-ja, vetëm nëse kontraktori fillestar zëvendësohet për shkak të vdekjes, ristrukturimit të korporatës, duke përfshirë marrjen në dorëzim, bashkimin, ndarjen, blerjen ose falimentimin, nga një operator tjetër ekonomik që përmbush kriteret për përzgjedhje cilësore të përcaktuara fillimisht, me kusht që kjo të mos sjellë ndryshime të tjera thelbësore në kontratë dhe të mos synojë shmangien e zbatimit të këtij Shtojce.

3.5 Kohëzgjatja e kontratës mund të zgjatet vetëm gjatë afatit të ekzekutimit të saj, nëse një opsion për zgjatjen e kohëzgjatjes përfshihet shprehimisht në kontratën origjinale dhe në dokumentet e tenderit. Në këtë rast, kontraktorët janë të detyruar të kryejnë punën me të njëjtat çmime dhe kushte të kontratës origjinale, ose më të favorshmet për autoritetin kontraktues.

3.6 Pa cenuar përmbushjen e detyrimeve në lidhje me gjurmueshmërinë e flukseve financiare, sipas paragrafit 3.10 në vijim, dorëzimi i kredive që rrjedhin nga një kontratë prokurimi, konkurrimi projektimi ose koncesioni konsiderohen në fuqi nga Qeveria e Republikës Italiane vetëm me miratim paraprak nga AICS-ja. Në çdo rast, autoriteti kontraktues rezervon të drejtën të kundërshtojë ndaj kontraktorit të gjitha përjashtimet që zbatohen për kontraktorin fillestar në përputhje me kontratën e punimeve, furnizimit, shërbimit ose projektimit të nënshkruar nga ky i fundit.

3.7 Kontraktorët të cilëve u është dhënë një kontratë projektimi, janë përgjegjës për dëmet e shkaktuara autoriteteve kontraktuese për gabime ose mosveprime në projektimin e tyre. Në rastin e kontratave të prokurimit të projektimit ose punimeve, kontraktorët janë përgjegjës për vonesat dhe shpenzimet shtesë të shkaktuara nga mangësitë në projektimin origjinal.

3.8 Dokumentet e tenderit duhet të specifikojnë kushtet për nënkontraktim. Ofertuesit duhet të deklarojnë në ofertat e tyre se cilat furnizime, shërbime ose punime synojnë të nënkontraktojnë. Ofertuesit e suksesshëm i paraqesin të gjitha nënkontraktimet autoriteteve kontraktuese para se të fillojë ekzekutimi i nënkontratës. Kontraktorët kryesorë janë plotësisht përgjegjës ndaj autoritetit kontraktues për të gjithë kontratën. Nënkontraktorët duhet të përmbushin të gjitha kërkesat sipas paragrafit 1.2 në lidhje me nënkontratën dhe nuk duhet të përfshihen në asnjë arsye për përjashtim sipas paragrafët 1.6 dhe 1.7 më sipër. Ofertuesit ose kontraktorët kryesorë duhet të zëvendësojnë të gjithë nënkontraktorët që kanë ndonjë bazë për përjashtim.

3.9 Çmimet e kontratës shprehen dhe paguhen në Euro, ose në monedhën e përmendur shprehimisht ndryshe në Marrëveshje. Rreziqet dhe ndryshimet e këmbimit nuk do t'i nënshtrohen asnjë kompensimi.

3.10 Pagesat do të jenë të gjurmueshme, sipas afateve të parashikuara në kontratë dhe duke marrë parasysh progresin aktual në performancë. Qeveria e Republikës Italiane i kryen pagesat Palës tjetër, siç parashikohet në Marrëveshje, ekskluzivisht në një llogari bankare të dedikuar. Në të gjitha kontratat, një klauzolë specifike i detyron autoritetet kontraktuese, kontraktorët kryesorë dhe nënkontraktorët të përdorin llogarinë e dedikuar për të gjitha pagesat.

3.11 Kontratat ndërpriten automatikisht nëse kontraktorët janë objekt i procedurave të falimentimit, për likuidim, për administrimin e punëve të tyre nga gjykata, ose janë në një marrëveshje me kreditorët, ose për ndonjë procedurë të ngjashme të parashikuar në ligjin e tyre kombëtar.

3.12 Në rast të sjelljes së qëllimshme ose fajit serioz, përgjegjësia e kontraktorëve nuk mund të kufizohet.

3.13 Ekzekutimi i kontratës do të rregullohet nga ligji i autoritetit kontraktues, përveç nëse parashikohet ndryshe në Marrëveshje ose Shtojcë.

3.14 Mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet kontraktorëve dhe autoritetit kontraktues nuk do t'i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave italiane.

3.15 Dokumentet e tenderit duhet të përmbajnë parimet e lartpërmendura.

4 Kostot e pranueshme dhe të papranueshme

4.1 Kostot e përfshira në kontratë(a) do të jenë të pranueshme nëse janë aktuale, ekonomike dhe të nevojshme për kryerjen e Projektit, në përputhje me dokumentin e Projektit.

4.2 Në çdo rast, artikujt e mëposhtëm nuk do të konsiderohen të pranueshëm:

4.2.1 mallra vullnetare ose luksoze (p.sh. parfume, kozmetikë, objekte arti, pije alkoolike, mallra sportive etj.)

4.2.2 mallra, shërbime dhe punime civile të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me aktivitete ushtarake;

4.2.3 taksa jo të ardhurash/jofitimprurëse (përfshirë TVSH-në) dhe detyrime importi që duhen paguar përfundimisht në vendin e autoritetit kontraktues;

4.2.4 provizione për borxhet e papaguara dhe humbjet e ardhshme të përfituesit ose përdoruesve përfundimtarë;

4.2.5 interesa që i detyrohen autoriteti kontraktues ose përdoruesit përfundimtarë ndonjë pale të tretë.

5. KLAUZOLA ETIKE

5.1 Çdo përpjekje nga kandidatët ose ofertuesit për të marrë informacion konfidencial, për të hyrë në marrëveshje të paligjshme me konkurrentët ose për të ndikuar autoritetin kontraktues gjatë procesit të shqyrtimit, sqarimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, do të çojë në refuzimin e kandidaturës ose ofertës së tij dhe mund të rezultojë në penalitete administrative;

5.2 Kontraktorët dhe stafi i tyre ose çdo shoqëri tjetër me të cilën kontraktori është i asociuar ose i lidhur, nuk mund të furnizojnë shërbime të tjera, të kryejnë punime ose të furnizojnë pajisje për Projektin, as mbi bazë ndihmëse ose nënkontraktimi.

5.3 Kontraktorët duhet të veprojnë në çdo kohë në mënyrë të paanshme dhe si një këshilltar besnik në përputhje me kodin e sjelljes së profesionit të tyre. Ata duhet të përmbahen nga bërja e deklaratave publike në lidhje me Projektin ose shërbimet, pa miratimin paraprak të autoritetit kontraktues. Ata nuk mund ta angazhojnë autoritetin kontraktues në asnjë mënyrë, pa pëlqimin e tij paraprak me shkrim.

5.4 Gjatë kohëzgjatjes së kontratës, kontraktorët dhe stafi i tyre duhet të respektojnë të drejtat e njeriut dhe të zotohen të mos shkelin zakonet politike, kulturore dhe fetare të shtetit përfitues. Në veçanti, ofertuesit të cilëve u është dhënë kontrata, duhet të respektojnë standardet themelore të punës siç përcaktohen në Konventat përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (siç janë konventat mbi sindikatat dhe mbrojtjen e të drejtave të sindikatave, si dhe mbi lirinë e shoqërimit dhe negociatat kolektive; eliminimin e punës së detyruar dhe të detyrueshme, siç është integruar nga Protokolli i vitit 2014; eliminimin e diskriminimit në lidhje me punësimin dhe profesionin; Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Grave gjatë Barrëlindjes (Maternitetit), Konventën mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Bujqësi dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve).

5.5 Kontraktorët nuk mund të pranojnë asnjë pagesë të lidhur me kontratën përveç asaj të parashikuar në të. Kontraktorët dhe stafi i tyre nuk duhet të ushtrojnë asnjë aktivitet ose të marrin ndonjë avantazh që nuk përputhet me detyrimet e tyre ndaj autoritetit kontraktues.

5.6 Kontraktori dhe stafi i tij janë të detyruar të ruajnë sekretin profesional për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës dhe pas përfundimit të saj. Të gjitha raportet dhe dokumentet e hartuara ose të marra nga kontraktori, janë konfidenciale.

5.7 Kontraktorët duhet të përmbahen nga çdo marrëdhënie që mund të cenojë pavarësinë e tyre ose të stafit të tyre. Nëse kontraktorët pushojnë së qeni të pavarur, ose në rast se lind një konflikt interesi, ata do të informojnë autoritetin kontraktues pa vonesë. Autoriteti kontraktor mund ta ndërpresë kontratën pa njoftim të mëtejshëm dhe pa pasur furnizuesi ndonjë kërkesë për kompensim.

5.8 Qeveria e Republikës Italiane rezervon të drejtën për të pezulluar ose anuluar financimin e Projektit nëse zbulohen praktika korruptive të çdo lloji në çdo fazë të procesit të dhënies së kontratës dhe nëse autoriteti kontraktues nuk arrin të marrë të gjitha masat e duhura për të korrigjuar situatën. Për qëllimet e këtij dispozite, "praktikat korruptive" janë ofrimi i një ryshfeti, dhurate, shpërblimi ose komisioni për çdo person si nxitje ose shpërblim për kryerjen ose moskryerjen e ndonjë veprimi që lidhet me dhënien e një kontrate ose zbatimin e një kontrate të lidhur tashmë me autoritetin kontraktues.

5.9 Të gjitha dokumentet e tenderit dhe kontratat për punime, furnizime dhe shërbime, duhet të përfshijnë një klauzolë që përcakton se ofertat do të refuzohen ose kontratat do të ndërpriten nëse rezulton se dhënia ose ekzekutimi i një kontrate ka shkaktuar shpenzime të pazakonta tregtare. Shpenzime të tilla të pazakonta tregtare janë komisione që nuk përmenden në kontratën kryesore ose që nuk rrjedhin nga një kontratë e lidhur sipas rregullave që i referohet kontratës kryesore, komisione që nuk janë paguar në këmbim të ndonjë

shërbimi aktual dhe legjitim, komisione të dërguara në një parajsë tatimore, komisione të paguara një marrësi që nuk është identifikuar qartë ose komisione të paguara një shoqërie që ka gjasa të jetë një shoqëri fasadë.

5.10 Kontraktorët duhet të ofrojnë, me kërkesë të AICS-së, prova mbështetëse në lidhje me kushtet në të cilat po ekzekutohet kontrata. Autoritetet kompetente italiane mund të kryejnë çdo kontroll dokumentar ose në vend që i çmojnë të nevojshëm për të konstatuar prova në rastet e dyshuara për shpenzime të pazakonta tregtare ose praktika të dyshuara korruptive.

5.11 Kontraktorët që zbulohen se kanë paguar shpenzime të pazakonta tregtare për Projekte të financuara nga Republika Italiane, janë përgjegjës, në varësi të shkallës së fakteve të vëzhguara, për ndërprerjen e kontratave të tyre ose për përjashtimin e përhershëm nga marrja e fondeve nga Qeveria e Republikës Italiane.

5.12 Mosrespektimi i një ose më shumë klauzolave të etikës, mund të rezultojë në përjashtimin e kandidatit, ofertuesit ose kontraktorit nga kontrata të tjera të financuara nga Italia, dhe në penalitete të parashikuara në kontratë. Individi ose shoqëria në fjalë duhet të informohet për faktin me shkrim.

5.13 Është detyrë e autoritetit kontraktues të garantojë që procedurat e prokurimit të ekzekutohen në mënyrë transparente, bazuar në kritere objektive dhe duke mos marrë parasysh ndonjë ndikim të mundshëm të jashtëm.

SHTOJCA III
E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT "PËRPARIMI I SHËNDETIT NEONATAL DHE I NËNËS NË SHQIPËRI (ANMA) – AID 013307"

RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË ZBATUESHME PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT

Fusha e zbatimit	Kufiri monetar (në EURO)	Udhëzime referuese	Autoriteti (procedura e prokurimit)	Publikimi i thirrjes për tender	Miratimi paraprak nga		Rishikimi i mëvonshëm i auditimit (po/jo)
					Dokumentet e Tenderit	Vendimi i fituesit	Kontratë
Punime	>1.000.000,00	PRAG	MSHMS	Faqet e internetit të reklamave ndërkombëtare për tendera/faqja e internetit e AICS-së/faqet e internetit të institucioneve shqiptare	AICS	AICS	JO
	>300.000,00		MSHMS	Faqet e internetit kombëtare të njoftimeve për tendera/faqja e internetit e AICS-së /faqet e internetit të institucioneve shqiptare	-	AICS	JO
	<= 300.000,00		MSHMS	Faqet e internetit të institucioneve shqiptare	-	-	PO
Furnizime dhe Shërbime	>300.000,00	PRAG	MSHMS	Faqet e internetit të reklamave ndërkombëtare për tendera/faqja e internetit e AICS-së /faqet e internetit të institucioneve shqiptare	AICS	AICS	JO
	<300.000,00		MSHMS	Faqet e internetit kombëtare të njoftimeve për tendera/faqja e internetit e AICS-së /faqet e internetit të institucioneve shqiptare	-	AICS	JO
	<=100.000,00		MSHMS	Faqet e internetit të institucioneve shqiptare	-	-	PO

VENDIM
Nr. 795, datë 24.12.2025

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE TË APLIKIMIT E TË SHQYRTIMIT, TË MËNYRËS SË PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE DHE TË PROCEDURAVE TË FINANCIMIT NË FORMË TRANSFERTE PËR VEPRIMTARI TË PROPOZUARA NGA KOMITETI OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR, OLIMPIKU SPECIAL SHQIPTAR, FEDERATAT JOOLIMPIKE DHE FONDACIONET SPORTIVE, ME THEMELUES INSTITUCIONET PUBLIKE PËRGJEGJËSE NË FUSHËN E SPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 79/2017, "Për sportin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e kritereve, të procedurave të aplikimit e të shqyrtimit, të mënyrës së përzgjedhjes së projekteve dhe të procedurave të financimit në formë transferte nga ministria përgjegjëse për sportin për veprimtaritë e propozuara nga organizatat sportive, si më poshtë vijon:

a) Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar;

b) Olimpiku Special Shqiptar;

c) federatat joolimpike;

ç) fondacionet sportive, me themelues institucionet publike përgjegjëse në fushën e sportit.

2. Organizatat sportive të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, duhet të plotësojnë kriteret, si më poshtë vijon:

a) të kenë fushë veprimtarie të ngjashme me projektin që po aplikojnë;

b) të kenë zhvilluar Kampionatin Kombëtar dhe Kupës së Shqipërisë në vitin paraardhës, në rastin e Federatave Joolimpike, dhe Lojërat Olimpike Speciale, në rastin e Olimpikut Special Shqiptar;

c) të kenë ndikim në masivizimin e sportit dhe përfshirjen e të rinjve në aktivitetet sportive, zhvillimin e talenteve dhe përmirësimin e rezultateve sportive, promovimin e barazisë gjinore, përfshirjen e femrave e të personave me aftësi ndryshe, promovimin dhe mbështetjen e sportistëve të nivelit të lartë.

3. Organizatat sportive të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, paraqesin projektpropozimin, të miratuar paraprakisht nga organi ekzekutiv, të shoqëruar me vendimin përkatës dhe me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimet e asamblesë vjetore për vitin paraardhës të aplikimit dhe vendimet e asamblesë së fundit zgjedhore, të zhvilluar në respektim të ciklit olimpik, në rastin e federatave sportive;

b) kopjen e statutit dhe/ose të vendimit të gjykatës për regjistrimin e saj, sipas legjislacionit në fuqi;

c) dokumentacionin që vërteton regjistrimin si person juridik, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) urdhrin e ministrit përgjegjës për sportin për miratimin e statutit dhe ndryshimeve të tij;

d) bilancin financiar të miratuar sipas legjislacionit në fuqi;

dh) të dhënat e llogarisë bankare të nivelit të dytë të dedikuar;

e) raporte financiare periodike për fondet publike të akorduara nga ministria përgjegjëse për sportin.

4. Formulari i aplikimit të projektit përcaktohet çdo vit me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin dhe përmban të dhënat, si më poshtë vijon:

a) projektpropozimin e plotë;

b) planin e detajuar dhe kohëzgjatjen e aktiviteteve;

c) buxhetin e detajuar dhe të argumentuar për realizimin e aktiviteteve;

ç) konfirmimin për bashkëfinancimin e projektit të propozuar, nëse ka;

d) marrëveshjet me partnerë të tjerë, që janë pjesë e zbatimit të projektit.

4/1. Në rast se paraqitet më shumë se një projektide, duhet të paraqitet buxhet i veçantë për secilin projekt.

5. Prioritetet për përzgjedhjen e projekteve përcaktohen çdo vit me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin, shoqëruar me formularin e aplikimit të projektit.

6. Thirrja për paraqitjen e projektpropozimeve hapet çdo vit brenda muajit shkurt dhe qëndron e hapur, sipas afatit të përcaktuar, me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin. Pas përfundimit të afatit të aplikimit, struktura përgjegjëse, brenda 7 (shtatë) ditëve, nëse konstaton parregullsi, njofton

aplikuesit, duke i caktuar afatin 5-ditor për plotësimin e parregullsive.

7. Shqyrtimi, renditja dhe përzgjedhja e projektpropozimeve nga ministria përgjegjëse për sportin bëhet sipas procedurës së mëposhtme:

a) Ngrihet komisioni i vlerësimit të aplikimeve të bëra nga organizatat sportive, i cili vlerëson projektet, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij vendimi;

b) Komisioni i vlerësimit harton për secilin projektpropozim raportin e arsyetuar dhe propozimin për financim;

c) Komisioni i vlerësimit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga ngritja e tij, i njofton aplikuesve renditjen përfundimtare. Aplikuesit mund të ankimojnë vendimmarrjen e komisionit të vlerësimit brenda 5 (pesë) ditëve te ministri përgjegjës për sportin. Nëse pas përfundimit të afatit të ankimit administrativ, rezulton se nuk është paraqitur asnjë ankim administrativ, komisioni i vlerësimit i paraqet ministrit renditjen përfundimtare të aplikuesve, shoqëruar me vlerat financiare.

Shqyrtimi i ankimit kryhet nga komisioni i shqyrtimit të ankesave, i cili përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) anëtarë. Ky komision ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin. Pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit administrativ, komisioni i paraqet ministrit vendimin për shqyrtimin e ankesave dhe renditjen përfundimtare.

8. Tavanet e financimit për financimin në formë transferte për veprimtari të propozuara nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Olimpiku Special Shqiptar, federatat joolimpike dhe fondacionet sportive, me themelues institucionet publike përgjegjëse në fushën e sportit, përcaktohen në përputhje me fondin e miratuar në ligjin vjetor të buxhetit, në programin e zhvillimit të sportit. Këto organizata financohen dhe monitorohen nga ministria përgjegjëse për sportin, sipas procedurave të mëposhtme:

a) strukturat përgjegjëse për financat, në ministrinë përgjegjëse për sportin, kryejnë kreditimin e fondeve buxhetore për organizatat sportive;

b) strukturat e sportit, në ministrinë përgjegjëse për sportin, sipas rregullores së brendshme, monitorojnë përdorimin e fondeve publike nga përfituesit e grantit/transfertës gjatë vitit ushtrimor;

c) organizatat sportive të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, duhet të bëjnë transparente për anëtarët e tyre ndarjen e të gjitha fondeve të përfituara në vitin korrent, si dhe të publikojnë këtë informacion në *website*-t e çdo organizate. Drejtoria përgjegjëse për programet e zhvillimit të sportit monitoron zbatimin e këtij detyrimi.

9. Fondet e miratuara alokohen nga ministria përgjegjëse për sportin në llogaritë bankare të dedikuara të nivelit të dytë të përfituesve. Përfituesit e fondeve publike raportojnë periodikisht, çdo 6 (gjashtë) muaj, për zbatimin e projektpropozimeve të financuara, për të siguruar transparencë, monitorim të rezultateve dhe përputhshmëri me objektivat dhe planin e miratuar të aktiviteteve.

10. Monitorimi i projekteve të realizuara nga federatat sportive dhe fondacionet e themeluara nga ministria përgjegjëse për sportin kryhet nga struktura përgjegjëse për sportin.

11. Monitorimi për mbikëqyrjen e realizimit të mbështetjes financiare të KOKSH-it kryhet nga grupi i punës, i caktuar me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin. Përbërja dhe detyrat e grupit të punës përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.

12. Në rastet e projekteve me interes të veçantë publik, të cilat lidhen me zhvillimin kombëtar të sportit, përfshirjen sociale, edukimin fizik të të rinjve, apo nisma të tjera, që kanë impakt të drejtpërdrejtë në komunitet, të paraqitura nga organizatat sportive, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, të paraqitura jashtë afateve të përcaktuara, ministria përgjegjëse për sportin, bazuar në fondet buxhetore të disponueshme ose ato të vëna në dispozicion nga ministria përgjegjëse për financat, mund të shqyrtojë dhe të miratojë financimin e këtyre projekteve. Në këtë rast, aplikuesit plotësojnë kriteret e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, dorëzojnë dokumentacionin shoqërues të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, së bashku me projektpropozimin e plotë, planin e detajuar dhe kohëzgjatjen e aktiviteteve, buxhetin e detajuar dhe të argumentuar për realizimin e aktiviteteve, konfirmimin për bashkëfinancimin e projektit të propozuar, nëse ka, dhe marrëveshjet me partnerë të tjerë, që janë pjesë e zbatimit të projektit.

13. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe organizatat sportive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin nr. 35, datë 11.12.2025, "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.3.2019, 'Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë"', i ndryshuar, në titullin si dhe në tekstin e këtij vendimi (pika 1 e tij) të miratuar nga KED-ja, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 233, datë 15.12.2025, konstatohet një gabim material te data e vendimit nr. 4 (që është amenduar nga vendimi nr. 35) e cila figuron e shkruar **13.3.2019**, ndërkohë që data e saktë e vendimit nr. 4 është data **11.3.2019**.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rruga "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/12/29 16:06:30 +02'00'
b913a66ffd8f4e8f9c138e53e9f1d17220

Çmimi 640 lekë

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)